



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. PAL PERAJ

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. __ Datë __.__._____

Kryetar i Bashkisë

Z. FRAN TUCI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË FUSHË-ARRËZ

STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. __, Datë __.__._____

DPKZHT: *TONIN PRENGA*

KONSULENT “GJEOKONSULT&CO”: *me përfaqësues ligjor Z.Hamit Mustafa , Nr.Liç. N6408/18*

PËRMBAJTJA	2
1. HYRJE.....	5
2. REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT	6
2.1 PARASHIKIMET E PLANIT KOMBËTAR.....	6
2.1.1 OBJEKTIVAT, POLITIKAT DHE VIZIONI I PPK.....	6
2.1.2 PARASHIKIMET E PPK NË LIDHJE ME FUSHË-ARRËZIN.....	7
3. STRATEGJI DHE DIREKTIVA KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT SEKTORIAL	8
3.1 STRATEGJIA E SEKTORIT TË TRANSPORTIT	8
NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË TRANSPORTIT, BASHKIA FUSHË-ARRËZ PËRFSHIHET NË RRUGËT LIDHËSE MIDIS QARKUT TË SHKODRËS KU AJO BËN PJESË DHE QARKUT TË KUKËSIT. LIDHJA NËPËRMJET KËSAJ BASHKIE BËN TË MUNDUR FUQIZIMIN E VETË SAJ NË RAPORTET RAJONALE DHE NDËR-RAJONALE.	10
3.2 STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË	10
3.3 STRATEGJIA KOMBËTARE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	11
3.4 PROGRAMI KOMBËTAR SEKTORIAL I UJIT 2018-2030.....	13
1. PËRDORIMI I UJIT	13
2. MBROJTJA E UJIT	13
3. MBROJTJA NGA UJI	13
3.5. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM 2015-2020	13
3.6. STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE 2015-2020	15
STRUKTURAT E DEKONCENTRUARA	15
3.7. STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E MJEDISIT 2015 – 2020.....	16
3.8 STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2018-2020.....	19
3.9 DEKLARIMI I POLITIKËS DHE VIZIONI	20
4. PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE	21
4.1 TË DHËNA SOCIO-DEMOGRAFIKE	21
4.2 SHËRBIMET PUBLIKE OSE ME PËRDORIM PUBLIK	22
4.2.1 KOPSHTET, SHKOLLAT 9-VJEÇARE, SHKOLLAT E MESME.	22
4.2.2 QENDRAT SHËNDETËSORE	23
5. ORIENTIME NGA DOKUMENTAT E PLANIFIKIMIT	24
5.1 FUSHË-ARRËZI NË LIDHJET RAJONALE.....	24
5.2 FUSHË-ARRËZI NË PROGRAMIN IPA II	24
5.3 FUSHË-ARRËZI SIPAS PPV-SË PUKË, PPV-SË KUKËS, PPV TROPOJË, PPV-SË MIRËDITËS DHE PPV-SË VAU I DEJËS.....	24
6. PËRCAKTIMI I TERRITORIT NË PESË SISTEMET DHE ANALIZA SWOT	25
6.1 SISTEMI URBAN	27
6.2 SISTEMI BUJQËSOR.....	30
6.3 SISTEMI NATYROR.....	32
<i>Zona të Mbrojtura historike.....</i>	<i>33</i>
6.4 SISTEMI UJOR	37
6.5 SISTEMI INFRASTRUKTUROR	40
- RRUGA FUSHË-ARRËZ - MICOJ.....	43
- RRUGA FUSHË-ARRËZ - LUMBARDHË.....	43
- RRUGË IBALLË - FJERZË.....	43
6.6 KONKLUSIONE PARAPRAKE	44
7. VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE E BASHKIVE FQINJE	45
7.1 KUKËSI:	45
7.2 TROPOJA:	46
7.2.1 Vizioni i Bashkisë:.....	46
7.2.2 Objektivat Strategjike të Bashkisë.....	46
O2- RUAJTJA E VLERAVE KULTURORE.....	46
O3- ZHVILLIMI I TURIZMIT	46
O5- PËRMIRËSIMI I AKSESUESHMËRISË NË TERRITOR DHE NË LIDHJET E BRENDSHME	47
O6- KONSOLIDIMI I QENDRAVE URBANE DHE RURALE	47
O7- PËRDITËSIMI DHE KRIJIMI I IËTURËS BAZË URBANE	47
O8- PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR.....	47
7.3 PUKË:	47

7.3.1	Vizioni i Bashkisë.....	47
7.3.2	Objektivat Strategjike të Bashkisë.....	47
8.	VIZIONI DHE STRATEGJIA E FUSHË-ARRËZIT.....	48
8.1	VIZIONI I BASHKISË	48
	PROMOVIMI DHE ZHVILLIMI I BASHKISË SË FUSHË-ARRËZIT NË ASPEKTIN E TURIZMIT PYJOR DHE MALOR, RITJESË AKSESUESHMËRISË DUKE PËRMIRËSUAR INFRASTRUKTURËN MIDIS PORTAVE TË RËNDËSISHME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE NË AFËRSI TË SAJ, SI EDHE RUAJTJA E ASETVE MJEDISORE TË PASURA TË VETË BASHKISË	48
8.2.	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	51
8.3	DREJTIMIT KRYESORE TË ZHVILLIMIT	52
9.3.1.	DREJTIMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS	53
	TRANSPORTI	53
	SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË	54
	SISTEMET E KANALIZIMEVE DHE TRAJTIMIT TË UJRAVE TË ZEZA	55
	MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA	55
	RRJETET TEKNOLOGJIKE	56
9.3.2.	DREJTIMI I ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË	56
9.3.3.	DREJTIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT	57
9.3.4.	DREJTIMI I ZHVILLIMIT TË MJEDISIT	58
8.4.	OBJEKTIV STRATEGJIK 1 - MBROJTJA E MJEDISIT	59
8.4.1	PROGRAMET STRATEGJIKE PËR OS1	60
	PROJEKTET PRIORITARE/PILOT	65
8.5.	OBJEKTIV STRATEGJIK 2 - ZHVILLIMI I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM DUKE PROMOVUAR ASETET NATYRORE DHE KULTURORE NË FUSHË-ARRËZ	72
	PROGRAMET STRATEGJIKE	73
8.6.	OBJEKTIV STRATEGJIK 3 - PËRMIRËSIMI I BUJQËSISË EDHE BLEGTORISË	95
	PROGRAMET STRATEGJIKE	97
8.7.	OBJEKTIV STRATEGJIK 4 - PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE.....	105
	PROGRAMET STRATEGJIKE	106
	PROJEKTET PRIORITARE/PILOT	110
	8.9 Objektiv Strategjik 5 - Organizimi i hapësirës urbane të Bashkisë	135
	PROGRAMET STRATEGJIKE	136
	PROGRAM STRATEGJIK 5.2. : "ORGANIZIMI I HAPËSIRAVE URBANE TË KRYEZIUT"	136
PLANI I VEPRIMIT.....		150
9.	REFERENCA LIGJORE	165
11.DËGJESA PUBLIKE DHE FORUMI VENDOR I KRYER NGA AKPT		166
11.1	DËGJESA PUBLIKE	166
11.2	FORUMI I BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR, DATË 28.01.2019	169
	KONLUZIONE NGA FORUMI VENDOR:	169

PËRPUNIMET HARTOGRAFIKE

Harta 1	Harta me Institucionet Arsimore	22
Harta 2	Harta me Institucionet Shëndetësore	23
Harta 3	Harta e 5 sistemeve.....	26
Harta 4	Harta e sistemit Urban	28
Harta 5	Sistemi Bujqësor.....	31
Harta 6	Harta e sistemit natyror ekzistues	36
Harta 7	Harta e sistemit ujor ekzistues	39
Harta 8	Rajonalizimi i qendrave të banuara (të integruara me pjesën natyrore të Bashkisë).....	49
Harta 9	Harta e Vizionit.....	50
Harta 10	Harta e projektit të ndërtimit të pikave të vrojtimit	63
Harta 11	Harta e projektit të pyllëzimit.	64
Harta 12	Shpërndarja e pikave të informacionit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz	74

Harta 13 Harta e vendodhjes së monumenteve natyrore dhe kulturore në Bashkinë Fushë- Arrëz	76
Harta 14 Harta e projektit për ndërtimin e intinerarit të vozitës në Koman	80
Harta 15 Harta e projektit për ndërtimin e intinerarit të biçikletave Fjerzë-Dardhë	81
Harta 16 Zonat e propozuara për kamping	82
Harta 17 Harta e fazave të zbatimit të PPV	150
Harta 18 Vendodhja e skedave teknike	164
Figure 1 diagrama me vizionin e të ardhmes për Kukësin	46
Figure 2 Diagrama e objektivave strategjike	52
Figure 3 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit strategjik 1	59
Figure 4 Harta e projektit të vendosjes së barierave mbrojtës në degëzimet e lumit Drin	62
Figure 5 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 2	73
Figure 6 Intinerar i propozuar në shtigjet e malit të Munellës	75
Figure 7 Foto në ish-burgun e Qafë-Brarit	77
Figure 8 Vendodhja e Bashkisë në Fushë-Arrëz ku do jenë zyrat e projektit për sektorin e turizmit	78
Figure 9 Pozicionimi i InfoPointit në Hartë	79
Figure 10 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 3"	96
Figure 11 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 4"	106
Figure 12 Rruga Fushë-Arrëz – Micoje cila propozohet për sitemim dhe asfaltim	107
Figure 13 Diagrama e "Objektivi strategjik 5"	135
Figure 14 Segmenti i lumit Fan ku propozohet ndërtimi i shëtitorës dhe lulishteve	136
Figure 15 Foto nga dëgjuesat me publikun	166
Figure 16 Lista e pjesëmarrësve nga dëgjesa publike e datës 22.01.2019	168

1. HYRJE

Ky raport zhvillon Strategjinë territoriale të Bashkisë së Fushë-Arrëzit duke nisur nga vlerësimi i analizës territoriale zhvilluar në Fazën 1, përsa i përket natyrës, kulturës, gjeologjisë, hidrologjisë, socio-demografisë, socio-ekonomisë, infrastrukturës, të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të vendbanimeve. Analiza gjithashtu përfshin identifikimin e parashikimeve dhe strategjive të Planit Kombëtar për zonën e Fushë-Arrëzit, që do të implementohen në PPV-në e të gjithë territorit të Bashkisë, i cili pas reformës së re territoriale është zgjeruar në sipërfaqe dhe më menaxhimin e sipërfaqes nga qeveria vendore.

Ripërpunimi kritik i të dhënave të dala i ka dhënë rrugë përpunimit të analizës SWOT mbi të pesë sistemet e caktuara territoriale : sistemin urban (UB), sistemin e infrastrukturës (IN), sistemin natyral (N), sistemin ujqor (U) dhe sistemin bujqësor (B).

Relacioni paraqitet si më poshtë:

- Kapitulli i parë janë përmbledhur rezultatet e kërkimeve të kryera në fazën e parë
- Kapitulli i dytë janë nxjerrë konkluzione në lidhje me Bashkinë Fushë-Arrëz në bazë të strategjive dhe direktivave kombëtare të planifikimit sektorial
- Kapitulli i tretë janë trajtuar projeksionet demografike
- Një kapitull në të cilin përshkruhet strategjia territoriale për 5 sistemet duke përcaktuar objektiva strategjike, për zhvillimin e territorit në përputhje me identifikimin e nevojave dhe mundësive
- Një plan veprimi që paraqet pamjen e përgjithshme të projekteve të identifikuara dhe në të cilat janë paraqitur:
 - Akse strategjike të planit
 - Objektiva
 - Projekte
 - Prioritete dhe korniza kohore
 - Tipologjia e investimit
 - Vlerësim i përafërt i kostove
- Për çdo projekt janë redaktuar disa skeda implementimi që përcaktojnë:
 - Objektivin e projektit
 - Përmbajtjen e projektit

2. REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT

2.1 Parashikimet e planit kombëtar

Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e referimit për të gjitha planet e hartuara në Shqipëri, në fakt, ai përcakton parimet dhe udhëzimet për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, duke vendosur supozimet për krijimin e kushteve territoriale për zhvillimin rajonal.

Përveç kësaj, Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e infrastrukturës publike kombëtare, dhe përcakton kushtet për ruajtjen e ekosistemeve dhe burimeve territoriale, nga ato nëntokësore në ato natyrore e kulturore, në lidhje me ndikimet e sistemeve urbane dhe të aktiviteteve ekonomike.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar drejton objektivat ndërsektoriale të planifikimit rajonal, dhe koordinon objektivat e zhvillimit sektorial me efekt mbi territorin; së fundi, një funksion i rëndësishëm që zhvillohet nga Plani ka të bëjë me kontrollin logjik në lidhje me udhëzimet dhe orientimet e perspektivës së zhvillimit të hapësirës Evropiane.

Lidhja me dimensionin evropian të qeverisjes së territorit është perceptuar si një çështje shumë e rëndësishme, duke supozuar për të ndërtuar në mënyrë sa më të mirë marrëdhëniet strategjike me shtetet fqinje që lindin nga stabiliteti politik, por edhe bazat për krijimin e një platforme që lehtëson aksesin e fondeve të alokuara në kuadër të programit evropian.

Ndërsa për sa i përket qeverisjes territoriale në dimensionin e saj të brendshëm, plani zhvillohet në brendësi të një procesi më të gjerë reforme administrative e cila ka prodhuar një ridefinim të hierarkive territoriale mes qendrave urbane dhe territoreve, së cilave i korrespondon një unifikim dhe riorganizim mjeteve planifikimi hapësinor në shkallë të gjerë.

2.1.1 Objektivat, politikat dhe vizioni i PPK

Në nivel strategjik, Plani Kombëtar shpalos objektivat e mëposhtme:

1. Integrimi hapësinor në kontekstin evropian,
2. Përforsimi i konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë në nivel rajonal,
3. Sigurimi i integritetit fizik e territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin kombëtar.
4. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet promovimit të rritjes ekonomike, eliminimit të pabarazive hapësinore dhe heqjen e pengesave për qasje në infrastrukturë dhe njohuri.

Për arritjen e këtyre objektiveve, plani evidenton direktivat e projektimit në nivel politik, të cilat kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimi i infrastrukturave kombëtare të lidhjes me korridoret e transportit ndërkombëtar;

2. Zhvillimi i rolit të Shqipërisë si pikë lidhëse për infrastrukturën energjetike të rajonit të Ballkanit;
3. Zhvillimi i Sistemeve Urbane Inteligjente;
4. Mbrojtja dhe zhvillimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, edhe në aspektin e identitetit, duke përmirësuar aksesin dhe përdorimin;
5. Zhvillimi i sistemit të transportit multimodal që lidhet me qëndrueshmërinë dhe transportin e integruar, i cili mbështet zhvillimin territorial policentrik;
6. Zhvillimi i infrastrukturave energjetike funksionale në përdorimin e burimeve energjetike të ripërtëritshme;
7. Projektimi dhe zhvillimi i një hub-i për të integruar flukset që lidhen me komunikimet, transportin, energjinë dhe produktet ushqimore.

Politika të tilla përshkruajnë "vizionin" e përgjithshëm të Planit, i cili shtrihet në nivele dhe fusha të ndryshme, duke mbajtur të forta dy referenca të kontekstit të cilit i asociohen dy shkallë diskutimi, njëra e lidhur me kontekstin e gjerë evropian, dhe të tjera me atë të hapësirës ballkanike. Në rastin e parë, skenari i propozuar nga plani merr në konsideratë krijimin e lidhjeve të infrastrukturës kombëtare që lidhin Shqipërinë me rrjetin e transportit trans-evropian, duke synuar forcimin e lidhjeve strategjike të vendit me anë të disa korridoreve që do të zhvillohen sipas një arsytimi multi-sektorial:

- Korridori gjelbër (Shkodër, Hani Hotit - Kakavijë, Gjirokastrë)
- Korridori Blu (përgjatë bregdetit)
- Korridori VII, i cili lidh Detin Mesdhe me Detin e zi
- Boshti qëndror Elbasan, Berat – Jug
- Rruga e Arbrit

Në kontekstin Ballkanik, Shqipëria ka qëllim për të zhvilluar centralitetin e saj në lidhje me tematikën të ndryshme, ndër të cilat qëndron tema e energjisë: Shqipëria është në fakt vend kalimi për korridore të ndryshme ndërkombëtare, të tilla si: Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) dhe IAP i KOSOVES për furnizimet në Kosovë përmes unazës së Ballkanit Perëndimor (WBR), të cilave i shtohen funksionet e shkëmbimit tregtar dhe logjistik të katër porteve kryesore shqiptare, ndër të cilat ai i Vlorës paraqitet më i rëndësishmi në frontin energjetik.

2.1.2 Parashikimet e PPK në lidhje me Fushë-Arrëzin

Në këtë paragraf do të bëjmë një përshkrim të shkurtër të parashikimeve të planifikuara në Planin Kombëtar në lidhje me Fushë-Arrëzin dhe konkluzione nga faza e analizës.

1. Bashkia e Fushë-Arrëzit sipas PPK-së klasifikohet në qendrat terciare urbane, në këtë klasifikim janë futur të gjitha Bashkitë e reja të krijuara pas reformës territoriale, të përcaktuara dhe si zona me shërbime arsimore dhe shëndetësore të nivelit të tretë si p.sh. poliklinikat

2. Fushë-Arrëzi, lokalizohet midis 2 poleve të zhvillimit rajonal, përkatësisht atij të Kukës- Fushë-Arrëz -Tropojë dhe të Shkodër-Lezhë. Ky pozicion i Bashkisë bën atë të përfitojë nga zhvillimet që parashikohen të ndodhin në këto rajone, të drejtuara kryesisht në fushën e infrastrukturës. Afërsia me polin Shkodër - Lezhë për Bashkinë Fushë-Arrëz si dhe pozicioni gjeografik i tij, bën të mundur që me fuqizimin e këtij poli të ketë zhvillim nga pikëpamja turistike, infrastrukturore etj.
3. Rigjenerimi i aksit Fushë-Arrëz-Tropojë.
4. Fushë-Arrëzi definohet në materialet edhe hartat përkatëse të PPK-së si një zonë për t'u mbrojtur nga shpyllëzimi, gjithashtu si një zonë ku kalon një korridor i gjelbër që lidhet me pjesët e tjera natyrore të kufitarëve të saj.
Pjesë e rëndësishme për sa i përket zhvillimit të Bashkisë në lidhje me këtë pikë të PPK-së është mbrotja e zonave natyrore, ku në rastin e Bashkisë Fushë-Arrëz spikat zona e Munellës si një zonë e cila është në fazën e konsolidimit si zonë e mbrojtur natyrore.
5. Zhvillimi i turizmit me fokus zonat me prioritet turistik dhe itinerarin vozitës përgjatë liqenit të Fierzës si dhe itineraret ciklistike përgjatë saj. (e lokalizuar në pjesën veriore të Bashkisë Fushë-Arrëz)

3. STRATEGJI DHE DIREKTIVA KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT SEKTORIAL

3.1 Strategjia e Sektorit të Transportit

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në Shqipëri është një nga prioritetet kryesore, për krijimin e parakushteve për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, rritjen e aksesit dhe kontributit të konsiderueshëm në rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin e ekonomisë. Nga Strategjia Kombëtare e Transportit për zhvillimin e infrastrukturës së transportit, parashikohen si më poshtë:

- Prioritet strategjik për infrastrukturën rrugore, është përfundimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor primar dhe dytësor të vendit, duke siguruar ndërlidhjen, lidhjen ndërkombëtare dhe sigurinë rrugore. Me gjithë investimet e fundit në rrjetin rrugor lokal dhe rajonal, cilësia e infrastrukturës së transportit rrugor mbetet e ulët dhe ekziston një ndryshim i konsiderueshëm rajonal në drejtim të aksesit të tregjeve dhe shërbimeve bazë. Rrjeti rrugor në vend është ende i kufizuar në mbulim dhe në cilësi dhe vuan nga mungesa e mirëmbajtjes, pavarësisht nga investimet e bëra përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Mirëmbajtja dhe performanca sipas standardeve të BE-së, si dhe dendësia e rrjetit, duhet të përmirësohet përmes një sistemi menaxhimi të aseteve rrugore dhe zgjerimit të rrjetit rrugor kombëtar me pjesët e rrjetit rural. Në këtë drejtim, kontribuon në zbatimin e projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore (EBRD) deri në vitin 2020 si dhe zbatimin e një programi shtesë, bashkëfinancuar nga IPA për mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare që nuk mbulohen nga projekti RRMSP, por të konsideruara si prioritet i lartë sipas Deklaratës të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor (Iniciativa 6 - Axhenda e Lidhjes).

- Përveç kësaj, rishikimi i klasifikimit funksional të rrjetit rrugor, rritja e alokimit të buxhetit vjetor për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar rrugor, promovimi i outputeve dhe koncesioneve të bazuara në performancë (Partneritetet Publike-Private) për operatorët rrugorë dhe mirëmbajtjen, jo vetëm për rrjetin kombëtar, por edhe për rrjetin rajonal dhe lokal dhe ekzaminimi i mundësisë së përcaktimit të një përqindje të caktuar të tarifave të përdoruesit të rrugës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor.
- Për më tepër, për të siguruar lidhjen midis Evropës Juglindore dhe BE, strategjia parashikon përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e lidhjeve të munguara në rrjetin gjithëpërfshirës të Evropës Juglindore, duke siguruar në të njëjtën kohë lidhjen e këtij rrjeti bazë me pjesën tjetër të rrjetit primar dhe sekondar të vendit. Rrjeti i projektit përfshin seksionin Rrëshen - Milot të korridorit SEETO 7 që lidh Nishin (Serbi) - Prishtinën (Kosovë) dhe Durrësin,(në aksin e kësaj rrugë që kalon në Shqipëri , pjesë e itinerarit të saj është edhe Bashkia e Fushë-Arrëzit) . Mbetet prioritet dhe përfundimi i një ure dhe një tuneli në segmentin Kukës-Morinë në rrugën 7 drejt Prishtinës.
- Lidhur me infrastrukturën hekurudhore, prioritet është futja e vendit në tregun hekurudhor evropian si një aktor në korridoret e transportit në Evropën Juglindore. Kjo kërkon përpjekje për rritjen e performancës së hekurudhave, përkatësisht për të reduktuar kohën e tranzitit, shpenzimet e transportit dhe logjistikës, për të lehtësuar kalimet kufitare duke krijuar kalime të përbashkëta kufitare dhe tërheqjen e investimeve të nevojshme për të harmonizuar aspektet teknike dhe rregullatore sipas standardeve të BE. Është planifikuar një korridor hekurudhor atraktiv dhe konkurrues nga porti i Durrësit në Tiranë (ndërtimi dhe modernizimi i linjës në Terminalin e Transportit Publik Tiranë dhe lidhja e munguar me aeroportin e Tiranës), së bashku me rehabilitimin e linjës nga Durrësi në Rrogozhinë - Elbasan
- Pogradec dhe Lin, ndërtimi i linjës Qafë Thanë drejt kufirit me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përgatitja e rinovimit të linjës Vorë - Hani i Hotit drejt kufirit me Malin e Zi. Për Fushë-Arrëzin nuk është parashikuar ndonjë segment hekurudhor i cili kalon në këtë territor.
- Së fundmi, për Aeroportet, duhet të përpunohet një Master Plan për të gjithë vendin për 20 vitet e ardhshme, me theks në zhvillimin dhe ndërtimin e një aeroporti të ri në jug të vendit, në mënyrë që të shërbejë si një qendër për fluturimet ndër-evropiane e dhe mesdhetare, për zgjerimin e aeroportit të Tiranës pas vitit 2025 dhe për ndërtimin e aeroportit të Kukësit. Aeroporti i Kukësit do të ndikojë në zhvillimin jo vetëm të Kukësit, por edhe zonave përreth , ku përfshihet edhe Fushë-Arrëzi.
- Perspektiva e zhvillimit Intermodal dhe Transportit të Kombinuar, qëllimi është të integrojë planifikimin dhe zhvillimin e terminaleve në planifikimin më të gjerë të transportit dhe përdorimit të tokës, përmirësimin e aksesit në terminale dhe pajisjet e terminaleve me kapacitete operationale si dhe për të drejtuar investimet në trajtimin e pengesave, në mënyrë që të sigurohet një transport efikas i integruar me zinxhirë logjistikë pa ndërprerje, kosto të ulët dhe zvogëlim të trafikut të automjeteve të rënda nga portet kryesore shqiptare.

në vendet fqinje (duke përfshirë vendet që kanë dalje në det, Kosovë dhe FYROM) dhe më gjerë dhe duke kontribuar në këtë mënyrë në zbatimin e Flagship Axes në rajon.

Në lidhje me zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit, Bashkia Fushë-Arrëz përfshihet në rrugët lidhëse midis qarkut të Shkodrës ku ajo bën pjesë dhe qarkut të Kukësit. Lidhja nëpërmjet kësaj Bashkie bën të mundur fuqizimin e vetë saj në raportet rajonale dhe ndër-rajonale.

3.2 Strategjia Kombëtare e Energjisë

Shpreh në thelb përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik, si një sektor mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me një kosto minimale sociale. Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme të burime të rinovueshme:

- Energjia nga burimet hidrike
- Energjia Diellore
- Energjia e Erës
- Energjia e biomasës
- Energjia gjeotermale.

Përmirësimi i performancës së sektorit energjetik është thelbësor, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit tonë, por ajo duhet parë dhe në kontekst të situatës energjetike në vendet e Europës Juglindore.

Traktati i Komunitetit të Energjisë, i cili ka hyrë në fuqi në Korrik 2006, në të cilin vendi ynë është palë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006), inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe të gazit në rajon, në kuadër të Tregut të Brendshëm Energjetik të Komunitetit European.

Për realizimin e objektivave të strategjisë janë përcaktuar këto prioritetë:

- Përfundimi i ristrukturimit të sektorit energjetik shqiptar;
- Përsosja e mëtejshme e kuadrit efektiv institucional e ligjor;
- Rritja sigurisë së furnizimit me energji të vendit,
- Rritja e kontributit të sektorit energjetik në zhvillimin ekonomik të vendit, në Buxhetin e Shtetit dhe bilancin financiar të vendit,
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimi i tyre,
- Intensifikimi i operacioneve të kërkim-prodhimit të hidrokarbureve dhe tërheqja e investorëve strategjikë në këtë sektor, si dhe në zhvillimin e vendburimeve ekzistuese, për të mundësuar shfrytëzimin me efektivitet dhe efikasitet të naftës bruto.
- Ndërtimi i linjave të reja të interkonjeksionit në sektorin elektroenergjetik,
- Angazhimi në realizimin e projekteve rajonale të interkoneksionit me linjat e gazit dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit,

- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, me konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis,
- Nxitja e përdorimit eficient dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitja e aplikimit të mënyrave të ndryshme të menaxhimit të energjisë, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë,
- Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,
- Krijimi i tregut të brendshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal,
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në sektorin energjetik,
- Përmirësimi i organizimit institucional i sektorit energjetik dhe nënsektorëve të tij (elektroenergjetik, hidrokarbur, energji të rinovueshme dhe efikasitet).
- Për realizimin e qëllimi strategjik në përafrimin me Direktivat e Bashkimit Europian duhet të realizohen:
- Përfundimi i plotësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator të sektorit energjetik, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian;
- Përfundimi i strukturimit të shoqërive tregtare, që operojnë në sektorin energjetik;
- Do të përfundojë privatizimi i shoqërive të prodhimit të energjisë elektrike, pronë publike, me përjashtim të hidrocentraleve Vau i Dejës, Koman dhe Fjerzë mbi lumin Drin.

Shqipëria si një prej Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është e detyruar të transpozojë dhe të jetë në përputhje me direktivën e BE-së 2009/28/EC, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Një nga kërkesat e ligjit 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë” është përgatitja dhe miratimi i **Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjitë e Rinovueshme 2015-2020** (PKVER), i cili vendos objektiva kombëtare të energji të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit, si dhe masat mbështetëse për t’i arritur ato. Sipas vendimit nr. 27, datë 20.1.2016 është miratuar Plan Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme për vitet 2015–2020.

Përsa i përket Bashkisë Fushë-Arrëz situata ekzistuese e Bashkisë paraqet vështirësi me furnizimin energjistik për shkak të largësisë dhe relievit malor që ndan qendrat e banuara nga njëra - tjetra. Një pasuri e Bashkisë Fushë-Arrëz janë burimet ujore të cilat shfrytëzohen jo vetëm për sektorin energjistik (nëpërmjet disa HEC-eve të vogla) por edhe për sektorin e industrisë për furnizim me ujë të pijshëm.

3.3 Strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve

Është miratuar me VKM 175, datë 19.01.2011. Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel shumë të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Praktikohet shumë pak riciklim. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vendgrumbullimet e mbetjeve. Nuk ka një sistem të sigurt për administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Sipas kësaj strategjie raportohen disa probleme mjedisore të cilat lidhen me këto çështje si:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe jo efektive;

- Vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund të bëhen në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Publiku ka mungesë informacioni për sa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve.

Strategjia mbulon periudhën 2010-2025, e cila është periudhë e rëndësishme para dhe menjëherë pas aderimit në BE, kohë gjatë së cilës administrimi i mbetjeve konsiderohet një çështje prioritare, ka përpjekje të rëndësishme dhe duhet të bëhen përmirësime radikale në situatën aktuale. Strategjia bazohet në katër shtyllat themelore të politikës kombëtare mbi mbetjet, si:

- planifikimi,
- edukimi,
- burimet,
- legjislacioni.

Strategjia kombëtare e mbetjeve e pranon nevojën për të marrë plotësisht në konsideratë nevojat dhe rrethanat lokale, në mënyrë që të identifikojë zgjedhjet praktikisht më të mira për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë vendin.

Për këtë arsye, strategjia e ndan vendin në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë të qarqeve ekzistuese, ku secili nga planet do të zhvillohet në bashkëpunim me aktorët lokalë.

Gjithashtu Fushë-Arrëzi, njih nevojën për të identifikuar burimet parësore të mbetjeve, në mënyrë që ata të mund të jenë subjekt i veçantë në konsideratë për Qeverinë dhe komunitetin ndërkombëtar të donatorëve.

Aktualisht në Bashkinë Fushë-Arrëz menaxhimi i mbetjeve nuk ka një plan zhvillimi të konsoliduar. Menaxhimi i mbetjeve është kryesisht në nivel privat dhe individual nga banorët e zonës. Pavarësisht kësaj mbetjet që prodhohen nga ndërtimet industriale në disa zona të Bashkisë kanë nevojë të merren parasysh nga kompanitë private të cilat menaxhojnë sipërfaqet e caktuara ku ato veprojnë si psh : Miniera në afërsi të qytetit të Fushë-Arrëzit, Industritë e nxjerrjes dhe përpunimit të ujit të cilat shoqërohen me impiante dhe godina të veçanta për funksionimin e tyre etj. Këto lloj industrish duhet të shoqërohen me plane menaxhimi të mbetjeve që ato prodhojnë për të mos ndotur mjedisin përreth, sidomos në një zonë si Fushë-Arrëzi i cili ka natyrë kryesisht natyrore pyjore, ku impakti është i ndjeshëm dhe i drejtpërdrejtë.

Duke pasur si çështje kryesore përmirësimin e synuar të rrethanave patogjene që ndikojnë në metabolizëm për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit, propozohen veprimet e mëposhtme për Bashkinë:

- Ndryshimi total i modelit të menaxhimit të mbetjeve (të lëngshme dhe të ngurta). Përpunimi (në impiante të përshtatshme) të ujërave të zeza urbane, përhapjen e riciklimit të ambalazhimeve dhe mbetjeve organike të ngurta urbane, në mënyrë që në të ardhmen, deponimi i mbetjeve të kufizohet në ato që teprojnë nga mënyrat alternative të menaxhimit.
- Marrja e masave për të parandaluar dhe rehabilituar ndotjen e burimeve ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore).

3.4 Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030

Manaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritet e qeverisë shqiptare. Ky prioritet theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (*miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016*). Sektori i ujit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ai lidhet ngushtë me prodhimin e energjisë elektrike, zhvillimin e bujqësisë, turizimin dhe rekreacionin. Në procesin e integritit evropian arritja e standardeve të BE-së në sektorin e ujit konsiderohet si një nga proceset më të vështira dhe të kushtueshme.

Për të realizuar vizionin për një periudhë trembëdhjetë vjeçare (2018-2030) për sektorin e ujit janë identifikuar dhe propozuar tre qëllime, të cilat shprehen në funksion të tre shtyllave të sektorit të ujit: përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji. Për arritjen e këtyre qëllimeve janë propozuar trembëdhjetë objektiva të cilat tregojnë pozicionimin e sektorit të ujit për këtë periudhë. Këto tre qëllime prekin ciklin natyror të ujit dhe nuk ndryshojnë pavarësisht kuadrit institucional, i cili ka rolin kryesor në harmonizimin e tyre.

1. Përdorimi i Ujit

Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre ndërmjet përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike në respekt të kushteve mjedisore dhe parimeve të manaxhimit të qëndrueshëm.

2. Mbrojtja e Ujit

Mbrojtja e ekosistemeve ujore, përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga ndotja shpërdorimi dhe mbishfrytëzimi, duke mirëkoordinuar të gjitha aktivitetet të cilat shkaktojnë presione mbi to si dhe duke respektuar parimet e manaxhimit të qëndrueshëm.

3. Mbrojtja Nga Uji

Mbrojtja e popullsisë dhe e pronës nga efektet e pakthyeshme të shkaktuara nga uji, përfshirë këtu përmbytjen dhe erozionin, në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

3.5. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon axhendën e integritit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. SKZHI II është dokumenti që paraqet vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2015-2020, duke ravijëzuar aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian. SKZHI 2015-2020 paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë, si më poshtë:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;

- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

Vizioni dhe përparësitë strategjike të Shqipërisë bazohen në njohuri të shëndosha rreth faktorëve të integritit evropian dhe zhvillimit kombëtar. Përgatitja e SKZHI-II është udhëhequr nga një numër parimesh bazë, disa prej të cilave janë artikuluar në një gamë konventash dhe marrëveshjesh ndërkombëtare dhe disa të tjerash që kanë dalë dhe janë përdorur gjatë proceseve të konsultimit dhe analizës së politikave. Parimet janë përdorur gjithashtu edhe për përgatitjen e strategjive dhe planeve specifike sektoriale dhe ndërsektoriale, të tilla si parimet e tregtisë së ndershme dhe menaxhimit të financave publike, ose parimet e Kartës së Autonomisë Vendore të BE-së, dhe kështu me radhë. Megjithatë, disa parime të caktuara të nivelit më të lartë mbështesin vizionin e SKZHI-II si një e tërë. Ato janë:

1. Parimet e qëndrueshmërisë. SKZHI-II bazohet në përdorimin e parimeve të pranura në shkallë botërore të zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë Deklaratën e Parimeve udhëheqëse të zhvillimit të qëndrueshëm të Komisionit Evropian. Midis parimeve të shumta të përfshira të qëndrueshmëria, një theks i veçantë i jepet:
 - Zhvillimit njerëzor dhe kohezionit social, ku qytetarët shqiptarë janë në qendër të zhvillimit në një shoqëri të lirë, demokratike, shoqërisht përfshirëse, kohezive, të shëndetshme, të sigurt dhe të drejtë, që respekton të drejtat themelore të njeriut, të drejtat qytetare, dhe që hedh poshtë të gjitha format e diskriminimit.
 - Ruajtja e mjedisit, nëpërmjet promovimit të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm, parandalimit të degradimit mjedisor, zbrazjes së burimeve ujore, integritit të çështjeve mjedisore në të gjitha strategjitë sektoriale, dhe gjithashtu edhe në nocionin e përgjegjësitë sociale të korporatave dhe në përdorimin e parimit parandalues në aktivitetet e planifikuara.
 - Pjesëmarrja dhe konsultimet, ku qytetarët, shoqëria civile dhe sektori privat marrin pjesë ose konsultohen në vendimmarrjen e politikave dhe ku dialogu social promovohet dhe nxitet.
 - Informacioni dhe njohuritë që përdoren: si një faktor zhvillimi, si bazë për vendimmarrje të mbështetur në evidenca.
 - Realizueshmëria. Të gjitha iniciativat e planifikuara të zhvillimit të jenë ekonomikisht, shoqërisht, financiarisht dhe në pikëpamje të mjedisit të shëndosha, të realizueshme, dhe me kosto efikase. Shqipëria dhe institucionet e saj të kenë kapacitetet e nevojshme për zbatimin, thithjen dhe për operacione të vazhdueshme, mirëmbajtje dhe monitorim, me një normë kthimi të dukshme të investimeve.
2. Parimet e sipërmarrjes. Aspiratat e Shqipërisë për integrim në BE dhe për zhvillim kombëtar duhen realizuar me anë të novacioneve, konkurrueshmërisë dhe përqëndrimit të puna dhe rezultatet – si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Të gjitha këto mund të shihen në zbatimin e parimit të sipërmarrjes: së pari në një qeverisje të modernizuar, ku fokusi i vihet ofrimit të

shërbimeve publike me kosto efikase në një klimë stabiliteti makroekonomik dhe fiskal; dhe së dyti, në një sektor privat të gjallë i cili nxit rritjen ekonomike të barabartë dhe diversifikimin e prodhimit dhe begatinë, që kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të vendit.

3. Parimet e qeverisjes së mirë. Institucione të forta dhe efikase të qeverisë janë themeli i Shqipërisë për konkurrueshmëri, rritje dhe qëndrueshmëri. Ata janë thelbësorë për anëtarësim në BE. Të gjitha funksionet e qeverisë në lidhje me politikën, programimin dhe ofrimin kryen në mënyrë transparente, llogaridhënëse, dhe të parashikueshme. E gjithë politika bashkërendohet dhe integrohet nëpërmjet SKZHII dhe instrumenteve dhe mekanizmave të lidhura të tilla si, Sistemi i Planifikimit të Integruar dhe qasja sektoriale e buxhetit, dhe u nënshtrohet mekanizmave funksionalë të monitorimit dhe vlerësimit. Vullneti politik i Shqipërisë në të gjitha nivelet, në arritjen e qëllimeve të integritetit dhe zhvillimit kombëtar, përkthehet në angazhim dhe veprime të rëndësishme, një administratë publike dhe shërbim civil modern dhe profesionist, në vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe ofrimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes efikase.

3.6. Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

Reforma administrativo-territoriale si një nga prioritetet më të rëndësishme, u hartua në një proces gjithëpërfshirës dhe u miratua me ligjin 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi kryesor dhe përfundimtar i reformës administrative territoriale është rritja e efikasitetit të administratës lokale, cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve si dhe zhvillimi i drejtë i territorit duke mundësuar burime më të mëdha njerëzore dhe financiare, duke shtuar përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal dhe duke u orientuar drejt një vendimmarrjeje më transparente dhe me më shumë pjesëmarrje.

Strukturat e dekoncentruara

Reforma administrative do të rikonfigurojë marrëdhëniet e bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe strukturave të dekoncentruara të qeverisjes qendrore. Do të synohet përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional si dhe eliminimi i mbivendosjeve funksionale dhe të kompetencave. Gjithashtu do të synohet saktësimi dhe kalimi gradual i kompetencave në funksionet e përbashkëta. Rishikimi i rolit të prefektëve kundrejt monitorimit dhe kontrollit të ligjshmërisë të organeve të qeverisjes vendore do të respektojë parimet e Kartës Evropiane të Qeverisjes Vendore. Në këtë aspekt do të ndërmerren disa ndërhyrje si: (i) rishikimi i ligjit për prefektët (ii) rishikimi i legjislacionit aktual të funksioneve dhe kompetencave të njësive të dekoncentruara në arsim, shëndetësi, rendin publik, sistemin e kujdesit social, turizëm, etj., në mënyrë që të identifikohen fushat ku ka mbivendosje ose përplasje të kompetencave; dhe (iii) hartimi i matricës së qartë të kompetencave për çdo sektor, ku do të bëhet harta e përgjegjësive duke filluar nga identifikimi, programimi, zbatimi dhe monitorimi e kontrolli i performancës të cilësisë së shërbimeve.

Funksionet e qeverisjes vendore pas reformës administrative-territoriale do ti nënshtrohen një rishikimi me qëllim ripërcaktimin e përgjegjësisë së autoriteteve vendore mbi funksionet e veta dhe të përbashkëta që do të miratohen nga ligji i ri organik i qeverisjes vendore. Megjithatë decentralizimi si një proces në vazhdim do të synojë alokimin e funksionet të reja edhe me ligje sektoriale, por duke aplikuar parimin e analizës funksionale dhe financimin e plotë të funksionit përpara decentralizimit të tij.

Qeverisja vendore do mund të refuzojë funksionet që synohen ti decentralizohen me ligje sektoriale nëse nuk ka një analizë funksionale dhe financim të plotë të funksionit. Ligji i ri organik për qeverisjen vendore do të përmbajë për herë të parë edhe parimin e decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e subsidiaritetit. Ato njësi vendore që kanë kapacitete njerëzore dhe burime financiare mund të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara brenda funksioneve të përbashkëta apo dhe funksioneve të tjera që ushtrohen nga organet e qeverisë qendrore duke synuar ofrimin e shërbimeve në një standard më të lartë.

Sikurse dhe Bashki të tjera në territor, Bashkia Fushë-Arrëz ka pësuar rritje të sipërfaqes së saj në administrim. Procesi i decentralizimit dhe qeverisjes sidomos në Bashkinë e Fushë-Arrëzit, ka shtruar disa problematika menaxhimi për shkak të kapacitetit të stafit më të vogël në krahasim me sipërfaqen territoriale në administrim.

Element i rëndësishëm që kërkon vëmendje në sqarimin e politikës së implementuar në këtë Bashki është administrimi i sipërfaqeve pyjore të cilat kanë nevojë për definim të saktë të Bashkisë me kufitarët e saj.

3.7. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015 – 2020

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitave dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi 85 % për këto Direktiva. Është plotësuar kuadri ligjor kombëtar nëpërmjet hartimit dhe miratimit prej vitit 2006 të një numri ligjesh të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit që transpozojnë direktivat e sipërpërmendura si: Ligji “Për mbrojtjen e faunës së egër”, Ligji “Për gjuetinë”, Amendimi i Ligjit “Për zonat e Mbrojtura”, Ligji “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”, amendimi i Ligjit “Për biodiversitetin” si dhe një numër aktesh nënligjore në zbatim të tyre. Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike është synuar përmes rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura nga 10, 4 % ose 303 mijë ha të territorit të vendit në vitin 2007 në 16, 61 % ose 477 mijë hektarë në fund të vitit 2014 nëpërmjet shpalljes së Zonave të reja të Mbrojtura si dhe zgjerimit të atyre ekzistuese duke kontribuar në sigurimin e statusit të favorshëm të ruajtjes duke siguruar ruajtjen dhe mbijetesën e llojeve.

Është realizuar përgatitja e Planeve të Menaxhimi për 10 Zona të Mbrojtura dhe është në përfundim procesi i përgatitjes për 10 Zona të Mbrojtura të tjera. Është realizuar zbatimi në praktikë i planeve të menaxhimit të miratuara dhe ndërtimi e forcimi i kapaciteteve të administratave të zonave të mbrojtura, kryesisht në ato zona të mbrojtura në të cilat zbatohen projekte të donatorëve si: Liqeni i Shkodrës, Parku Kombëtar Prespë, Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parku Kombëtar

Detar Sazan-Karaburun etj. Gjithashtu është miratuar metodika standarte për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Sfidat për të ardhmen përfshijnë përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrejtës Natura 2000 të zonave të veçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian.

Zbatimi i planeve të menaxhimit për ato Zona të Mbrojtura që kanë plane të miratuara. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe ngritja e kapaciteteve administrative të stafit të administratave të zonave të mbrojtura dhe organeve të kontrollit për ruajtjen e florës dhe faunës së egër përbëjnë prioritet. Në fillim të vitit 2015 u miratua krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Me këtë organizim dhe funksionim është arritur që për herë të parë në Shqipëri të ketë një strukturë të veçantë dhe të shkëputur nga DSHP për Zonat e Mbrojtura që synon të sigurojë një menaxhim të pavarur të tyre. Administratat e zonave të mbrojtura me krijimin e AKZM do të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Mjedisit, si një agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës. Krijimi i kësaj agjencie krijon premisa për akses më të lehtë dhe vizibilitet të administrative të zonave të mbrojtura, duke mundësuar aplikimin e drejtpërdrejtë dhe menaxhimin direkt të fondeve nga ky institucion.

Një nga objektivat e realizuara të politikës në sektorin pyjor, nëpërmjet programeve të realizuara është arritur transferimi i pyjeve dhe kullotave drejt 315 njësive të qeverisjes vendore për të siguruar gjithë përfshirjen duke i mbështetur ato me plane menaxhimi dhe punime pyllëzimi dhe përmirësimi në pyje. Sipërfaqja fondit pyjor kullor e mbuluar me plane mbarështimi deri në vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga punimet pyjore të kryera në 12.000 ha pyje të degraduar, erozioni është reduktuar me rreth 200.000 ton sedimente. Për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme nga ana e strukturave të Policisë Pyjore me masat e marra janë ulur niveli i prerjeve të paligjshme në pyje, nga 8% në vitin 2007 në 55 % në vitin 2011. Sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve aluvionale bregdetare po eliminohen çdo vit si rezultat i erozionit bregdetar i cili është mjaft aktiv.

Sfidat për të ardhmen. Objektivat e ardhshëm do të jenë:

- përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian në fushën e pyjeve dhe kullotave;
- rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve komunale nëpërmjet granteve konkurruese dhe forcimit të kapaciteteve;
- përmirësimi i sistemit të informacionit dhe data bazës pyjore;
- forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje;
- përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive;
- aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend,
- përfshirja e çështjeve të ndryshmeve klimatike në të gjithë aspektet e administrimit të menaxhimit të fondit pyjor.

Pyjet në Bashkinë e Fushë-Arrëzit zënë një vend të rëndësishëm në grupin e burimeve natyrore. Territori i Bashkisë konsiderohet si një territor me masive të pasura pyjore dhe me kullota. Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe inproduktive zë rreth 80% të sipërfaqes. Pyjet dhe kullotat ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme. Banorët e zonave rurale e kanë të lidhur jetesën ngushtë me këto pasuri natyrore.

Tradicionalisht, pyjet dhe kullotat në afërsi të fshatrave apo qendrave të banuara janë përdorur për prodhim dru zjarri, lëndë ndërtimi, kullotë dhe prodhim të hazës ushqimore për blegtorinë, etj. Pyjet janë administruar në fomra të ndryshme, por ka qenë traditë shfrytëzimi për material drusor për plotësimin e nevojave të drurëve të tharë, të shtrëmbër dhe të prapambetur (të degraduar), duke ruajtur kështu vazhdimësinë e pyllit. Gjatë viteve të tranzicionit ato janë shfrytëzuar në mënyrë të pakontrolluar, me pasojë dëmtimin dhe degradimin e masiveve pyjore. Lënda drusore u bë objekt fitimprurës i kontrabandës nga persona e kompani të papërgjegjshme. Gjithashtu, rënia e zjarreve të shpeshta ka kontribut në vet negativ. Sot pyjet dhe kullotat janë të dëmtuara rëndë dhe kanë prodhimtari të ulët. Në këto sipërfaqe është prishur ekuilibri ekologjik dhe ka filluar erozioni, rreshqitjet, përmbytjet, rritja e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, apo inpaktin negativ në klimën e zonës në përgjithësi. Shtresa e sipërme e tokës është dëmtuar dhe gërryhet vazhdimisht, kafshët e egra në pyll janë pakësuar. bimët mjekësore janë të pakta dhe të zhvilluara dobët, ndërsa shkurret po bëhen gjithnjë e më të vogla dhe degëzat e tyre marrin formë gjëmbore. Rrjedhimisht pyjet dhe kullotat, apo pjesë të tjera të degraduara kanë nevojë të permiresohen.

Një aspekt pozitiv që vihet re vitet e fundit është se sa vjen dhe po rritet interesi i komunitetit për menaxhimin më të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave duke synuar tek agro-pylltaria (në një pyll shumë-funksional) që do të thotë që në pyllin e tyre banorët të kenë sa më shumë lloje dru pyjor dhe frutor të harmonizuar së bashku për plotësimin e nevojave të tij. Një prioritet është zëvendësimi i haloreve duke iu përshtatur terrenit dhe klimës me dushqe të cilët më vonë mund të përdoren mjaft mirë për bazë ushqimore për blegtorinë, dru zjarri dhe për mbrojtjen e tokës nga erozioni kryesisht në shpatinat që ndodhen mbi zonat e banuara.

Sipas VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- Komunave/Bashkive" sipërfaqja totale e masiveve pyjore të të gjithë kategorive është rreth 48.000 ha ose rreth 90% të sipërfaqes së përgjithshme të Bashkisë Fushë - Arrëz .

Pavarësisht se brenda territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz nuk ka zona të mbrojtura natyrore ekzistuese, zona Masivi i Krrabit dhe Kunore Dardhë kanë potenciale për propozimin e tyre si zona të mbrojtura natyrore.

Në lidhje me zonën "Masivi i Krrabit", Bashkia Fushë-Arrëz propozon që të kthehet në zonë e mbrojtur natyrore si vazhdim i zonës së mbrojtur "Mali i Munellës", të propozuar nga PPV Pukë, kjo për faktin se në këtë masiv gjendet një shumëllojshmëri e bimëve, frutave të pyllit, si edhe kafshëve të egra. Me rëndësi është specia e mbrojtur me ligj, Rrëqebulli (Macja e Ballkanit), i cili gjendet në këto masive. Me rëndësi për zhvillimin ekonomik për banorët është edhe shumëllojshmëria e frutave të pyllit si: boronicë, dredhëza (luleshtrydhe), kërpudha, mjedër, kulumri, etj.

Në lidhje me masivin "Kunorë Dardhë", Bashkia Fushë-Arrëz propozon kthimin e saj në zonë të mbrojtur pasi sot është zonë e pashfrytëzuar, pa infrastrukturë rrugore që e përshkon, si dhe me një inventar lënde drusore në sasi të konsiderueshme dhe të shumëllojshme , ku mbizotëron bredhi si dhe më pak lisi, gështenja dhe pisha. E veçantë është shumëllojshmëria e botës shtazore, ku përmendim speciet e rralla si : Kaprolli, Macja e Egër dhe Ariu i Murrme, ndërsa specie të shumta në numër mund të përmendet: Ujku, Dhelpra, Lepuri, Derri i Egër, si edhe një shumëllojshmëri shpendësh shtegëtar.

Referuar VKM r. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen Zonë e Mbrojtur të Monumenteve të Natyrës

Shqiptare" në Bashkinë Fushë-Arrëz, monumentet e natyrës të cilat kanë status mbrojtje(Kategoria III) listohen si më poshtë:

1. Gështenjat e Kokdodit
2. Qarret e varrezave të Shënkollit
3. Qarri i Xhamisë së Kryeziut
4. Ujëvara e Kryeziut
5. Karsti i Munellës
6. Pisha e Dardhës
7. Pisha e Shejzës.

Referuar studimeve gjeologjike të fundit të kryer nga Instituti i Gjeologjisë dhe Minierave në zonat si Bugjon (Njësia Administrative Fierzë), Marinaj (Njësia Administrative Qafë- Mali) dhe Dardhë (Njësia Administrative Blerim), rekomandimi përfundimtar i specialisteve është që në këto zona ka rrezik të përhershëm të rrëshqitjeve të dheut. Lagjja Palaj në Dardhë është konsideruar e pa banueshme duke rekomanduar shpërnguljen e banorëve rezident dhe moslejimin e ndërtimeve të reja. Është e nevojshme që në PPV kjo zonë të mos parashikohet si zonë banimi. Përsa i përket zonave të tjera, ka fenomene si rrëshqitje, vidhisje dhe erozion agresiv.

Në zonën e Poravit në Njësinë Administrative Fierzë, janë problematike rrëshqitjet e vogla të shpërndara pothuajse në të gjithë territorin e fshatit. Shkaqet e këtyre rrëshqitjeve janë pjerrësia e shpaleve, vërshimi i ujërave sipërfaqësor, braktisja prej migrimit të banorëve etj.

Në territorin Tuç-Qafë Bari vërehen vidhisje të vogla të dukshme si pasojë e punimeve nëntokësore horizontale të kryera në kohë të ndryshme për nxjerrjen e mineraleve të bakrit. Në ditët e sotme punimet nuk vazhdojnë më dhe këto zona janë dëmtuar, pasi janë të pambrojtura dhe të pa armuara.

3.8 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2020

Vizioni Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare.

Turizmi luan një rol kryesor në ekonominë shqiptare, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për investimet dhe hapjen e vendeve të punës. Zhvillimi i turizmit do të shkojë në përputhje me objektivat dhe strategjitë e sektorëve të tjerë që kushtëzojnë dhe ndikojnë direkt dhe indirekt zhvillimin dhe cilësinë e shërbimeve turistike. Harmonizimi në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) do të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe një strategji të arritshme.

Turizmi i qëndrueshëm shqiptar luan një rol të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike dhe sociokulturore, të rritjes së të ardhurave dhe krijimit të vendeve të reja të punës dhe është një kontribues i rëndësishëm për reputacionin ndërkombëtar të Shqipërisë, bazuar në marketingun intensiv të produkteve turistike të Shqipërisë, markave të njohura ndërkombëtarisht dhe me vlerë të

lartë të shtuar.

3.9 Deklarimi i politikës dhe vizioni

Qeveria synon mbështetjen e turizmit si një sektor i rëndësishëm i integruar ekonomik me karakteristika të thella kulturore, ndër-sektoriale, ndër-rajonale dhe i një niveli të lartë ndikimi social. Turizmi është tashmë një sektor me ndikim të madh social dhe ekonomik që synon të plotësojë kërkesat e qytetarëve shqiptarë dhe turistëve të huaj për vizita kulturore, kohën e lirë, shëndetin dhe sportin, akomodimin, ushqimin dhe argëtimin, etj., duke ndryshuar pozitivisht strukturën ekonomike, duke krijuar vende të reja pune me një treg pune tërheqës, të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe të ardhura të konsiderueshme, si dhe duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Parimet kryesore të strategjisë dhe politikave bazë në fushën e turizmit janë:

- Vlerësimi i turizmit si sektor strategjik dhe prioritar i ekonomisë, me ndikim të lartë social dhe komunitar;
- Mbrojtja dhe respekti ndaj mjedisit janë kriteret të panegociueshme të çfarëdo planifikimi dhe zhvillimi në sektorin e turizmit;
- Mbështetja e turizmit duke krijuar kushte të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tij;
- Sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit duke krijuar kuadrin e plotë të ligjeve dhe rregulloreve dhe zbatimi i një procesi të koordinuar planifikimi për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin dhe strukturat sociale;
- Përcaktimi i drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, me fokus në produktin e turizmit bregdetar, produktin e turizmit kulturor dhe produktin e turizmit natyror;
- Krijimi i imazhit të favorshëm të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik; - Krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve dhe ofruesve të shërbimeve turistike;
- Sigurimi i zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit, parashikuar edhe në MSA;
- Mbështetja e shoqatave dhe organizimeve vullnetare të subjekteve të veprimtarisë turistike në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- Përfshirja aktive e qeverisjes vendore në zhvillimin e turizmit në nivel lokal dhe rajonal (destinacioni) dhe krijimi i kushteve për jetësimin e këtij kontributi;
- Zbatimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit të lidhur ngushtë dhe në ndërveprim e simbiozë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Planin e Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Politikat strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, Strategjinë e Transportit, Politikat strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, Kulturën dhe Turizmin Kulturor dhe çdo strategji tjetër kombëtare e sektoriale që ka ndikim në zhvillimin e turizmit.

Konkretisht, kjo çështje mbi zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Bashkinë Fushë-Arrëz lidhet me objektivin strategjik nr.3 në vizionin e të ardhmes për Fushë-Arrëzin.

4. PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE

4.1 Të dhëna socio-demografike

Bashkia	Njësia Administrative	Popullsia / Njësi Administrative
Fushë-Arrëz	Fushë-Arrëz	2513
Fushë-Arrëz	Blerim	913
Fushë-Arrëz	Fjerzë	1302
Fushë-Arrëz	Iballë	1129
Fushë-Arrëz	Qafë-Mali	1548
Total		7405

Tabela 1 Popullsia e Bashkisë Fushë-Arrëz

Bashkia e Fushë-Arrëzit ka një popullsi prej 7405 banorësh, me një densitet prej 13.70 banorë/km²

Pavarësisht se popullsia sipas Censutit rezulton se ka një popullsi prej 7.405 banorësh, sipas Regjistrat Civil, kjo Bashki numëron 11.498 banorë. Bashkia ka një densitet popullsie në territorin e saj prej 21.55 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 13.70 banorë/km² sipas Censutit 2011.

Popullsia në raport me sipërfaqen e re të Bashkisë pas reformës territoriale, e cila shkon në 59 682 ha, ka një dendësi shumë të ulët. Kjo për efekt të faktit që Bashkia karakterizohet kryesisht nga pyje sesa vendbanime të dendura në të.

Popullsia e bashkisë ka një tendencë për tu larguar nga territori i saj duke zhvilluar përgjithësisht një rritje të saj në periudhën e verës dhe të pranverës ku Fushë-Arrëzi për efekt të sistemit natyror tërheq turistë të huaj dhe lokal si tranzit në territorin e tij.

Kjo lëvizje e popullsisë sjell dhe konsolidimin e shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe personel lokal që do të ketë nevojë ti orientojë ato dhe vetë popullsinë lokale drejt përmirësimit turistik të Bashkisë.

Në këto kushte, duke parashikuar dhe kthime në përdorimin e disa vendbanimeve ekzistuese në formën e guest houseve dhe të bujtinave parashikohet një rritje e vogël e popullsisë deri në 10-15%, që do të thotë që parashikohet të shkojë deri në 13 000 banorë në vitin 2030.

4.2.1 Kopshtet, shkollat 9-vjeçare, shkollat e mesme.

Mbulimi i shërbimit është i llogaritur në bazë të popullsisë së territorit të Fushë-Arrëzit si dhe në bazë të aksesibilitetit të këtyre zonave, duke specifikaur rrezet e mbulimit sipas llojit të shërbimit si më poshtë:




Vitet e fundit janë marrë masa për ndërhyrje në të gjithë infrastrukturën arsimore të Bashkisë Fushë-Arrëz. Disa prej të cilave kanë pasur vetëm ndërhyrje restauruese, dhe një pjesë më e vogël, për shkak të degradimit të strukturës, është parë e nevojshme ndërtimi i godinave të reja.

Ndërhyrjet në infrastrukturën arsimore kanë të bëjnë më përmirësimin e kushteve në ambientet ekzistuese dhe përmirësimin e aksesit kryesisht në zonat rurale kryesisht për përmirësim e aksesit gjatë stinës së dimrit ku ka probleme në lëvizje.

4.2.2 Qendrat Shëndetësore

Edhe qendrat shëndetësore kanë një mbulim të ulët, madje të papërfillshëm në territorin e tyre. Vendbanimet e largëta bëjnë që qendra kryesore e Bashkisë të jetë vetëm në qytet, ndërkohë në disa fshatra ato mbulohen vetëm nga klinika të vogla.



Harta 2 Harta me Institucionet Shëndetësore

Ndërkohë për ndihmën spitalore Bashkia del jashtë territorit të saj të administrimit për të marrë shërbimin përkatës.

PPV Fushë-Arrëz propozon rregullimin e rrjetit ekzistues të qendrave shëndetësore duke ndërhyrë në përmirësimin e infrastrukturës së ndërtesave ekzistuese.

Mbulimi i shërbimit është llogaritur duke parë gjëndjen ekzistuese në territor si dhe aksesibilitetin nga ana e popullsisë në këto territore.

5.ORIENTIME NGA DOKUMENTAT E PLANIFIKIMIT

Në këtë kapitull do të bëjmë një përmbledhje të të gjitha orientimeve dhe konkluzioneve që kemi përfutur nga dokumentat e planifikimit. Duke përfshirë lidhjet rajonale të Fushë-Arrëzit, pozitën e Bashkisë Fushë-Arrëz në raport me programin IPA II, direktivat që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, raporti i Bashkisë Fushë-Arrëz me “PINS Bregdeti” dhe “PINS Durana”, gjithashtu më poshtë do të paraqiten dhe konkluzionet e arritura nga PPV-të e Bashkive Kukës, Mirëditë, Pukë, Vau i Dejës, Tropojë, tashmë të miratuara.

5.1 Fushë-Arrëzi në lidhjet rajonale

Bashkia Fushë-Arrëz ka pozicion strategjik shumë të favorshëm në lidhje me rrjetin pan europian. Kjo pasi është pjesë e Qarkut Shkodër dhe kufizohet në veri nga Bashkia e Tropojës nga ku ka dalje për në Gjakovë, në lindje me Bashkitë Fushë-Arrëz dhe Kukës ku nëpërmjet korridorit kombëtar Durrës – Kukës – Morinë ka dalje në Prizren, në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës dhe në jug me Bashkitë Pukë dhe Mirditë ku nëpërmjet aksit rrugor Pukë-Vau i Dejës- Shkodër ka dalje në Podgoricë, i mundëson që nëpërmjet Prishtinës ose Podgoricës të lidhet me Korridorin X pan – europian. Ky korridor është shtylla kurrizore e rrjetit rrugor dhe hekurudhor të europës jug-lindore, si një korridor që lidh shtete si : Austria, Hungaria, Sllovenia, Kroacia, Sërbia, Bulgaria, Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Ky akses kaq i afërt me shtetet fqinje dhe europën e vendos Fushë-Arrëzin në një pozitë të favorshme për këmbimet ndërkombetare, ekonomike, social-kulturore, etj. Avantazh tjetër për Fushë-Arrëzin është dhe afërsia me aeroportin e Kukësit, i cili me vendosien në funksionim të plotë të tij, përbën një mundësi shumë të mirë për lidhjen e Fushë-Arrëzit me Europën dhe më gjërë.

5.2 Fushë-Arrëzi në programin IPA II

Bashkia e Fushë-Arrëzit nuk është drejtpërdrejtë pjesë e bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të programit IPA, por ndodhet midis dy grupeve, atij të Kukës-Prishtinë dhe Shkodër-Podgoricë. Aspekt avantazhues për Bashkinë Fushë-Arrëz kundrejt përfitimit të fondeve të programit IPA, për bashkëpunimin ndërkufitar, është dhe fakti që në kufi ka shtete dhe shqip folëse gjë e cila e bën më të thjeshtë bashkëpunimin dhe bashkërendimin për projekte të përbashkëta, kjo si pasojë e kulturës së njëjtë, traditës, historisë dhe perspektivës së përbashkët që këto treva kanë me njëra-tjetrën.

5.3 Fushë-Arrëzi sipas PPV-së Pukë, PPV-së Kukës, PPV Tropojë, PPV-së Mirëditës dhe PPV-së Vau i Dejës.

Mbështetur në vizionin strategjik të secilës prej Bashkive kufitare me Bashkinë Fushë-Arrëz, ngjashmëria e pozitës gjeografike, formës dhe resurseve territoriale, ka rezultuar në propozime që trajtojnë të njëjtat problematika që Fushë-Arrëzi ka dhe në zhvillimin e Bashkisë Fushë-Arrëz. Këto plane janë një shembull shumë i mirë ku do të mund të referohemi për hartimin e vizionit strategjik, por dhe më tej, të PPV-së për Bashkinë Fushë-Arrëz.

Gjithashtu nga analiza e bërë vizioneve strategjike të këtyre Bashkive, vërehet edhe nevoja për krijimin e lidhjeve midis këtyre Bashkive dhe Fushë-Arrëzit në trajtimin e strategjisë territoriale. Mundësia që na krijohet për të parë këto lidhje na jep mundësinë për të shmangur gjatë trajtimit të strategjisë

territoriale për PPV-në e Bashkisë Fushë-Arrëz .

Në përfundim vërehet se ashtu si në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz, ashtu dhe në territoret e Bashkive Pukë, Kukës, Vau i Dejës, Mirëditë dhe Tropojë, ekziston nevoja për pasurimin e këtyre territoreve me shërbime dhe lehtësirat më elementare për të cilat banorët në këto Bashki kanë nevojë.

6.PËRCAKTIMI I TERRITORIT NË PESË SISTEMET DHE ANALIZA SWOT


Territori i Bashkisë, me qëllim të përgatitjes së PPV, është ndarë në pesë sisteme në përputhje me kërkesat refereruar VKM Nr. 686 dt. 22.11.2017 dhe të rregullores aktuale:

1. Sistemi Urban (UB)
2. Sistemi Infrastrukturor (IN)
3. Sistemi Natyror (N)
4. Sistemi Ujor (U)
5. Sistemi Bujqësor (B)

Këto sisteme nuk duhet të lexohen si komponentë të izoluara, por në ndërveprim të vazhdueshëm dhe lidhje midis tyre në një pespektivë të zhvillimit strategjik të territorit, në bazë të potencialeve, problemeve dhe nevojave të mundshme dhe specifike të cdo sistemi.

Sistemi	Ha	%
Sistemi Urban (UB)	5563.493	2.3%
Sistemi Infrastrukturor (IN)	273.4195	4.9%
Sistemi Natyror (N)	50543.2362	89.2%
Sistemi Ujor (U)	131.03237	0.5%
Sistemi Bujqësor (B)	1892.2550	3.1%

Tabela 2 Tabela me sipërfaqet e sistemeve territoriale



Sikurse spikat nga treguesit dhe nga leximi i vetë hartës, Territori i Bashkisë së Fushë-Arrëzit mbizotërohet nga sistemi natyror në pjesën më të madhe të tij, përkatësisht 89.2%. Pas tij mbizotëron sistemi i infrastrukturës dhe tokat bujqësore, megjithëse me një përqindje shumë të vogël territoriale.

Bashkia e Fushë-Arrëzit sikurse dhe Bashki të tjera të territorit të Shqipërisë mbizotërohet nga sistemi urban në qendrën e saj, në rastin konkret në qytetin e Fushë-Arrëzit, e cila është qendra

kulturore, shëndetësore, arsimore e Bashkisë. Qyteti sot ka një karakter urban, ndërkohë, njësitë administrative (më parë ish - komunat) dhe fshatrat përbërëse të tyre kanë një territor 100% rural duke bërë që në to të mbizotërojnë sistemi bujqësor dhe ai natyror.


6.1 SISTEMI URBAN

Në hapësirën gjeografike të administruar nga Bashkia Fushë-Arrëz gjenden të dy tipat e vendbanimeve, urbane dhe rurale. Nga pikëpamja administrative Bashkia Fushë-Arrëz ndahet në 5 njësi administrative përkatësisht:

- Njësia administrative Fushë-Arrëz e cila është dhe qendra administrative e Bashkisë, si dhe e vetmja njësi që mund të konsiderohet me karakter urban.
- Njësia administrative Qafë Mali është njësia territoriale e cila përmbledh të gjithë pjesën jugore të Bashkisë Fushë-Arrëz.
- Në kufi me Tropojën në pjesën veriore dhe veri-lindore, ndodhen 2 njësitë përkatësisht të Fjerzës dhe Blerimi.
- Edhe njësia administrative Iballë që kufizohet me Vaun e Dejës dhe me Tropojën sërish

Përveç 5 njësive kryesore administrative, në përbërjen e saj Bashkia ka 35 fshatra përkatësisht:

- Fushë- Arrëz
(Qyteti Fushë- Arrëz, Fshatrat: Fushë- Arrëz, Micaj, Lumëbardhë)
- Blerim
(Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë, Qebik)
- Fjerzë
(Fjerzë, Porav, Bugjon, Kokdodë, Arst, Miliska, Mëzi, Aprip- Guri)
- Iballë
(Iballë, Sapac, Levosh, Brishë e Vogël, Berishë Vendi, Berishë e Sipërme, Shopël, Mërtur)
- Qafë - Mali
(Qafë- Mali, Armiraj, Srriqë , Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuç, Kryezi, Orosh)



Harta 4 Harta e sistemit Urban

Vihet re që ka rikonstruksione dhe ndërtime të reja nga banorët, kryesisht, në fshatra gjatë dhjetvjeçarit të fundit. Ndërsa në qytetin e Fushë-Arrëzit ato janë të pakta. Këtu banorët jetojnë në godina të ndërtuara përpara viteve '90. Nevojat për strehim janë të mbuluara edhe si rezultat i

migracionit të madh brenda dhe jashtë vendit. Por, problematike është çështja e cilësisë së godinave. Ndërtesat e banimit janë të amortizuara dhe nuk mirëmbahen.

Duke qenë se disa janë braktisur, por edhe ato që banohen nuk mirëmbahen, godinat janë dëmtuar rëndë. Disa ju kanë rënë çatitë, ndërsa disa të tjerave po ju thërmohen tullat për shkak të lagështirës. Së pari, kjo situatë është e rrezikshme për jetën e atyre që banojnë në to dhe së dyti krijon një pamje estetike të pakëndshme për qytetatrët. Hapësirat ndërmjet pallateve janë zënë nga stivat e druve për dimër. Nuk ka hapsira të gjelbëruara, ambjente çlodhëse për moshën e tretë, apo parqe lodrash për fëmijët.

Plani i fundit rregullues i qytetit të Fushë-Arrëzit daton përpara viteve '90.

Në përfundim të analizës së gjëndjes ekzistuese në këtë territor mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit urban:

Anët e forta

- Zonat urbane zhvillohen në raport me sistemin natyror i cili rrit cilësinë e ajrit dhe të jetesës në to.
- Fushë-Arrëzi shihet si një potencial turistik sezonal i cili në qendrat urbane dhe rurale të tij mund të akomodojë turistët.

Dobësitë

- Shpërndarja e vendbanimeve larg njëra tjetrës.
- Mungesë në ofrimin e shërbimeve.
- Cilësi e ulët shërbimesh në zonat rurale.

Mundësitë

- Bashkëpunim ekonomik dhe social në nivel rajonal dhe ndërkufitar.
- Zbatimi / Programim i ndërhyrjeve të rëndësishme të rigjenerimit urban që rrisin funksionin dhe imazhin e qytetit dhe të vetë zonave rurale.
- Zbatimi / Programim i Infrastrukturës sociale që përmirësojnë jetën shoqërore dhe mundësitë rekreative.
- Zbatimi / Rritja e mundësive të guest houseve duke rritur ciësinë e shërbimeve ekzistuese.

Kërcënimet

- Fenomeni i emigrimit.
- Tendenca e të rinjve për të braktisur zonën.

6.2 SISTEMI BUJQËSOR


Nga analiza e bërë mbi propozimet dhe qasjen e PPK-së në lidhje me sistemin bujqësor të Fushë-Arrëzit rezulton se kjo Bashki futet në grupin e Bashkive prioritare në lidhje me bujqësinë edhe pse pozita gjeografike që ka dhe terreni kodrinoro-malor e bën që sipërfaqja e punueshme të jetë shumë e vogël. Nga statistikën, qarku i Shkodrës ku përfshihet dhe Bashkia e Fushë-Arrëzit, është qarku me nivele të lartë të prodhimit bujqësor në shkallë vendi. Gjithsesi direktivat e PPK-së janë që në të gjitha rastet toka bujqësore të ruhet dhe zhvillohet duke shfrytëzuar në maksimum potencialin që kjo zonë ka për zhvillimin e bujqësisë.

Bujqësia dhe blegtoria janë një komponent i rëndësishëm i ekonomisë dhe përbëjnë aktivitetin bazë për popullsinë. Afërsisht 70-80 % e familjeve që jetojnë në fshat kanë si burim të vetëm jetese të ardhurat që sigurojnë nga toka bujqësore dhe blegtoria. Pjesa tjetër e popullsisë fshatare ka si burim të ardhurat nga emigracioni i pjesëtarëve të familjes ose ndonjë aktivitet tjetër privat.

Prodhimi bujqësor dhe blegtoral, në masën 80%, përdoret për konsum familjar dhe shumë pak nga ky prodhim nxirret në treg. Nga analiza e treguesve të prodhimit bujqësor e blegtoral del se ato janë nën nivelin e potencialeve prodhuese që ka zona. Këto potenciale që mund të garantojnë një zhvillim më të madh të kësaj dege të ekonomisë janë ekzistenca e zonave dhe mikrozonave të veçanta klimatike që krijon mundësi për diversitet prodhimi, zgjidhja përfundimtare e problemeve të pronësisë mbi tokën, ekzistenca e fuqisë punëtore relativisht e lirë, dhe mbështetja e duhur financiare dhe teknike.

Zona ka traditë të hershme në pemtari dhe vreshtari. Si pemë të veçuara mbillen qershia, kumbulla, molla, arra dhe gështenja (në brigjet e përrenjëve), mani, dardha dhe pjeshka. Përgjithësisht rendimenti është i ulët prej rreth 22 kg/rrënjë, por ka një interes në rritje tek banorët. Gjithashtu, ata kanë eksperiencë në kultivimin e pjergullave në fundet e arave dhe kopshteve ose në krijimin e tendave të rrushit në oborre dhe prodhimi përdoret për konsum familjar, përfshirë edhe prodhimin e verës dhe rakisë.

Blegtoria jep, afërsisht, 60 % të prodhimit bujqësor-blegtoral dhe jep qumështin, leshin, vezët dhe mishin. Por prodhimi ka një rendiment të ulët. Produktet dhe nënproduktet blegtorale plotësojnë një pjesë të madhe të nevojave ushqimore të popullsisë në Fushë-Arrëz. Produktet dhe nënproduktet blegtorale shpesh nuk i plotësojnë disa kushte optimale për të dalë në treg siç janë freskia, pastërtia mikrobike e bakteriale, pastërtia nga mbetjet e ndryshme kimike, ambalazhimi, etiketimi dhe çertifikimi, etj. Një rol të rëndësishëm në tregëtimin e produkteve dhe nënprodukteve blegtorale luan infrastruktura rrugore, afërsia me tregun, etj. Gjë që terreni dhe gjendja aktuale infrastrukturore nuk e favorizon.



Harta 5 Sistemi Bujqësor

Larmia e kushteve dhe faktorëve gjeo-klimatike që ka sipërfaqja e Bashkisë Fushë-Arrëz ka kushtëzuar shumëllojshmërinë e tokave, të cilat, si në të gjithë vendin, ndryshojnë sidomos në drejtim vertikal. Në këtë drejtim dallohen tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore, ndërsa si nën tipa dallohen tokat aluvionale në luginat e lumenjve.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit bujqësor:

Anët e forta

- Kosto e lirë e krahut të punës.
- Tradita historike familjare në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe eksperiencia e përfituar në vite përbën një bazë të rëndësishme për sektorin.
- Akses për tregun ndër rajonal dhe vendet fqinje.

Dobësitë

- Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme bujqësore, mungesa e teknologjive të reja.
- Problemet me pronën dhe fragmentimi i saj.
- Efikasitet i ulët dhe prodhimtë për efekt të fragmentarizimit të tokës bujqësore dhe mungesa e kulturës së bashkëpunimit mes fermerëve.
- Mungesa e pikave të grumbullimit të prodhimeve bujqësore.
- Mungesa e promovimit të produkteve bujqësore dhe blegtoriale.
- Kostoja e lartë e prodhimit dhe rendimenti i ulët i prodhimit gjeneron norma të vogla fitimi.
- Përdorimi pa kriter i plehrave kimike apo i pesticideve ka shkaktuar humbje të produktivitetit të tokave.

Mundësitë

- Kërkesa e tregut për produkte BIO dhe të certifikuara.
- Bujqësia, një sektor me prioritet për qeverinë.
- Mundësi për zhvillimin e agrobizneseve nëpërmjet zhvillimit të agroturizmit.
- Interes në rritje për eksportin e bimëve medicinale dhe aromatike.
- Skema e subvencionit nga Ministria e Bujqësisë dhe donatorëve të huaj.

Kërcënimet

- Mungesa e aftësisë për të bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermerëve
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësi intensive dhe të integruar
- Fatkeqsi natyrore sidomos për efekt të shpyllëzimit
- Mungesa e politikave afatgjata në mbështetjen e sektorit të Bujqësisë;
- Kostoja e lartë e shpenzimeve të transportit
- Siguria ushqimore
- Konkurrenca rajonale nga importet

6.3 SISTEMI NATYROR

Territori i Bashkisë së Fushë-Arrëzit shtrihet në mes të zonës më të pasur me mineral bakri në vendin tonë, që janë të tipit vulkanogjenik. Ndër depozitat më të rëndësishme mund të përmendim ato të Perlatit, Munellës, Lak Roshit, Tuçit, Palucës, Qafë Barit, Gurthit 1,2,3, Spaçit, Kaçinarit, Dervenit, etj. Bakri konsiderohet si metali i dytë më i rëndësishëm në Shqipëri pas kromit, edhe pse vitet e fundit industria e tij është goditur nga rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe problemet e

brendshme të menaxhimit. Sipas të dhënave zyrtare, vitet e fundit eksportet shqiptare të bakrit janë luhatur nga 30 deri në 40 milionë dollarë në vit, pjesa dërmuese e të cilave - mbi 87 për qind - i përket prodhimit të Munellës.

Administrimi i pyjeve i ka kaluar tashmë njësive të qeverisjes vendore, por që kanë vështirësi në kryerjen e saj, për arsye të burimeve të pamjaftueshme financiare, stafeve, mjeteve, eksperiencës, etj. Ndërsa Ministria e Mjedisit, në linjë vertikale me Drejtorinë Rajonale në Shkodër dhe Sektorin Pyjor në Fushë-Arrëz kanë rolin e inspektimit dhe atë këshillimor në mbarëvajtjen e pyjeve. Por ndërkohë që njësitë e reja administrative nuk janë konsoliduar akoma, Sektori Pyjor i Fushë-Arrëzit ka reduktuar numrin e stafit nga 45 në 8 vetë, gjë që vështirëson realizimin e detyrave, duke mos përmendur këtu mungesën e mjeteve.

Një aspekt pozitiv që vihet re vitet e fundit është se sa vjen dhe po rritet interesi i komunitetit për menaxhimin më të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave duke synuar tek agro-pylltaria (në një pyll shumë funksional) që do të thotë që në pyllin e tyre banorët të kenë sa më shumë lloje drurësh pyjor dhe frutor të harmonizuar së bashku për plotësimin e nevojave të tyre. Një prioritet është zëvendësimi i halorëve duke ju përshtatur terrenit dhe klimës me dushqe të cilët më vonë mund të përdoren mjaft mirë për bazë ushqimore për blegtorinë, dru zjarri dhe për mbrojtjen e tokës nga erozioni kryesisht në shpatinat që ndodhen mbi zonat e banuara.

Ndërhyrjet për rigjenerimin e pyjeve janë bërë, kryesisht nga qeveria me mbështetjen financiare të donatorëve të huaj si Banka Botërore, apo Sida. Por duke qenë se fondet kanë qenë të pamjaftueshme ndërhyrja është përqëndruar kryesisht në çështjet më imediate si rehabilitimi i zonave të djegura, apo pyllëzimi i zonave të zhveshura. Por ndikimi i tyre ka qenë fare i vogël.

Për më tepër pozita gjeografike e tij bën që të jetë në mes të disa zhvillimeve në kontekstin natyror, të propozuara në PPK për këtë zonë. Bashkia e Fushë-Arrëzit kufizohet nga korridori natyror i propozuar në PPK, i cili parashikohet të jetë finalizuar deri në 2030. Ky korridor që shtrihet përgjatë kufirit verior të Bashkisë dhe shtrihet pjesërisht dhe në territorin e Fushë-Arrëzit në këtë zonë. Bën që Bashkia e Fushë-Arrëzit të ketë detyrim ligjor, i cili rrjedh nga PPK-ja, që të japë kontributin që i takon në realizimin e tij. Por nga ana tjetër dhe çka është më rëndësi, është interesi që Bashkia e Fushë-Arrëzit ka në realizimin e këtij korridori, nga i cili asaj do i shtohen vlerat dhe atraksionet natyrore.

Propozime të tjera të rëndësishme të PPK nga i cili Fushë-Arrëzi përfiton vëmendje dhe rritje të frekuentimit nga vizitorë, për pasojë dhe rritje të turizmit. Është itinerari i biçikletave, që nis nga liqenini i Fierzës, përshkon përmes territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe përfundon në Pukë. Një itinerar që është pjesë e rrjetit të rrugëve të biçikletave në hapësirat natyrore të gjithë Shqipërië. Propozim tjetër është dhe krijimi i itinerarit Vozitës, i cili lidh të gjithë qytetet bregdetare të shqipërisë me rrugë detare. Dhe vazhdon nëpërmjet grykëderdhjes së lumit Drin në Velipojë, drejt liqenit të Fierzës në Kukës, një itinerar gjatë së cilit përshkon thajse të gjithë kufirin verior të territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz. Nga ku Fushë-Arrëzi ka mundësi të bëhet pjesë e inegruar e guidave turistike që do të përfshijnë këtë itinerar.

Bashkia Fushë-Arrëz ka në territorin e saj mjaft zona, teritore e objekte që mund të klasifikohen si të rëndësise kombëtare referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014. Këtu mund të rënditen:

Zona të Mbrojtura historike

Monumente Kulture - Kategoria I

- Kalaja në Miçaj

- Kështjella e Fletit dhe gjurmët e rrugës për Prizren, në Flet
- Kalaja e Sakatit, në Trun
- Banesa e Stak Mash Binakut dhe e Martin Pjetër Binakut

Monumente Kulture - Kategoria II

- Banesa e Nikoll Preng Rrapit

Monumente Natyre - Kategoria II (shpallur me VKM Nr. 676, datë 20.12.2012);

Infrastrukturë rrugore kombëtare e kategorive të ndryshme:

- Rr. Fushë-Arrëz - Qafë-Qele
- Rr. Fushë-Arrëz - K/Fjerzë
- Rr. K/Fjerzë - Fjerzë
- Rr. Bardhet - Tuç - Q.Bari
- Rr. F.Arrëz - Iballë;

Infrastukturë kombëtare/lokale energjitike:

- Hidrocentrale;
- Linja transmetimi I 10kv, 220kv dhe 400kv;
- Stacione e nënstacione elektrike.

Zona minerare të pasura në Bakër si:

- Munella,
- Lak Roshi ,
- Tuç
- Qafë-Bari etj.

Bashkia Fushë-Arrëz ka një pozicion gjeografik favorizues, ky pasi ndodhet në qendër të veriut të Shqipërisë. Turizmi malor, i tipit të bujtinave familjare mbetet një potencial zhvillimi ku mund të ndiqet shembulli i bujtinave të Valbonës dhe të Thethit. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë mundësia e integritimit në sistemin e turizmit malor të zhvilluar në zonën e Alpeve. Fshati Kryezi është përzgjedhur së fundmi në projektin e Qeverisë Shqiptare .. "100 Fshatrat" pasi është një ndër zonat, ku turizmi mund të marrë hov përmes adaptimit të banesave tradicionale në shtëpi pritëse për turistët, përmes agro-turizmit , prodhimit të veshjeve tradicionale dhe mbi të gjitha për shkak të natyrës dhe pyjeve. Potencial në këtë fushë ruajnë edhe fshatrat Iballë dhe Dardhë.

Sipas VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- Komunave/Bashkive" sipërfaqja totale e masiveve pyjore të të gjithë kategorive është rreth 48.000 ha ose rreth 90% të sipërfaqes së përgjithshme të Bashkisë Fushë-Arrëz .

Pavarësisht se brenda territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz nuk ka zona të mbrojtura natyrore ekzistuese, zona Masivi i Krrabit dhe Kunorë Dardhë kanë potenciale për propozimin e tyre si zona të mbrojtura natyrore.

Në lidhje me zonën "Masivi i Krrabit", Bashkia Fushë-Arrëz propozon që të kthehet në zonë e mbrojtur natyrore si vazhdim i zonës së mbrojtur "Mali i Munellës", të propozuar nga PPV Pukë, kjo për faktin se në këtë masiv gjendet një shumëllojshmëri e bimëve, frutave të pyllit, si edhe kafshëve të egra. Me rëndësi është specia e mbrojtur me ligj, R.reqebulli (Macja e Ballkanit), i cili gjendet në këto masive. Me rëndësi për zhvillimin ekonomik për banorët është edhe shumëllojshmëria e frutave të pyllit si: boronicë, dredhëza (luleshtrydhja), kërpudha, mjedra, kulumria, etj.

Në lidhje me masivin "Kunorë Dardhë", Bashkia Fushë-Arrëz propozon kthimin e saj në zonë të mbrojtur pasi sot është zonë e pa shfrytëzuar, pa infrastrukture rrugore që e përshkon, si dhe me një inventar lënde drusore në sasi të konsiderueshme dhe të shumëllojshme, ku mbizotëron ashtu dhe bredhi si dhe më pak lisi, gështenja dhe pisha. E veçantë është shumëllojshmëria e botës shtazore, ku përmendim speciet e rralla si: Kaprolli, Macja e Egër dhe Ariu i Murrme, ndërsa specie të shumta në numër mund të përmendet: Ujku, Dhelpra, Lepuri, Derri i Egër, si edhe një shumëllojshmëri shpendësh shtegtare.

Referuar VKM r. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen Zonë e Mbrojtur të Monumenteve të Natyrës Shqiptare" në Bashkinë Fushë-Arrëz, monumentet e natyrës të cilat kanë status mbrojtje (Kategoria III) listohen si më poshtë:

8. Gështenjat e Kokdodit
9. Qarret e varrezave të Shënkollit
10. Qarri i Xhamisë së Kryeziut
11. Ujëvara e Kryeziut
12. Karsti i Munellës
13. Pisha e Dardhës
14. Pisha e Shejzës.

Referuar studimeve gjeologjike të fundit të kryer nga Instituti i Gjeologjisë dhe Minierave në zonat si Bugjon (Njësia Administrative Fierzë), Marinaj (Njësia Administrative Qafë-Mali) dhe Dardhë (Njësia Administrative Blerim), rekomandimi përfundimtar i specialistëve është që në këto zona ka rrezik të përhershëm të rrëshqitjeve të dheut. Lagjia Palaj në Dardhë është konsideruar e pabanueshme duke rekomanduar shpërnguljen e banorëve rezident dhe moslejimin e ndërtimeve të reja. Është e nevojshme që në PPV kjo zonë të mos parashikohet si zonë banimi. Përsa i përket zonave të tjera, ka fenomene si rrëshqitje, vidhisje dhe erozion agresiv.

Në zonën e Poravit në Njësia Administrative Fierzë, janë problematike rrëshqitjet e vogla të shpërndara pothuajse në të gjithë territorin e fshatit. Shkaqet e këtyre rrëshqitjeve janë pjerrësia e shpaleve, vershimi i ujërave sipërfaqësor, braktisja prej migrimit të banorëve etj.

Në territorin Tuç-Qafë Bari vërehen vidhisje të vogla të dukshme si pasojë e punimeve nëntokësore horizontale të kryera në kohë të ndryshme për nxjerrjen e mineraleve të bakrit. Në ditët e sotme punimet nuk vazhdojnë më dhe këto zona janë dëmtuar, pasi janë të pambrojtura dhe të pa armuara.

Anët e forta

- Burimet natyrore dhe biodiversiteti
- Peizazhet e pasura natyrore pyjore dhe panoramike
- Prania e parqeve natyrore dhe zona e Munellws si zonë me karakteristika të rëndësishme në botën e florës dhe faunës
- Turizmi i lidhur me këto elementë natyrorë

Dobësitë

- Mos mirëmbajtja e zonave natyrore
- Mungesa e sensibilizimit për vlerën e pasurive natyrore
- Shërbime me cilësi jo të mirë dhe mungesë të kapaciteteve pritëse
- Mungesa e bashkëpunimit mes autoriteteve publike dhe operatorëve turistike
- Ndotje mjedisore

Mundësitë

- Mundësi për zhvillimin e turizmit malor
- Mundësi për zhvillimin e turizmit pyjor
- Mundësi për krijimin e itinerareve vozitëse

Kërcënimet

- Ndotja
- Mungesa e kontrollit mjedisor
- Dëmtimi i pyjeve


6.4 SISTEMI UJOR

Bashkia e Fushë-Arrëzit është e pasur me burime ujore. Në fshatin Kryezi të njësisë administrative Qafë-Mali buron lumi Fan i Madh, që gjarpëron në krah të qytetit të Fushë-Arrëzit, dhe më tej në njësinë administrative Gjegjan, derisa bashkohet me lumin Fan i Vogël në perëndim të qytetit të Rrëshenit, dhe pas disa kilometrash bashkohet me lumin Mat. Ai ka vlera ekonomike dhe klimatiko-mjedisore, por që fatëkeqsisht, është ndotur nga derdhja e mbetjeve të fabrikës së pasurimit të bakrit në Fushë-Arrëz. Për shkak të natyrës së mbetjeve, që përmbajnë metale të rënda, përdorimi i ujit paraqet probleme, si për njerëzit ashtu edhe për florën dhe faunën. Gjithashtu, në të derdhen edhe ujrat e zeza të qytetit të Fushë-Arrëzit, si dhe ato të fshatrave përgjatë rrjedhës së tij. Si rezultat i burimeve ujore që zotëron, në Bashkinë e Fushë Arrëzit po ndërtohen edhe disa

hidrocentrale, relativisht të vegjël, por që mund të kenë një ndikim afatgjatë në ekosistemin përkatës.

Furnizimi me ujë të pijshëm i banorëve ka dy veçori, atë të furnizimit të qytetit të Fushë-Arrëzit dhe të fshatrave. Këto të fundit, për shkak të shtrirjes në territor dhe numrit relativisht të kufizuar të banorëve, në disa raste kanë rrjetet e tyre të furnizimit dhe disa të tjera furnizohen direkt nga burimet natyrore, apo nga puset. Qyteti i Fushë-Arrëzit furnizohet nga dy burime, ai i Krrabit dhe ai i Micojt, me gjatësi linje, përkatësisht, 7km dhe 3.5km, që shkarkohen në të njëjtin rezervuar.

Territori i Bashkisë të Fushë-Arrëzit nuk njihet për rrezikshmëri në lidhje me përmbytjet apo erozionet, të paktën jo në masën që sjellin probleme për zonat e banuara, bujqësinë, etj. Megjithatë nga harta e vlerësimit të këtyre rreziqeve konstatohet që ato janë të lokalizuara përgjatë lumenjve që rrjedhin nga malet drejt liqenit të Fjerzës. Përgjatë të cilëve vërehen dhe zona të banuara që preken në rate katastrofash natyrore apo vërshime të pazakonta të ujërave dhe erozionit. Prandaj duhet të merren masa, duke vlerësuar rrezikun potencial rregullisht dhe duke hartuar projekte dhe vepra për mbrijtje nga to kur është e nevojshme.



Anët e forta

- Prania e liqenit artificial të Fjerzës përbën një atraksion turistik për zonë
- Lidhja e liqenit të Fjerzës me Bashkitë kufitare në lëvizjen turistike dhe rajone të Bashkisë
- Afërsia e resurseve ujore me ato pyjore për shtimin e lëvizjeve turistike në to.

Dobësitë

- Ndotje nga derdhjet e patrajtuar
- Kontroli sanitar i nevojshëm për t'u përmirësuar dhe shtrirë në të gjithë sistemin
- Mungesa e infrastrukurës adekuate
- Mbrotje nga përmbytjet apo erozionet për ato zona që janë të lokalizuara përgjatë lumenjve
- Ndotje mjedisore

Mundësitë

- Investime për të përmirësuar mbulimin me shërbime
- Riorganizim i përpunimit të ujërave
- Mundësi për krijimin e itinerareve vozitëse ujore

Kërcënimet

- Ndotja
- Lidhjet e shumta informale dhe të paligjshme

6.5 SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Bashkinë e Fushë-Arrëzit e përshkon rrjeti rrugor kombëtar që në total arrin në 116 km. Ndërsa qyteti i Fushë-Arrëzit ka 2 km rrugë të brendshme. Rrjeti i rrugëve lokale është rreth 186 km. I gjithë rrjeti është në përdorim dhe shfrytëzohet nga banorët.

Infrastruktura rrugore në këtë zonë lë shumë për të dëshiruar, pasi pjesa më e madhe e saj është e amortizuar jo vetëm në akset rurale, por edhe në ato nacionale. Specifikë për këtë zonë është fakti se gjatë muajve të dimrit pjesa më e madhe e komunave izolohehen nga dëbora.

Në përgjithësi gjëndja e rrugëve nuk është e mirë, pasi mirëmbajtja e tyre ose është në nivel të pamjaftueshëm, ose nuk ekziston fare. Më problematike paraqiten, segmenti kombëtar Reps – Fushë-Arrëz, segmenti kombëtar Fushë-Arrëz – Pukë (në pjesën e njësisë administrative Rrape), rrugët lokale që lidhin fshatrat me qendrat e njësive administrative. Ka nevojë për asfaltimin e 1,5 km rrugë të brendshme në qytet, por edhe të rrugëve lokale. Së fundmi, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka financuar ndërtimin e rrugës Fushë-Arrëz – Iballë, rreth 33 km e gjatë, një rrugë me standarte.

Si pjesë e qarkut të Shkodrës ndodhet pranë aksit Durrës-Hani Hotit (Kufiri me Malin e Zi), ka fatin të jetë shumë pranë me rrugën Durrës-Kukës-Morinë. Një nga rrugët kryesore që lidhin bregun perëndimor të

shqipërisë me pjesën kontinentale lindore të vendit tonë dhe më tej me Kosovën.

Gjithashtu në vijimësi të të njëjtit korridor në Kosovë, nëpërmjet Prishtinës lidhet me Koridorin X pan-europian. Përgatë të njëjtës trajektore, PPK propozon shtrimin e një hekurudhe që nis nga qyteti i Rrëshenit dhe përfundon në Prizren. Një arterie shumë efikase në këmbimet tregëtare mes dy vendeve, por dhe një mundësi më shumë për transport pasagjerësh. Tjetër avantazh për Bashkinë e Fushë-Arrëzit është dhe afërsia me hubin ndërkombëtar të Kukësit dhe atë të Shkodrës të propozuar në PPK.

Rrjeti rrugor ekzistues për zonën e Fushë-Arrëzit sipas njësive administrative është siç vijon:


Bashkia F.Arrëz	9.06 km Asfalt	44.26 km Çakull
Njësia Qafe Mali	28.22 km Asfalt	160.90 km Çakull
Njësia Blerim	35.94 km Asfalt	74.27 km Çakull
Njësia Fjerzë	28.67 km Asfalt	107.35 km Çakull
Njësia Iballe	19.31 km Asfalt	99.93 km Çakull

Tabela 3 Tabela e rrjetit rrugor

Lidhja e qytetit me njësitet administrative është një sfidë e cila vështirësohet në këtë zonë me klimë të ftohtë dhe të ashpër në periudhën e dimrit. Një pjesë e mirë e rrugëve lidhëse kryesore është e asfaltuar, por duke marrë parasysh faktin e vështirësive gjatë periudhës së dimrit rëndësi e veçantë i duhet dhënë mirëmbajtjes së rrugëve.

Një tabelë e detajuar për rrugët lidhëse të njësive me Bashkinë e Fushë-Arrëzit është si më poshtë:

Lidhja ndërmjet Fushë-Arrëzit me:	Segmenti i Asfaltuar (km)	Segmenti me Çakull (km)	Gjatësia Totale (km)
Kryezi	6.28	1.3	7.51
Iballë	32.68	-	32.68
Fjerzë	66.78	-	66.78
Iballë - Fjerzë	31.64	18.16	49.80
Dardhë	39.03	2.16	41.19



Duke parë situatën e mësipërme dhe duke marrë parasysh gjëndjen në të cilën ndodhen rrugët ekzistuese, objektivi është që të mirëmbahen në mënyre optimale funksionale rrugët e asfaltuara duke marrë në konsideratë. Gjithashtu dhe gjetja e mundësive financiare për asfaltimin e segmenteve të pashtuara dhe mirëmbajtja e tyre duhet të jetë një ndër prioritetet e qeverisjeve vendore për qarkullimin sa më të lirë të banorëve të zonës.

Transporti publik funksionon për qytetin pasi sipërfaqja është relativisht e vogël.

Transporti që lidh njësitë administrative ofrohet nga operatorë privatë të licensuar nga Bashkia e Fushë-Arrëzit. Përmirësimi i rrjetit rrugor ul kostot për ofruesit e këtij shërbimi dhe i nxit ata drejt rritjes së investimit në këtë fushë.

Nevoja për rrugë të reja dhe përmirësimin apo zgjerimin të atyre ekzistuese është gjithmonë e pranishme në një qytet me synim zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit për banorët e zonës prandaj nuk mund të bënte përjashtim dhe Bashkia e Fushë-Arrëzit

- Rruga Fushë-Arrëz - Micoj

Fshati Micoj është një nga fshatrat në distancë më të afërt me qendrën e Bashkisë Fushë-Arrëzit me një distancë prej 5 km. Gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Micoj duke i integruar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepeve për shkëmbimin e makinave.

- Rruga Fushë-Arrëz - Lumbardhë

Fshati Lumbardhë është një nga fshatrat në distancë të afërt me qendrën e Bashkisë Fushë-Arrëzit. Gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Asfaltimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Lumbardhë, Tuç dhe Mollëkuqe. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepeve për shkëmbimin e makinave.

- Rrugë Iballë - Fjerzë

Fshatrat Iballë dhe Fjerzë janë qendrat e njësisë administrative me të njëjtin emër. Rruga mes dy fshatrave është në gjendje mjaft të keqe dhe me nevojë përmirësimin e saj. Asfaltimi i kësaj rruge ka një ndikim për gjithë Bashkinë e Fushë-Arrësit pasi ndihmon në qarkullimin më të shpejtë dhe efikas të gjithë qendrave të banuara në veri të Bashkisë. Asfaltimi i kësaj rruge ul ndjeshëm dhe distancën kohore mes Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Bashkisë Tropojë. Aksi rrugor Fushë-Arrëz-Iballë është një aks i përfunduar vitet e fundit dhe vazhdimi i këtij aksi drejt Fjerzës dhe më pas Tropojës ndikon në zhvillimin e ekonomik të zonës, rritjen e aksesit për turistët të cilët afrohen në distancë me fshatin Kryezi pjesë e projektit të 100 Fshatrave dhe me fshatin Iballë. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës dhe krijon mundësinë e rritjes së investimeve private dhe kthimin e banorëve të larguar. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me akull. Asfaltimi i kësaj rruge ka ndikim për gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepeve për shkëmbimin e makinave. Projekti propozohet të zhvillohet në 2 Lote/Faza. Lot 1 Iballë- Bugjon 10.5 km.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e

sektorit infrastrukturor:

Anët e forta

- Afërsia me rrugët ndërkufitare të rajonit
- Afërsia me hubin ndërkombëtar të Kukësit

Dobësitë

- Infrastrukturë e dobët në zonat rurale
 - Akses i varfër në ujë pishëm
 - Lidhjet e paligjshme
- Mungesë e nyjeve të transportit

Mundësitë

- Lidhje rajonale
- Përmirësimi i ujit të pijshëm
- Afërsia me qytetin e Kukësit

Kërcënimet

- Fshatrat të caktuar të pa aksesueshëm gjatë periudhës së reshjeve të dëborës, me rrugë shpesh të pakalueshme
- Transporti publik i dobët

6.6 KONKLUZIONE PARAPRAKE

Duke u mbështetur në të gjitha analizat e bëra më sipër, paraqiten më poshtë konkluzionet kryesore për gjendjen aktuale të Bashkisë, avantazhet e veçanta të Bashkisë, dobësitë e identifikuara, potenciali i zhvillimit dhe perspektivat e Bashkisë, si dhe vështirësitë.

Si **avantazhe** (Strengths) të rëndësishme përmenden fillimisht:

- Mjedis i pasur dhe i qetë natyror me vlerë të rëndësishme kulturore dhe ekologjike
- Peizazhe të paprekura dhe të bukura.
- Afërsia me qendrën urbane Kukës e cila parashikohet të shndërrohet në një nga portat hyrëse të Shqipërisë.
- Afërsia me qendrën urbane Shkodër e cila është në një nga portat hyrëse të Shqipërisë.
- Ekzistenca e njësive themelore të mikpritjes – ushqimit traditë të fortë dhe të gjatë kulturore.
- Burime të shumta të ujit të pijshëm të pastër, të përshtatshëm për ambalazhim në shishe.
- Njohje e rajonit përmes produkteve të standartizuara bujqësore.

Më poshtë shënohen **pikat e dobëta** të Bashkisë dhe konkretisht:

- Mungesë nga territori i bashkisë i rrugëve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare - mungesë qasjeje e vendbanimeve jashtë rrjetit të rrugëve kryesore.

- Pamundësi për të tërhequr fonde të mjaftueshme për investime.
- Infrastruktura teknike urbane e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme (p.sh. furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave).
- Ulje e numrit të popullësisë dhe plakja e saj.
- Braktisja e vendbanimeve malore dhe fshatrat e largëta nga banorët e tyre.
- Numër i kufizuar dhe cilësi e ulët e iëturës së turizmit dhe rekreacionit.
- Ndërtesa të shpërndara jashtë kufijve zyrtarë dhe ekzistenca e ndërtesave informale.

Potenciali më i rëndësishëm i zhvillimit - mundësi (Opportunities) të rajonit, në raport edhe me ambientin e jashtëm, përmbledhen në:

- Hapësira për mirësimin e rrjetit të brendshëm rrugor (lidhje e selisë me njësitë administrative) dhe lidhja rrugore me Bashkitë fqinje.
- Tendencat të rritura të zhvillimit të ekoturizmit në vend dhe jashtë vendit.
- Zbatimi / Programimi ndërhyrjeve të rëndësishme (a) rigjenerimit urban që rrisin funksionin dhe imazhin e qytetit të Fushë-Arreztit, (b) lëturës sociale që përmirësojnë jetën shoqërore dhe mundësitë rekreative, dhe (c) ndërtimin e banesave sociale për grupet në nevojë.
- Interesi i Bashkisë për projekte dhe investime për të krijuar vepra të reja dhe ndërhyrjeve në ekonomi, duke u fokusuar në format e buta dhe alternative të turizmit (p.sh. turizmi rural, turizmi dimëror).
- Kthimi i banorëve të cilët kishin emigruar brenda dhe/ose jashtë vendit me njohuri dhe mundësi financiare.
- Shfrytëzimi i trendeve ndërkombëtare të kërkesës për produkte cilësore lokale agro-ushqimore.
- Shfrytëzimi i instrumenteve financiare dhe fondeve nga BE dhe organizatat ndërkombëtare,
- Afërsia me destinacione kryesore dhe të njohura turistike.
- Bashkëpunim i mirë dhe i vazhdueshëm me Bashkitë fqinje dhe institucione (p.sh. OJQ) për çështje që kërkojnë bashkëpunim ndër-Bashkiak.

7. VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE E BASHKIVË FQINJE

Si një qendër e re e krijuar me reformën e re territoriale, strategjia edhe vizioni i Bashkisë Fushë-Arrëzi nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga Bashkitë fqinje të saj.

Bazë për një zhvillim të qëndrueshëm edhe në bashkëpunim me këto Bashki fqinje më poshtë listojmë Vizionin dhe Strategjinë e 3 Bashkive kryesore në kufij me këtë Bashki.

7.1 KUKËSI:

7.1.1 Vizioni i Bashkisë Kukës: Promovimi i një zhvillimi territorial të integruar që mbështet zhvillimin ekonomik për një akses dhe cilësi shërbimesh më të mira me qëllim përmirësimin në kompleks të cilësisë të jetës

7.1.2 Objektivat strategjike të Bashkisë Kukës

OS1- Zhvillimi policentrik bazuar në forcimin e hierarkisë së sistemve urbane

OS2 - Përmirësimi i sistemit të brendshëm dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndërkufitare

OS3 - Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në fushat e turizmit, energjisë dhe minierave

OS4 - Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit vendor bazuar në sektorin e bujqësisë dhe zejtarisë

OS5-Organizimi i hapësirave urbane



Figure 1 diagrama me vizionin e të ardhmes për Kukësin

7.2 TROPOJA:

7.2.1 Vizioni i Bashkisë:

Vizioni për të ardhmen e e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe të kuptuarit të shfrytëzimit të tyre nevojitet të bëhet në përfitimin e ekonomisë dhe popullsisë vendase, pa çënuar vlefshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhmen.

7.2.2 Objektivat Strategjike të Bashkisë

O1- Mbrojtja e Mjedisit

- O1S1 Ruajtja (konservimi) i biodiversitetit
- O1S2 Menaxhimi i Zonave të mbrojtura dhe rrjetit ekologjik
- O1S3 Ndikimi i ndryshimeve klimaterike
- O1S4 Ndërhyrje rigjeneruese në zonat e paprekura

O2- Ruajtja e vlerave kulturore

- O2S1 Mbrojtja dhe rehabilitimi i monumeteve të kulturës dhe vendbanimeve fshatare
- O2S2 Ruajtja dhe pasurimi i trashëgimisë kulturore

O3- Zhvillimi i Turizmit

- O3S1 Promovimi i Territorit
- O3S2 Përmirësimi i rrugëve turistike dhe arritshmërisë në vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë
- O3S3

Zhvillimi i strukturave turistike
O3S4 Përmirësimi i shërbimeve turistike

O4- Fuqizimi i bujqësisë dhe blegtorisë

O4S1 Përmirësimi i mjedisit bujqësor O4S2
Mbështetja e fermave organike
O4S3 Mbështetja e prodhuesve të vegjël dhe fermave O4S4
Promovimi i bashkëpunimit
O4S5 Promovimi i tregtimit dhe prodhimeve ushqimore vendase O4S6
Sigurimi i certifikimit të produkteve vendase
O4S7 Promovimi i formimit profesional

O5- Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme

O5S1 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
O5S2 Përmirësimi i transportit ujor
O5S3 Përforcimi i lëvizshmërisë së përbashkët O5S4
Përforcimi i lëvizshmërisë së lehtë

O6- Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale

O6S1 Garantimi i arritshmërisë së hapësirave publike O6S2
Përmirësimi i shërbimeve të përbashkëta
O6S3 Përmbushja e nevojave për strehim dhe përmirësimi i ofertës aktuale për strehim
O6S4 Dendësimi dhe konsolidimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

O7- Përditësimi dhe krijimi i iëturës bazë urbane

O7S1 Përmirësimi i infrastrukturës lokale
O7S2 Përmirësimi i rrjetit të shërbimit të ujësjellësit
O7S3 Ngritja e një sistemi kanalizimesh funksional për të gjithë territorin
O7S4 Ngritja e një sistemi funksional për grumbullimin e mbeturinave për të gjithë territorin O7S5
Përmirësimi i rrjetit të telekomunikimit
O7S6 Përmirësimi i efektshmërisë energjitike

O8 -Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar

O8S1 Mbrojtja e biodiversitetit
O8S2 Mbështetja e zhvillimit socio ekonomik

7.3 PUKË:

7.3.1 Vizioni i Bashkisë:

"Bashkia Pukë, me mjedisin e pasur natyror dhe peizazhet e paprekura të një bukurie mahnitëse, do të jetë një qendër malore e formave alternative të turizmit që do të shfrytëzojë burimet natyrore. Do të jetë gjithashtu një qendër zhvillimi pilot në sektorin bujqësor dhe agro-blegtorisë, me theks të veçantë në produktet e certifikuara vendase"

7.3.2 Objektivat Strategjike të Bashkisë

OS1 Përtëritje e rajonit përmes promovimit të formave të turizmit
OS2 Rivitalizimi ekonomik i rajonit përmes zhvillimit të sektorit bujqësor OS3

8. VIZIONI DHE STRATEGJIA E FUSHË-ARRËZIT

Përshkrimi i strategjisë territoriale është i ndarë në dy seksione:

- Strategjia territoriale e vendndodhjeve që integron në mënyrë transversale disa elemente kyçe që dalin nga leximi i territorit në 5 sistemeve territoriale (UB, IN, N, U, B);
- Objektivat dhe veprimet të ndara sipas pesë sistemeve të sipërpërmendura, duke qartësuar që nuk bëhet fjalë për sektorë të izoluar dhe të pavarur, por të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin në të cilin zhvillimi i çdo sistemi individual drejton dhe është drejtuar nga të tjerët.

Këto elemente të vijnë së bashku në formulimin e një vizioni rajonal që, duke filluar nga analiza e mësipërme SWOT, shpreh objektivin kryesor drejt të cilit orientohen ndryshimet e viteve të ardhshme. Strategjia territoriale bazohet edhe në kërkesat zhvillimore derivuese nga Plani Kombëtar.

8.1 VIZIONI I BASHKISË


Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Plani Kombëtar, hulumtimi në terren, strategjia është e bazuar në vizionin e Fushë-Arrëzit si një qendër terciare e rëndësishme. Kjo Bashki me pozicionin e saj gjeografik, sikurse është përmendur edhe në kapitujt e mësipërm, që shtrihet midis dy poleve të rëndësishme kombëtare, sjellë për zhvillimin e saj përparësi në infrastrukturë, turizëm etj.

Karakteristika më e rëndësishme e kësaj Bashkie është prania e zonave pyjore, e cila shërben si një potencial shumë i rëndësishëm zhvillimi për turizmin lokal dhe ndërkombëtar. Prania e zonës së Munellës në pjesën jugore të Bashkisë, gjurmët e liqenit të Fjerzës në pjesën veriore të saj (duke konturuar vetë Bashkinë), janë elementët definues të përcaktimit të Strategjisë së kësaj Bashkie ku asetet natyrore kanë përparësi në zhvillimin e saj.


Mbi këto pika të rëndësishme në lidhje me zhvillimin e Bashkisë së Fushë Arrëzit më poshtë formulojmë Deklaratën e Vizionit të Bashkisë, e cila është:

PROMOVIMI DHE ZHVILLIMI I BASHKISË SË FUSHË-ARRËZIT NË ASPEKTIN E TURIZMIT PYJOR DHE MALOR, RRITJES SË AKSESUESHMERISË DUKE PËRMIRËSUAR INFRASTRUKTURËN MIDIS PORTAVE TË RËNDËSISHME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE NË AFËRSI TË SAJ, SI EDHE RUAJTJA E ASETVE MJEDISORE TË PASURA TË VETË BASHKISË

Nisur nga deklarata e Vizionit dhe potenciali i zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është strukturuar rajonalizimi i qendrave të banuara, në rastin e tonë, duke mos prekur dhe duke u integruar natyrshëm me zonat natyrore të Bashkisë.



Harta 8 Rajonalizimi i qendrave të banuara (të integruara me pjesën natyrore të Bashkisë)



Harta 9 Harta e Vizionit

Qyteti i Fushë-Arrëzit si qendra kryesore e Bashkisë, nga pozita e vetë gjeografike, nga popullsia në përbërjen e saj, shërben (po të shihet edhe në shtrirje gjeografike) si një prezantim ose portë hyrëse drejt territorit të vetë Bashkisë së Fushë-Arrëzit. Kështu qyteti shërben si qendra kryesore, edhe njësitë më të rëndësishme lidhen me të, drejt rrugëve që kalojnë në zona pyjore.

Definimi i zonave të banuara dhe shpërndarja e tyre, sikurse shihet dhe në figurën e mësipërme, definon më së miri zonat pyjore që spikasin në territorin e Fushë-Arrëzit. Ato ndahen në formën e 3 loteve, ku më i rëndësishmi është zona pyjore e Munellës (në pjesën veriore të territorit). Kjo zonë me pak qendra të banuara, gati të braktisura sot, lidh pjesën e Fushë-Arrëzit dhe me Bashkinë fqinje të Mirëditës dhe Pukës duke krijuar një vazhdimësi pyjore me to, aset shumë i rëndësishëm i Bashkisë në studim.

Nisur nga ky vizion dhe përmes ripunimit të Analizës SWOT, u përcaktuan objektivat strategjike që veprojnë në mënyrë të integruar me qendrat e banuara dhe potencialin e Bashkisë.

8.2. Objektivat strategjik

Objektivat strategjik për Bashkinë Fushë-Arrëz janë konceptuar në përputhje me realitetin lokal të kësaj Bashkie si dhe me synimin që të arrihet përmbushja e vizionit strategjik brenda harkut kohor prej 15 vitesh, për sa kohë kjo PPV do të jetë në fuqi. Duke u mbështetur në rezultatet e analizës së gjëndjes ekzistuese si dhe nga konsultat me aktorët vendas, janë konceptuar 5 objektiva strategjike të cilët do të ndihmojnë vënien në jetë të vizionit të hartuar më sipër.

- Objektivi strategjik 1 është “Mbrojtia e mjedisit”, si një Bashki që pjesën më të madhe të territorit e ka natyrë, mbrojtja e mjedisit është primare në aktivitetin Bashkiak por dhe qytetar.
- Objektivi strategjik 2 është “Promovimi i aseteve kulturore dhe monumentale në Fushë-Arrëzit për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit”, si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë, turizmit në Bashkinë e Fushë-Arrëzit do ti shtohen fondin e tij dhe asetet kulturore dhe monumentale si pika atraktive duke i bërë pjesë të intinerareve turistike.
- Objektivi strategjik 3 është “Përmirësimi i buqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase”, një objektivi shumë aktual në kuadrin e rritjes së mundësisë së plotësimit të nevojave të tregut vendas por dhe tregëtimit të produkteve jashtë territorit të Bashkisë apo shtetit shqiptar
- Objektivi strategjik 4 është “Përmirësimi i shërbimeve publike”, ky objektivi është konceptuar sidomos për përmirësimin e shërbimeve në zonat më periferike të bashkisë atje ku sot shumë prej shërbimeve publike mungojnë tërësisht.
- Objektivi strategjik 5 është “Organizimi i hapësirës urbane të Bashkisë”, me anë të këtij objektivi strategjik vihet në fokus qyteti i Fushë-Arrëzit si e vetmja hapësirë urbane në Bashkinë e Fushë-Arrëzit, por edhe fshati i Kryeziut si pjesë e projektit për 100 fshatrat, qëllimi i këtij objektivi është drejtimi i zhvillimeve urbane konform parametrave kontemporanë të zhvillimit si dhe në përputhje me legjislacionin territorial shqiptar




Figure 2 Diagrama e objektivave strategjike

8.3 Drejtimit kryesore të zhvillimit

Analiza e gjëndjes ekzistuese është baza kryesore për hartimin e Vizionit, i cili më vete është një përmbledhje e të gjitha propozimeve që lidhen me drejtimit e zhvillimit dhe objektivat strategjike.


Vizioni dhe strategjia përcaktojnë drejtimit e zhvillimit që do të ketë Bashkia e Fushë-Arrëzit, konkretizuar në një plan zhvillimi. Por gjithsesi ky Plan Zhvillimi nuk shteron mundësinë e propozimit ose zhvillimit të projekteve, programeve apo objektivave të reja shtesë për realizimin e Vizionit. Përkundrazi, plani është i nevojshëm që të plotësohet sipas nevojave konkrete të cilat mund të lindin jashtë parashikimeve të tij.

Në procesin e planifikimit, emergjencat e paparashikuara duhet të konstatohen, rivlerësohen në lidhje me planin, të bëhen rregullimet e nevojshme sipas udhëzimeve ligjore të planifikimit nëse është nevoja, dhe të implementohen masat e nevojshme që duhen marrë. Dokumenti i PPV-së duhet të kuptohet si një mjet orientues, jo garantues i zhvillimit, i cili ndihmon organet e qeverisjes vendore për t'u përqafuar me nevojat lokale për zhvillim dhe për të orientuar potencialet investuese vendore përmes një platforme të përbashkët me qytetarët, që është vetë dokumenti dhe instrumentet që dalin në funksion të tij.

Ndërkohë, për aplikimin e efektshëm të propozimeve të planit në territor, është i domosdoshëm verifikimi konkret i të dhënave të detyrueshme ligjore dhe të planit, me qëllim afrimin e tyre me gjëndjen ekzistuese në vend, si dhe konsultim të vazhdueshëm mes grupeve që preken përpara çdo vendim-marrjeje.

Rregullorja e Planifikimit të Territorit, në bazë të V.K.M. nr.686 të datës 22.11.2017, përcakton nevojën e formulimit të drejtimeve të zhvillimit të territorit të Bashkisë. Këto drejtime janë specifike për fushën që mbulojnë, orientuese për të gjitha fazat e mëtejshme të planit.

Drejtimit e zhvillimit përfshijnë disa disiplina dhe përcaktojnë bazën në të cilën do të orientohet formulimi i politikave urbane, lidhja e objektivave me programet, përparësia për projekte të zhvillimit, e të tjera. Për Bashkinë e Fushë-Arrëzit drejtimit e zhvillimit të territorit janë katër; *Infrastruktura, turizmi, bujqësia dhe mjedisi*. Këto drejtime zhvillimi marrin shkas nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i cili e cilëson rajonin Kukës-Has-Tropojë si porta lindore e rajonit malor verior.



9.3.1. Drejtimi i Zhvillimit të Infrastrukturës

Në funksionin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike përfshihen : shërbimi i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve, shërbimi i transportit dhe i infrastrukturës rrugore, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të mbetjeve urbane, shërbimi i ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore/shëndetësore, shërbimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të hapësirave të gjelbra, dekorit etj.

Transporti

Bashkinë e Fushë-Arrëzit e përshkon rrjeti rrugor kombëtar që në total arrin në 83.36km. Ndërsa qyteti i Fushë-Arrëzit ka 3.83 km rrugë të brendshme. Rrjeti i rrugëve lokale është rreth 484.9km. I gjithë rrjeti është në përdorim dhe shfrytëzohet nga banorët.

Qyteti i Fushë-Arrëzit lidhet në mënyrë të rregullt me Tiranën, Durrësi, Shkodrën, Lezhën dhe Pukën. Kryesisht mjetet e transportit të licencuara janë të tipit minibus dhe përballojnë mirë nevojat e qytetarëve. Gjithashtu, qyteti ka edhe linja brenda Bashkisë duke e lidhur atë me njësitë

administrative dhe fshatrat.

Megjithatë, rrjeti rrugor rural që lidh fshatrat me rrugën shtetërore ose me qendrat e njësive administrative, është në gjendje jo të mirë, ne shume pjese i pa asfaltuar dhe me vështirësi kalimi gjatë stinës së dimrit. Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve ka sjellë probleme në mënyrën e organizimit të mirëmbajtjes së rrugëve rurale ndër vite.

Linjat e transportit publik në Bashkisë së Fushë-Arrëzit thuajse nuk ekziston, referuar dhe te dhenave nga istatgis dallojmë që transporti me mjete publike si autobus, minibus apo taksi është vetem 6.1

%, përfaqëson dhe përqindjen më të ulët nga mënyrat e transportit që zgjedhin banorët e kësaj Bashkie për transportin në përditshmërinë e tyre. Linjat e transportit publik nuk ekzistojnë, ky lloj transporti përfaqësohet vetëm nga transporti me minubuza privatë të cilët janë të regjistruar si taksi. Makinë ose motocikletë përdorin 22.4% e popullsisë ndërsa përqindja më e madhe me 67.7% qarkullon në këmbë. Shihet e nevojshme krijimi i linjave urbane të transportit përgjatë linjave të fshatrave.

Sistemi i furnizimit me ujë

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe siguri i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Ai nënkupton pastërti, energji, por mbi të gjitha, diçka të sigurt për të pirë. Nga ky këndvështrim, Shqipëria mund të quhet një vend i bekuar. E megjithatë, ende një pjesë të mirë të popullatës nuk i ofrohet shërbimi i ujit, ndërkohë që edhe më “fatlumët” janë subjekt i ardhjes së ujit sipas orareve të caktuara.

Furnizimi me ujë të pijshëm i banorëve ka dy veçori, atë të furnizimit të qytetit të Fushë-Arrëzit dhe të fshatrave. Këto të fundit, për shkak të shtrirjes në territor dhe numrit relativisht të kufizuar të banorëve, në disa raste kanë rrjetet e tyre të furnizimit dhe disa të tjera furnizohen direkt nga ai i Micojt, me gjatësi linje, përkatësisht, 7km dhe 3.5km, që shkarkohen në të njëjtin rezervuar. Në fakt, ujësjellësi i Krrabës ka nevojë të rikonstruktohet në 50% të tij. Gjithashtu, rrjeti shpërndarës i brendshëm, i qytetit, është tejte i amortizuar duke sjellë humbje në sasinë e ujit, por edhe ndotje të tij. Investimi në këtë rrjet është i domosdoshëm jo vetëm për të adresuar çështjen e higjienës së ujit, por edhe të mirëmenaxhimit të tij duke vendosur sahatët matës për çdo familje. Bashkia e ka gati këtë projekt dhe pret vetëm financimet.

Vetëm qyteti i Fushë-Arrëzit ka lidhje me rrjetin e ujësjellësit i cili i furnizon qytetin për vetëm 7.5 orë në ditë. Ndaj banorët e këtij qyteti edhe pse kanë lidhje me ujësjellësin janë të detyruar të hapin puse për të plotësuar nevojat ditore për ujë. Ndërsa pjesa tjetër e vendbanimeve të vetmen mëyrë për të siguruar furnizim me ujë për banesat dhe aktivitetet e tjera janë puset. Në pjesën më të madhe puset banorët i kanë pajisur dhe me pompa private për ta bërë më të thjeshtë shpërndarjen e tij pranë banesave, tokave apo bizneseve ku iu nevojitet. Gjithsesi nuk janë të pakta rastet kur nxjerrja e ujit nga puset bëhet me kova dhe transportohet ne destinacion me anë të kafshëve.

Një fenomen tjetër i lidhur me puset është dhe periudha e thatësirës gjatë së cilës uji i puseve shteron sipas rasis dhe banorët detyrohen të udhëtojnë drejt pikave ku mund të gjendet ujë në formën e tij natyrale si lumi rezervuar apo burime natyrore të ujit.

Nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin që infrastruktura e depozitimit dhe shpërndarjes së ujit në Bashkinë Fushë-Arrëz duhet të rishikohet në tërësi, kjo duke hartuar projekte afat mesme me synimin që të përmbushen nevojat emergjente sa më parë.

Sistemet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të zeza

Ujërat me cilësi të dobët e rrezikojnë shëndetin e njerëzve dhe integritetin e ekosistemit, zvogëlojnë sasinë e ujit për pije në dispozicion dhe zvogëlojnë prodhimtarinë ekonomike. Janë një numër i aktiviteteve natyrore dhe njerëzore si: bujqësia, industria, minierat, depozitimet e mbeturinave, rritja e popullatës, urbanizimi dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në karakteristikat biologjike, kimike dhe fizike të ujrave duke ulur ndjeshëm cilësinë e tyre. Në të kaluarën në shumë vende, kur sistemet publike të kanalizimeve nuk kanë qenë të mundura, e vetmja alternativë praktike ka qenë dhe vazhdon akoma, ndërtimi në vend i sistemit të trajtimit të ujrave të ndotura me gropa septike dhe absorbim në tokë, por jo të gjithë situatat, apo strategjitë e planifikimit në zonat rurale, janë të përshtatshme për këtë tip.

Edhe në këtë rast kemi dy forma operimi. Në fshatrat e Bashkisë përdoren gjerësisht gropat septike. Ndërsa, vetëm në qytetin e Fushë-Arrëzit funksionon rrjeti i kanalizimeve. Por ky rrjet është tejte i amortizuar (për vite të tërë nuk ka patur ndërhyrje në pothuajse 80% të tij), si tek tubacionet ashtu edhe tek pusetat. Gjithashtu, duhet patur parasysh që edhe sasia e këtyre ujrave është rritur si rezultat i ndryshimit të mënyrës së jetesës së popullatës. Një aspekt problematik, nga pikëpamja mjedisore, është këtu edhe shkarkimi i ujrave të zeza në lumë, të papërpunuara. Edhe për këtë Bashkia e ka gati një projekt dhe pret vetëm financimet.

Edhe rrjeti i KUZ është në një situatë shumë të prapambetur, ku vërmë gjithashtu vetëm qytetin e Fushë-Arrëzit që të ketë rrjet KUZ. Megjithatë ekziston rrjeti i KUZ për qytetin e Fushë-Arrëzit ai shërben vetëm për transportimin e ujrave të zeza pasi mungon sistemi i trajtimit të tyre. Ndërsa pjesa tjetër e vendbanimeve nuk kanë rrjet KUZ dhe përdorin gropat septike private. Të cilat ashtu si dhe derdhja e pa trajtuar e ujrave të zeza nga rrjeti i KUZ cojnë në ndotjen e mjedisit dhe helmimin e tokave bujqësore dhe ujërave nentokësore.

Është e nevojshme instalimi i një sistemi të trajtimit të ujërave të zeza si pjesë përbërëse e rrjetit të KUZ si dhe zgjerimi i këtij rrjeti edhe drejt vendbanimeve të tjera. Ndërsa për vendbanimet ku nuk shihet e nevojshme instalimi i një rrjeti KUZ si pasojë e numrit të pakët të banorëve apo kushteve gjeografike të terrenit, sygjerohet implementimi i një programi Bashkiak për zëvendësimin e gropave septike me sisteme trajtimi bashkëkohore. Këto dy iniciativa do të siguronin lehtësi për banorët që i përdorin si dhe një mjedis natyror më të pastër.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipëri mbetet ende në nivele të ulta nga ana e administratave lokale të vendit. Për këtë arsye mbetjet e ngurta në Shqipëri shtohen çdo vit e më shumë, dhe kryesisht nga mbetjet industriale (për shkak të ndërtimeve të shumta dhe prishja e ndërtesave të vjetra) dhe mbetjeve urbane (për shkak të rritjes së konsumit të mallrave).

Qyteti i Fushë-Arrëzit është një qytet i vogël dhe relativisht prodhon pak mbeturinë, rreth 2-2,5 ton/ditë, por me krijimin e Bashkisë së re, përgjegjësia e mbledhjes së mbeturinave shtrihet në një territor mjaft më të madh, përfshirë ish komunat. Qyteti ka patur që nga viti 2007 një plan të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta, por, tashmë, ky plan duhet riparë në kuadrin e Bashkisë së re. Lidhur me depozitimin, mbetjet depozitohen në një pikë të veçantë, të miratuar nga Ministria e Mjedisit, por në kuadër të bashkëpunimit ndër-Bashkiak është mundësia e ngritjes së një pike të përbashkët grumbullimi për Bashkitë e Fushë-Arrëzit dhe të Pukës në territorin e njësisë administrative Rrape (Pukë).

Ideale do të ishte që mbeturinat e ngurta të dërgoheshin në landfill-in rajonal të qarkut Shkodër, në Bushat, i cili është i ndërtuar me parametra bashkëkohore dhe ku ekziston mundësia e përpunimit të tyre, por duket që për momentin, kushtet ekonomike-financiare të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe qytetarëve të saj nuk e mundësojnë një gjë të tillë. Landfill-i i Bushatit kërkon 7€/ton pa llogaritur këtu transportin në më shumë se 50km rrugë. Problem vazhdon të mbetet mbledhja e tarifës së pastrimit nga qytetatrët.

Rrjetet teknologjike

Territori i Bashkisë Fushë-Arrëz është i gjithi i mbuluar nga shërbimi i furnizimit me energji elektrike, çka do të thotë që të gjitha venbanimet furnizohen me energji elektrike. Energjia në venbanimet e bashkisë Fushë-Arrëz transmetohet 24 orë/ditë megjithëse vërehen shpërndarje të energjisë sidomos në fshatra. Kjo vjen si pasojë e amortizimit të rrjetit i cili si pasojë e ngarkesës apo kushteve klimatike jep defekte. Rikonstruksioni i linjave të shpërndarjes të energjisë shihet si prioritar në hapat që duhet të ndjekë zhvillimi në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

Situata paraqitet e ndryshme për sa i përket rrjetit të telefonisë fikse, ku vërehet që ai ekziston vetëm në qytetin e Fushë-Arrëzit, linjat e këtij rrjeti kanë ekzistuar edhe për venbanimet e tjera mirëpo zhvillimet e këtyre 30 viteve pas diktaturës kanë bërë që ato të dëmtohen. Telekomunikacioni në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz mbulohet nga shërbimet e telefonisë celulare që ofrohen nga operatorët privatë, nëpërmjet të cilit ofrohet dhe lidhja me internetin. Ky rrjet i telefonisë celulare mundëson mbulim të plotë për të gjitha vendbanimet e Bashkisë Fushë-Arrëz. Në lidhje me këtë rrjet sygjerohet që të krijohet rrjeti i telefonisë fikse për shërbimet spitalore apo ambulatorë, postat, pikat policore, etj. Kjo për ti dhënë këtyre shërbimeve mundësi komunikimi 24 orë/ditë dhe me një kosto të ulët në krahasim me shërbimet e telefonisë celulare.

Si pasojë e përfshirjes brenda territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz të hidrocentralit të Fjerzësz, aty gjendet një mori infrastrukturash që bëjnë prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë jo vetëm në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz por në të gjithë Shqipërinë. Kështu vërejmë në hartën më sipër, në veri të territorit të Bashkisë impjantin e prodhimit të energjisë elektrike nga ku shpërndahen linja të tensionit të lartë të mesëm dhe të ulët, nëpërmjet nënstacioneve elektrike bëhet shpërndarja e mëtejshme e energjisë.

9.3.2. Drejtimi i Zhvillimit të Bujqësisë

Objektivi për sistemin e bujqësisë është rritja e efikasitetit dhe produktiviteti i një sektori të prodhimit bujqësor. Politikat e PPK janë: ruajtja, konsolidimi, modernizimi. Bashkia Fushë-Arrëz karakterizohet nga një terren malor me sipërfaqe të vogla të tokës bujqësore me një shkallë boniteti të ulët .Gjithashtu si pasojë e terrenit dhe ndarjes së pronës pas viteve 90 toka bujqësore është e fragmentariuzar në parcela të vogla me kapacitete prodhimi kryesisht për përdorim familjar .Fushë-Arrëzi lidhet me propozimet e PPK për sistemin bujqësor në politikat e ruajtjes dhe konsolidimit të tokës që ka. Në mënyrë të veçantë, në këtë kontekst janë disa propozime të cilat janë të aplikueshme në kontekstin e Bashkisë Fushë-Arrëz :

- Ruajtja maksimale e mundshme dhe mbrojtja e tokës bujqësore përmes: zbatimit të politikave të dëndësimit të zhvillimit urban (Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban) (pas miratimit të PPK nuk do të lejohet ndërtimi që nuk ka lidhje me sistemin e bujqësisë).
- Pyllëzimi i tokës së degraduar pyjore duke respektuar natyrën dhe identitetin natyror të çdo zone.
- Funksionimi i mirë i ekosistemeve natyrore përmes mbrojtjes së tyre dhe krijimit të korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve ujore.
- Krijimi i një zinxhiri efikas të furnizimit: Prodhim-grumbullim-përpunim-disponim (zinxhiri ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim), me synim rritjen e vlerës së shtuar të një produkti (rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik).
- Reduktimi i kostos së prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së produktit nëpërmjet modernizimit teknologjik dhe investimeve në mirëmbajtjen e rrjeteve të ujitjes dhe kullimit.
- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë ekonomikë:
 - Turizëm (kontributi i shijes dhe cilësisë së produkteve bujqësore në njohjen e produktit turistik shqiptar),
 - energjisë (përdorim të burimeve të rinovueshme të energjisë për përpunimin e produkteve bujqësore)
 - transporti (rritje e performancës së zinxhirit të furnizimit (rritjes së efikasitetit të rrjetit bujqësor në grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore).
- Krijimi i qendrave/terminaleve bujqësore bazuar në traditat bujqësore lokale (bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendase).
- Prodhimi i produkteve të certifikuara, të njohura «Made in Albania» dhe specializim në produktet shqiptare karakteristike (bimë mjekësore, fruta, ullinj, rrush, perime tipike lokale, produkte të standartizuara bujqësore).

9.3.3. Drejtimi i Zhvillimit të Turizmit

Në dekadën e fundit, turizmi është parë si një mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës nga të gjithë ish-njësitë vendore. Pavarësisht se të gjitha njësitë kishin në vizionin, synimet dhe projektet tyre, zhvillimin e turizmit, ai mbetet në hapat e para të zhvillimit të tij për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme, promovimeve të pakta të vlerave turistike të zonës, mungesës së kushteve të akomodimit të turistëve, mungesës së qendrave të informacionit turistik, ciceronëve, tabelave në territor etj.

Fshati Kryezi është përzgjedhur së fundmi në projektin e Qeverisë "100 Fshatrat" pasi është një ndër zonat, ku turizmi mund të marrë hov përmes adaptimit të banesave tradicionale në shtëpi pritëse për turistët, përmes agro-turizmit , prodhimit të veshjeve tradicionale dhe mbi të gjitha për shkak të

natyrës dhe pyjeve. Potencial në këtë fushë ruajnë edhe fshatrat lballë dhe Dardhë.

Fushë-Arrëzi ofron një potencial të madh turistik për shkak të pozicionit gjeografik, vlerave të larta natyrore dhe aspekteve të shumta historike e kulturore. Zhvillimi i turizmit është frenuar nga infrastruktura rrugore e papërshtatshme, mungesa e promovimit dhe informacionit të vazhdueshëm turistik, mungesa e përvojës dhe kapaciteteve akomoduese, si dhe nga mungesa e një strukture administrative përgjegjëse për turizmin në zonë.

9.3.4. Drejtimi i zhvillimit të Mjedisit

Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Fushë-Arrëzit e konsideron mjedisin natyror si bazën në të cilën mbështeten të gjitha aktivitetet e tjera njerëzore dhe si i tillë ai duhet të jetë sa më i qëndrueshëm dhe frytdhënës. Për këtë arsye në mënyrë që të theksohet akoma më shumë rëndësia që ka kujdesi dhe mirëmbajtja e mjedisit natyror, “Zhvillimi i Mjedisit” është menduar si një nga drejtimit kryesore të zhvillimit që parashikohet nga vizioni për Bashkinë Fushë-Arrëz.

Në total sistemi natyror në Fushë-Arrëz është 50,580.1 ha, nga të cilat, 31,741.3ha janë pyje, 2,808.1ha kullota, 2,206.3ha shkurre, 267.7ha janë livadhe, 6.6ha janë park natyror dhe 13,513.3ha janë djerrë dhe inproduktive. Nga fillimi i vitit 2016, qeveria ka aplikuar moratoriumin mbi pyjet, që do të thotë aspak ose fare pak shfrytëzim të pyjeve nën mbikqyrjen e Bashkisë.

Pyjet në Bashkinë e Fushë-Arrëzit zënë një vend të rëndësishëm në grupin e burimeve natyrore. Territori i Bashkisë konsiderohet si një territor me masive të pasura pyjore dhe me kullota. Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe inproduktive zë rreth 80% të sipërfaqes. Pyjet dhe kullotat ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme. Banorët e zonave rurale e kanë të lidhur jetesën ngushtë me këto pasuri natyrore.

Tradicionalisht, pyjet dhe kullotat në afërsi të fshatrave apo qendrave të banuara janë përdorur për prodhim dru zjarri, lëndë ndërtimi, kullotë e prodhim të bazës ushqimore për blegtorinë, etj.

Pyjet, për gjatë historisë, janë administruar në forma të ndryshme, por ka qenë traditë shfrytëzimi për material drusor për plotësimin e nevojave të drurëve të tharë, të shtrembër dhe të prapambetur (të degraduar), duke ruajtur kështu vazhdimësinë e pyllit. Por, gjatë viteve të tranzicionit ato janë shfrytëzuar në mënyrë të pakontrolluar, me pasojë dëmtimin dhe degradimin e masiveve pyjore. Lënda drusore u bë objekt fitimprurës i kontrabandës nga persona e kompani të papërgjegjshme. Gjithashtu, rënia e zjarreve të shpeshta ka kontribut në vet negativ. Sot pyjet dhe kullotat janë të dëmtuara rëndë dhe kanë prodhimtari të ulët. Në këto sipërfaqe është prishur ekuilibri ekologjik dhe ka filluar erozioni, rrëshqitjet, përmytjet, rritja e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, apo impakti negativ në klimën e zonës, në përgjithësi. Shtresa e sipërme e tokës është dëmtuar dhe gërryhet vazhdimisht. Kafshët e egra në pyll janë pakësuar. Bimët mjekësore janë të pakta dhe të zhvilluara dobët. Shkurret po bëhen gjithnjë e më të vogla dhe degëzat e tyre marrin formë gjëmbore. Rrjedhimisht pyjet dhe kullotat, apo pjesë të tjera të degraduara kanë nevojë të përmirësohen.

Administrimi i pyjeve i ka kaluar tashmë njësitë të qeverisjes vendore, por që kanë vështirësi në kryerjen e saj, për arsye të burimeve të pamjaftueshme financiare, stafeve, mjeteve, eksperiencës, etj. Ndërsa Ministria e Mjedisit, në linjë vertikale me Drejtorinë Rajonale në Shkodër dhe Sektorin Pyjor në Fushë-Arrëz kanë rolin e inspektimit dhe atë këshillimor në mbarëvajtjen e pyjeve. Por ndërkohë që njësitë e reja administrative nuk janë konsoliduar akoma, Sektori Pyjor i Fushë-Arrëzit ka reduktuar numrin e stafit nga 45 në 8 vetë, gjë që vështirëson realizimin e detyrave, duke mos përmendur këtu mungesën e mjeteve.




Figure 3 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit strategjik 1

8.4. Objektivi Strategjik 1 - Mbrotjtja e mjedisit

Biodiversiteti i hapësirës së Bashkisë Fushë-Arrëz e bën këtë Bashki shumë të ndjeshme për mbrotjen e saj. Një zonë e cila në historikun e saj ka ndërherë prishjen edhe dëmtimin e pyjeve për shkak të djegies dhe shpyllëzimit, nevojitet të mbrohet duke mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm

të pyeje edhe të mjedisit natyror. Ky mjedis duhet të mbrohet duke krijuar kufij të qartë të ndarjes së zonave natyrore, pyjet, me zonat ku lejohet zhvillimi i ndërtimit apo tjetër lloj ndërhyrje në territor.

Në këto kushte ky objektiv strategjik i Bashkisë nënkupton krijimin e itinerareve në zonat natyrore duke mundësuar ruajtjen e pyjeve si dhe duke rritur ndjeshmërinë e turistëve të mundshme në lëvizjen e tyre në këto zona duke mos dëmtuar florën edhe faunën.

Një aspekt pozitiv që vihet re vitet e fundit është se sa vjen dhe po rritet interesi i komunitetit për menaxhimin më të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave duke synuar tek agro-pylltaria (në një pyll shumë funksional) që do të thotë që në pyllin e tyre banorët të kenë sa më shumë lloje dru pyjor dhe frutor të harmonizuar së bashku për plotësimin e nevojave të tij.

Pavarësisht se brenda territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz nuk ka zona të mbrojtura natyrore ekzistuese, zona **Masivi i Krrabit** dhe **Kunore Dardhë dhe Mali i Munellës** kanë potenciale për propozimin e tyre si zona të mbrojtura natyrore.

Me rëndësi është specia e mbrojtur me ligj, Rrethqebulli (**Macja e Ballkanit**), i cili gjendet Masivet të propozuara si zona të mbrojtura

E veçantë është shumëllojshmëria e botës shtazore, ku përmendim speciet e rralla si: Kaprolli, Macja e Egër dhe Ariu i Murrmë, ndërsa specie të shumta në numër mund të përmendet: Ujku, Dhelpra, Lepuri, Derrin i Egër, si edhe një shumëllojshmëri shpendësh shtegëtarë.

Gjithashtu mbrojtja e mjedisit kërkon:

- Krijimin e një koncepti të ndarjes që në burim, të mbetjeve urbane, sipas një kompozimi “praktik” të koshave të riciklimit, në përputhje me strategjinë e Ministrisë së Mjedisit si: Të riciklueshme (të thata); Organike/të ndryshme (të njoma); Të rrezikshme;
- Ndërtimi i landfilleve, duhet të bëhet me kritere tepër rigorozë si gjeologjike edhe teknike, nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë e plotë të specialistëve të kësaj fushe.

Në përmbledhjen e objektit strategjik numër 1 si më poshtë sugjerojmë:

- Propozimi i krijimit të zonave të mbrojtura si: Masivi i Krrabit, Kunorë Dardhë, Mali i Munellës etj
- Ruajtja e botës shtazore sidomos për speciet e rralla si: rrethqebulli etj.
- Ruajtja edhe mbrojtja e pyjeve nga shpyllëzimi dhe djegia
- Krijimi i itinerareve lëvizëse në pyje, identifikimi i tyre
- Përcaktimi i kufijve të saktë të zonave natyrore për të mos lejuar ndërtim

8.4.1 Programet strategjike për OS1

1.1.Mbrojtja e resurseve ujore

Bashkia e Fushë-Arrëzit është e pasur edhe me burime ujore. Në fshatin Kryezi të njësisë administrative Qafë-Mali buron lumi Fan i Madh, që gjarpëron në krah të qytetit të Fushë-Arrëzit, dhe më tej në njësinë administrative Gjegan, derisa bashkohet me lumin Fan i Vogël në perëndim të qytetit të Rrëshenit, dhe pas disa kilometrash bashkohet me lumin Mat. Ai ka vlera ekonomike

dhe klimatiko-mjedsore, por që fakteqsisht, është ndotur nga derdhja e mbetjeve të fabrikës së pasurimit të bakrit në Fushë-Arrëz. Për shkak të natyrës së mbetjeve, që përmbajnë metale të rënda, përdorimi i ujit paraqet probleme, si për njerëzit ashtu edhe për florën dhe faunën. Gjithashtu, në të derdhen edhe ujrat e zeza të qytetit të Fushë-Arrëzit, si dhe ato të fshatrave përgjatë rrjedhës së tij. Si rezultat i burimeve ujore që zotëron, në Bashkinë e Fushë-Arrëzit po ndërtohen edhe disa hidrocentrale, relativisht të vegjël, por që mund të kenë një ndikim afatgjatë në ekosistemin përkatës.

1.1.A. Projekt – “Pastrimi dhe mbrojtja e lumit Drin” projekt që konsiston në evidentimin e zonave përgjatë lumit ku ka depozitime të mbetjeve urbane, rrëshkitje të dherave apo pengesa të tjera që bëjnë që lumenjtë të ndoten dhe të kethehen në rrezik për mjedisin dhe njeriun si dhe marrja e masave për pastrimin e mbetjeve dhe përforcimin e luginave të këtyre lumenjve në zonat me rrezik për rrëshkitje.

1.1.B. Projekt – “Pastrimi dhe mbrojtja e lumit Lumit Fan ” ky projekt konsiston Pastrimi dhe sistemimi i shtratit të lumit Fan nga mbetjet urbane dhe depozitimet e ndryshme të dherave apo pengesa të tjera që bëjnë që lumenjtë të ndoten dhe të kethehen në rrezik për mjedisin dhe njeriun si dhe marrja e masave për pastrimin e mbetjeve dhe përforcimin e luginave të këtyre lumenjve në zonat me rrezik për rrëshkitje.

1.1.C. Projekt - "Zyrtarizimi i ditës së lumenjve (organizimi i aktiviteteve për pastrimin, ekskursionet, etj.)", me zyrtarizimin e ditës së lumenjve nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz, do të mundësohet krijimi i një dite me aktiviteteve social kulturore me temë lumenjtë. Ky projekt do të përfshijë në aktivitetet që do të zhvillohen të gjithë banorët e Fushë-Arrëzit dhe në veçanti të rinjtë dhe nxënësit e shkollave. Të gjithë të interesuarit do të bëhen pjesë e programit që do të hartohet nga Bashkia me rastin e kësaj dite, duke prezatuar punime të tyre në sfera të ndryshme si të artit, shkencës, kulturës apo duke u përfshirë në aktivitete sportive që Bashkia do të ideojë me këtë rast. Përveç faktit se ky projekt do të rrisë ndjeshmërinë qytetare ndaj lumenjve dhe hapësirave të përbashkëta do ti krijojë mundësinë Bashkisë Fushë-Arrëz ta shfrytëzojë dhe si një atraksion turistik shtesë.

1.1.D. Projekt - "Ngritja e pritave për sedimentet përgjatë rrjedhave ujore", vendosja e këtyre pritave do të sigurojë që të mos krijohen grumbullime sedimentesh të sjella nga rrjedha e lumenjve të cilët jo rrallë herë janë bërë shkaktarë për daljen nga shtrati të lumenjve sidomos në sesonin e shirave.

1.1.E. Projekt - "Vendosja e barrierave pritëse për mbetjet urbane në degëzimet e lumit Drin në brendësi të Bashkisë", në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, Bashkia Fushë-Arrëz duhet të sigurohet të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të saj ligjore dhe kapaciteteve ekonomiko-profesionale që ajo zotëron, në dhënien e kontributit të saj në mbrojtjen e mjedisit jo vetëm në kufijtë e saj por dhe atë jashtë këtyre kufijve. Ndaj projekti në fjalë konsiston në vendosjen e barrierave që filtrojnë mbetjet urbane që mund të derdhen në këto sipërfaqe. Ato do të montohen tërthor me rrjedhën e ujit në degëzimet e lumit Drin të cilat zgjaten në territorin e Bashkisë, në mënyrë që të mos lejojnë derdhjen e mbetjeve direkt në lumin Drin.

Këto barrjera përveç grumbullimit të mbetjeve do të mundësojnë dhe pastrimin e tyre në momentin që kanë arritur kapacitetin e tyre mbajtës, ose në raste kur vërehen fryrje të ujit dhe mbetjet e grumbullura mund të përbëjnë pengesë për rrjedhjen e ujit. Adminitrimi i tyre ti lihet drejtorisë së pastrimit të mbetjeve urbane pranë Bashkisë, ku të ngrihet një grup i posacëm që veç të tjerash do të merret me pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.




Figure 4 Harta e projektit të vendosjes së barierave mbrojtës në degëzimet e lumit Drin


1.2. Ruajtja dhe mirëmbajtja e resurseve natyrore

1.2.A. Projekt – “Hartimi i planit lokal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane”, e nevojshme në Bashkinë e Fushë-Arrëzit është hartimi i një plani afat mesëm të qartë për menaxhimin e mbetjeve të gurta urbane, nga ku Bashkia të marrë përsipër realizimin e tij me fonde lokale apo të formave të tjera. Me anë të këtij plani Bashkia Fushë-Arrëz do të përcaktojë saktësiht cilat janë zonat më të ndotura në territorin e saj dhe veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim pastrimin e tyre.

Gjithashtu ky plan do të vlerësojë nevojën dhe shpërdarjen e koshave nëpër vendbanimet e Bashkisë Fushë-Arrëz, sidomos në ato rurale ku aktualisht mungojnë. Njëkohësisht do të vlerësojë nevojën për kamiona për grumbullim-transport të mbetjeve si dhe intervalet kohore gjatë të cilëve do të bëhet transporti i mbetjeve nga koshat e mbeturinave drejt pikës së grumbullimit.

1.3. Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga shpyllëzimi


1.3.A. Projekt – “Ndërtimi i pikave të vrojtimit për kontrollin e sipërfaqeve pyjore të Bashkisë”, ky projekt konsiston në ndërtimin e disa pikave të vrojtimit të cilat do u vijnë në ndihmë punonjësve të Bashkisë për të kontrolluar aktivitetet njerëzore dhe natyrore në sipërfaqet pyjore të Bashkisë, të cilat sjellin dëmtim të këtyre sipërfaqeve. Konstatimi në kohë i aktiviteteve të dëmshme për pyjet do të bëjë të mundur marrjen e masave në kohë për zhbërjen e tyre.



Harta 10 Harta e projektit të ndërtimit të pikave të vrojtimit

1.3.B. Projekt – “Ngritja e një sistemi monitorimi të zonave pyjore të Bashkisë”, ky projekt do të konsistojë në krijimin e një databaze për të monitoruar rrezikun e shpyllëzimit dhe konsumit të tokës bujqësore dhe gjuetisë. Zhvillimin e masave për mbrojtjen e zonave pyjore. Programimin e fushatave për sensibilizimin dhe informimin e popullsisë të Bashkisë. Rritjen e kontrollit dhe gjoba për gjuetinë e paligjshme. Kufizim i shfrytëzimit të drurit dhe masa kompesimi në zonat ku kryhen këto aktivitete.

1.3.C. Projekt – “Projekt pyllëzimi - Mbjellja e fidanëve të rinj të kulturave vendase në sipërfaqet pyjore të dëmtuara”, rijetëzimi i sipërfaqeve pyjore të dëmtuara nga dora e njeriut apo shkaqet natyrore do ti shtojë vlerat fondit pyjor të Bashkisë si dhe do të mbrojë këto zona nga rrëshkitje të mundshme të dherave.



Harta 11 Harta e projektit të pyllëzimit.

1.3.D. Projekt - "Vlerësim i burimeve gjenetike kryesisht për speciet pyjore dhe identifikimi i pyjeve për ruajtjen e shumllojshmërisë", kategorizimi i llojeve të drurëve pyjorë do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sipërfaqeve pyjore në territorin e Bashkisë së Fushë-Arrëzit. Ky projekt do të ndërmarrë krijimin e databazave për klasifikimin e specieve pyjore, pasqyrimi i kësaj dtabaze si në hartat përkatëse ashtu edhe në terren me anë të treguesve të posaçëm, përcaktimin specieve pyjore që nuk duhet të priten për ngrohje apo si lëndë drusore, etj.


1.4.Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura

1.4.A. Projekt – “Hartëzimi dhe zhvillimi i bazës së të dhënave për habitatet natyrore”, një pasqyrë e saktë dhe e plotë e të gjithë elementëve natyrorë që ndodhen në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz si dhe përcaktimi i saktë i kufijve të tyre do të japë një kontribut të veçantë në ruajtjen dhe kultivimin e shtetit natyror në këtë Bashki. Gjithashtu do të krijojë një mekanizëm për vlerësimin e rrezeve ndaj të cilëve habitatet natyrore janë të ekspozuar si dhe pasojat e mundshme të prodhuara në mënyrë periodike nga ky sistem.

1.4.B. Projekt - “Promovimi dhe informimi i banorëve vendas dhe vizitorëve për ekzistencën e zonave natyrore të mbrojtura dhe rëndësinë e tyre”, me anë të fushatave në terren por edhe në media Bashkia Fushë-Arrëz duhet të promovojë dhe informojë qytetarët e saj dhe ata jashtë territorit të Bashkisë lidhur me ekzistencën e zonave natyrore të mbrojtura dhe monumneteve të natyrës që ndodhen në territorin e Bashkisë. Kjo është përveçse një formë sensibilizimi dhe një formë reklamimi të resurseve natyrore. Informimi do të kryhet duke përdorur:

- tabela informuese të vendosura përgjatë rrugëve kryesore të Bashkisë
- shpërndarja e fletëpalosjeve për banorët e Fushë-Arrëzit dhe vizitorët
- financimi i një spoti publicitar në një nga televizionet kombëtare
- organizimi i orëve tematike për nxënësit e shkollave

Projektet prioritare/pilot

SKEDA E PROJEKTIT - 1	
Lloji i Projektit	Prioritar
Emri i Projektit	“Projekt pyllëzimi - Mbjellja e fidanëve të rinj të kulturave vendase në sipërfaqet pyjore të dëmtuara.”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 1: “Mbrojtja e Mjedisit”
Vendndodhja	Projekti ka si synim mbjelljen e fidanëve në zonën e Munellës .
Harta	
Sektori	05_Mbrojtja e Mjedisit
Programi	056_Mbrojtja Mjedisore
Faza	Afat gjatë (4-10 vite)
Tipologjia	Kujdesi për mjedisin

Kohëzgjatja	4 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Bashkia Fushë-Arrëz është një ndër bashkitë të cilat mbartin sipërfaqen më të madhe të pyjeve në Shqipëri. Sistemi Natyror zë 87.4 % të sipërfaqes së Bashkisë. Shfrytëzimi i pakontrolluar i sipërfaqes pyjore dhe djegia e tyre gjatë 28 viteve ka sjellë që një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është dëmtuar duke sjell dhe dëmtim të florës dhe faunës . Mbjellja e bimësisë dhe pemëve propozohet të jetë sipas llojeve që rriten
	aktualisht në Fushë-Arrëz si : pisha ,dushku dhe ahu.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	339,596,123.53 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Pashkëpunim publik – privat - Ministria e turizmit dhe mjedisit - Drejtoria e pyjeve Bashki
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i një projekti ku të përcaktohen saktë në harta kufijtë e hapësirave ku do të ndërhyet, llojet e fidanëve që do të përdoren si dhe sasia. - Hartimi i një kalendari pune që mbulon kohëzgjatjen e parashikuar në këtë skede - Ngritja e grupit të punës ku duhet përfshihen specialiste të Bashkisë dhe grupet e punës që do te bëjnë mbjelljen në terren - Sigurimi i fondeve
Treguesi i monitorimit	Rritja e numrit të pemëve në fund të 4 vjeçarit në parcelat ku do të ndërhyet, hartimi i tabelave krahasuese dhe vënia në dispozicion të publikut.

SKEDA E PROJEKTIT - 2	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Vendosja e barrierave pritëse për mbetjet urbane në degëzimet e lumit Drin në brendësi të Bashkisë”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 1: “Mbrotjtja e Mjedisit”
Vendndodhja	Projekti ndërhyr në segmentet e lumit Drin që dëgëzojnë në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

Harta	
Sektori	05_Mbrotjtja e Mjedisit
Programi	056_Mbrotjtja mjedisore
Tipologjia	Kujdesi për mjedisin
Faza	Afat mesëm (1-3 vite)

Kohëzgjatja	3 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, Bashkia Fushë-Arrëz duhet të sigurohet të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të saj ligjore dhe kapaciteteve ekonomiko-profesionale që ajo zotëron, në dhënien e kontributit të saj në mbrojtjen e mjedisit jo vetëm në kufijtë e saj por dhe atë jashtë këtyre kufijve. Ndaj projekti në fjalë konsiston në vendosjen e barrjerave që filtrojnë mbetjet urbane që mund të derdhen në këto sipërfaqe. Ato do të montohen tërthor me rrjedhën e ujit në degëzimet e lumit Drin të cilat zgjaten në territorin e Bashkisë, në mënyrë që të mos lejojnë derdhjen e mbetjeve direkt në lumin Drin.
	Këto barrjera përveç grumbullimit të mbetjeve do të mundësojnë dhe pastrimin e tyre në momentin që kanë arritur kapacitetin e tyre mbajtës, ose në raste kur vërehen fryrje të ujit dhe mbetjet e grumbullura mund të përbëjnë pengesë për rrjedhën e ujit. Adminitrimi i tyre ti lihet drejtorisë së pastrimit të mbetjeve urbane pranë Bashkisë, ku të ngrihet një grup i posacëm që veç të tjerash do të merret me pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	12,587,143 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Bashkëpunim publik – privat - Ministria e mjedisit - Drejtoria e menaxhimit të mbetjeve urbane
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i një projektzbatimi për llojin dhe mënyrën e vendosjes së këtyre barrjerave - Montimi i barrjerave në degëzimet e lumit Drin në brendësi të Bashkisë
Treguesi i monitorimit	Montimi i barrjerave në degëzimet e lumit Drin në territorin e Bashkisë

SKEDA E PROJEKTIT - 3	
Lloji i Projektit	Prioritar
Emri i Projektit	"Ndërtimi i pikave të vrojtimit për kontrollin e sipërfaqeve pyjore të Bashkisë".
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 1: "Mbrojtja e Mjedisit"
Vendndodhja	Territori i Bashkisë Fushë-Arrëz.

Harta	PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË FUSHË-ARRËZ. HARTË KULLAT E VROJTIMIT LEGJENDË - Kullë - Gjyë - Forat - Proj. Pajez Emri i Projektit "Ndërtimi i pikave të vrojtimit për kontrollin e sipërfaqeve pyjore të Bashkisë" Skema Kullë
Spektori	05_Mbrojtja e Mjedisit
Programi	056_Mbrojtja Mjedisore
Tipologjia	Infrastrukturë mjedisore

Faza	Afatshkurtër (1 vit)
Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Synimi kryesor i këtij projekti është përcaktimi i pikave të vrojtimit të pyjeve si dhe ndërtimi i infrastrukturave përkatëse për kryerjen e këtij shërbimi. Ndërtimi i kullave të vrojtimit të pajisura me teknologjinë më të fundit në kryerjen e vrojtimit të pyjeve. Do të sjellë rritjen e cilësisë në punën për
	mirëmbajtjen e pyjeve në Bashkinë Fushë-Arrëz.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	160,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Bashkëpunim publik – privat - Ministria e mjedisit - Bashkia Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Përcaktimi i pikave ku do të ndërtohen kullat e vrojtimit - Përcaktimi i modelit të kullave të vrojtimit - Ndërtimi i kullave në pikat e evidnetura
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i ndërtimit të kullave të vrojtimit në të gjitha pikat e parashikuara.

8.5. Objektiv Strategjik 2 - Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm duke promovuar asetet natyrore dhe kulturore në Fushë-Arrëz

Monumentet kulturore:

1. Kalaja e Micoj
2. Kështjella e Fletit
3. Banesa e Stak Mash Binakut dhe Pjetër Binakut
4. Kalaja e Sakatit
5. Banesa e Nikoll Preng Rrapi
6. Zona Mbrojtëse e Banesës së Nikoll Preng Rrapi

Monumentet natyrore:

Status mbrojtje (Kategoria III) listohen si më poshtë:

1. Gështenjat e Kokdodit
2. Qarret e varrezave të Shenkollit
3. Qarri i Xhamisë së Kryeziut
4. Ujëvara e Kryeziut
5. Karsti i Munellës
6. Pisha e Dardhës
7. Pisha e Shejzës.

Këto pika evidentohen që të bëhet i mundur restaurimi dhe përdorimi i këtyre monumenteve si pika atraksioni turistik.

Shpallja e monumeteve të mësipërme pikëpamja natyrore por edhe kulturore bëjnë të mundur rritjen e zhvillimit të turizmit në Bashkinë e Fushë-Arrëzit. Këto pika nëpërmjet marketingut dhe rrtijes së pikave të informacionit në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë rrisin ndjeshmërinë edhe njohurinë e banorëve lokal dhe turistëve të huaj kundrejt tyre.

Propozime të tjera, të lidhura edhe me PPK-në për këtë Bashki ku përfiton vetë Bashkia është është itinerari i biçikletave, që nis nga liqeni i Fjerzës, përshkon përmes territorit të Bashkisë Fushë- Arrëz dhe përfundon në Pukë. Një intinerar që është pjesë e rrjetit të rrugëve të biçikletave në hapësirat natyrore të gjithë Shqipërisë. Propozim tjetër është dhe krijimi i intinerarit Vozitës, i cili lidh të gjithë qytetet bregdetare të shqipërisë me rrugë detare. Dhe vazhdon nëpërmjet grykëderdhjes së lumit Drin në Velipojë, drejt liqenit të Fjerzës në Kukës, një intinerar gjatë së cilit përshkon thuajse të gjithë kufirin verior të territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz. Nga ku Fushë-Arrëzi ka mundësi të bëhet pjesë e inegruar e guidave turistike që do të përfshijnë këtë intinerar.

Lidhja me këto zona krijon mundësinë që turistët nëpërmjet pikave të informacionit të njihen edhe më tepër me pikat e rëndësishme të zhvillimit turistik të Fushë-Arrëzit, jo vetëm si pikë tranzit po si pikë ku mund të bëhet ndalesë më e gjatë në të.

Nga të dhënat e listuara më sipër nxjerrim pikat kryesore në lidhje me zhvillimin e objektit strategjik numër 2:

- Propozimi i pikave infopoint për në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë
- Krijimi i hartave turistike edhe itinerarëve lëvizëse në pyjet e Bashkisë
- Ruajtja e biodiversitetit të Fushë-Arrëzit si element për zhvillimin e turizmit
- Ngritja e një sektori në Bashki për turizmin edhe marketimin e tij
- Bashkërendimi me Bashkitë kufitare për të krijuar itinerareve turistike në vazhdimësi nga njëra Bashki në tjetrën
- Rritja e vëmendjes së fshatit të Kryeziut si pjesë e projektit pilot 100 fshatrat




Figure 5 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 2

PROGRAMET STRATEGJIKE

2.1.Krijimi i shtigjeve dhe hartave turistike për territorin e Bashkisë.

2.1.A. Projekt – “Shpërndarja në territorin e Bashkisë të pikave të informimit për turistët”, ky projekt konsiston në krijim e një rrjeti informimi për vizitorët e Bashkisë Fushë-Arrëz, të cilat do të përfaqësohen nga stenda ku paraqiten harta dhe informacione lidhur me destinacionet turistike të Bashkisë. Gjithashtu në qytetin e Fushë-Arrëzit të ndërtohet dhe një pikë informimi ku punonjës të Bashkisë tu ofrojnë vizitorëve fletëpalosje apo harta dhe udhëzime në ndihmë të vizitës që ata planifikojnë.



Harta 12 Shpërndarja e pikave të informacionit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

2.1.B. Projekt – “Ndërtimi i shtigjeve turistike në malin e Munellës”, evidentimi i shtigjeve natyrore në malin e Pashtrikut me anë të piketave që tregojnë drejtimin që duhet të ndjekësh si dhe pasqyrimi i këtyre shtigjeve në harta të cilat vendosen në dispozicion të vizitorëve me antë të fletëpalosjeve që shpërndahen në pikat e informacionit.



Figure 6 Intinerar i propozuar në shtigjet e malit të Munellës

2.1.C. Projekt – "Hartëzimi i zonave turistike në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz (Hartë për zonat natyrore me akseset përkatëse, hartat monumentale me akseset përkatëse) dhe trajnimi i personelit", Bashkia duhet të krijojë guida turistike të cilat me anë të punonjësve të trajnuar do të shoqërojnë kundrejt pagesave të paracaktuara grupe vizitorësh apo individë përgjatë destinacioneve turistike që ndodhen në territorin e Bashkisë.


2.1.D. Projekt – “Trajnimi i të rinjve për krijimin e guidave turistike brenda territorit të Bashkisë Fushë-Arrëz”, me anë të këtij projekti Bashkia e Fushë-Arrëzit u krijon mundësi të rinjve të kësaj Bashkie të trajnohen për krijimin e intinerareve turistike përgjatë sipërfaqes së territorit të Bashkisë së Fushë-Arrëzit. Duke krijuar kështu mundësi punësimi si dhe nxitje të turizmit në këtë Bashki. Ky projekt do të:

- ngrejë një staf profesionistësh në fushën e turizmit për trajnimin e të rinjve të interesuar
- krijojë programin e trajnimit
- të sigurojë periudha praktike pas trajnimit
- ti mbështesë financiarisht iniciativat e kursantëve pas trajnimit

2.2.Përfshirja në ofertën turistike të monumenteve të kulturës dhe natyrës

2.2.A. Projekt – “Krijimi i intinerareve kulturore” si një krahinë me traditë të gjatë në aktivitetet kulturore, Bashkia e Fushë-Arrëzit duhet të krijojë intinerare njëditore për të vizituar objektet

monument kulture. Përfshirja në këtë intinerar i shtëpive muze që parashikon pika më sipër është detyrim për ta bërë intinerarin sa më tërheqës dhe të kompletuar.



Harta 13 Harta e vendodhjes së monumenteve natyrore dhe kulturore në Bashkinë Fushë- Arrëz

2.2.B. Projekt – “Ndërtimi i Memorialit në ish-burgun e Qafë-Brarit.”, Ish-Burgu i Qafë Brarit ka qenë një nga burgjet më famëkeqe gjatë sistemit komunist ku dërgoheshin në internim të burgosurit politik.

nga të dhënat e Bashkisë, gjatë sistemit komunist kanë humbur jetën 35 persona duke bërë që ky burg të ketë një ndjeshmëri të lartë nga banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz.



Figure 7 Foto në ish-burgun e Qafë-Brarit

2.3.Nxitja e marketingut

2.3.A.Projekt. - "Ngritja e një sektori në Bashki për turizmin dhe marketimin e tij", si fillim për nxitjen e marketingut është e rëndësishme krijimi i këtij sektori nga Bashkia ku do të ketë staf i cili do

[illegible]

2.3.B. Projekt – "Organizimi i aktiviteteve për çeljen e sezonit turistik" hartimi i një projekti për organizimin e një aktiviteti festiv me qëllimin e promovimit të turizmit, aty të propozohet dhe një datë që të njihet si dita e çeljes së sezonit turistik si dhe kohëzgjatja e sezonit turistik. Gjithashtu të përcaktohen dhe aktivitete social-kulturore dhe sportive që do të organizohen nga Bashkia gjatë periudhës së sezonit turistik.


78



Figure 9 Pozicionimi i InfoPointit në Hartë

2.4.Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit në lidhje me mjedisin


2.4.A. Projekt – " Krijimi i intinerarit vozitës ne Liqenin e Komanit ", shfaq një ofertë turistike shumë tërheqëse për vizitorët. Intinearari është menduar të nisë në fshatin Fjerzë pranë rezervuarit i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh22 dhe të përfundojë në fshatin e Komanit pranë rezervuarit te tij, i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh25. Në këtë intinerar bëhen bashkë natyra që është vozitja nëpër liqenin e Komanit me aktivitetin njerëzor i cili përfaqësohet nga struktura agroturistike pranë fshatit të Komanit. Duke ofruar kështu një destinacion turistik të kompletuar për vizitorët.




2.4.B. Projekt – “Ndërtimi i itinierarit të biçikletave Fjerzë-Dardhë” Krijimi i interierarit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës së infrastrukturës.




2.4.C. Projekt – “Përcaktimi i pikave për kamping”, evidentimi dhe shtimi në hartat turistike të Fushë-Arrëz it të zonave dhe pejzazheve më të përshtatshme për kamping dhe ecje në natyrë, do të plotësonte ofertën turistike të Fushë-Arrëzit edhe me ofrimin e nje aktiviteti i cili është dhe trend i viteve të fundit.



Harta 16 Zonat e propozuara për kamping

SKEDA E PROJEKTIT - 6	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Ndërtim i intinerarit të biçikletave Fjerzë-Dardhë”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 2: “Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Përmasa	19.1 km
Harta/Fotot	
Sektori	08_Argëtimi\Kultura\Feja
Programi	081_ Shërbime Rekreative dhe Sportive

Tipologjia	Infrastrukturë mjedisore
Faza	Afatshkurtër (1vit)
Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Krijimi i interiorit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës të infrastrukturës. Me këtë projekt mundësohet lidhja e fshatit Dardhë me fshatin Fjerzë duke ndjekur rrjedhjen e lumit dhe përfundon në afërsi të Kalasë së Sakatit. Ky projekt rrit aksesin e turistëve në zonë duke ofruar një rrugë pejzazhiste.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	120,161,600 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Evidentimi i saktë i gjurmës së intinerarit turistik Fjerzë-Dardhë - Pasqyrimi i tij në harta turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese përgjatë gjithë intinerarit
Treguesi i monitorimit	Ndërtim i intinerarit në hartat turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese.

SKEDA E PROJEKTIT - 7	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	" Krijimi i intinerarit vozitës ne Liqenin e Komanit"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 2: “Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Harta/Fotot	
Spektori	08_Argëtimi\Kultura\Feja
Programi	081_ Shërbime Rekreative dhe Sportive
Tipologjia	Infrastrukturë mjedisore
Faza	Afatshkurtër (1 vit)

Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Krijimi i një intinerari vozitës përgjatë basenit të liqenit të Komanit, shfaq një ofertë turistike shumë tërheqëse për vizitorët. Intinearari është menduar të nisë në fshatin Fjerzë pranë rezervuarit i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh22 dhe të përfundojë në fshatin e Komanit
	pranë rezervuarit të tij, i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh25. Në këtë intinerar bëhen bashkë natyra që është vozitja nëpër liqenin e Komanit me aktivitetin njerëzor i cili përfaqësohet nga struktura agroturistike pranë fshatit të Komanit. Duke ofruar kështu një destinacion turistik të kompletuar për vizitorët.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	1,394,724 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Evidentimi i saktë i gjurmës së intinerarit turistik - Pasqyrimi i tij në harta turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese përgjatë gjithë intinerarit
Treguesi i monitorimit	Publikimi i intinerarit në hartat turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese

SKEDA E PROJEKTIT - 8	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Ndërtimi i një Infopointi në fshatin e Kryeziut si pjesë e projektit pilot 100 fshatrat”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 2: “Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Harta/Fotot	
Sektori	08_Shërbime të Përgjithshme Publike
Programi	82_ Shërbime Kulturore
Përmasa	80 m2
Tipologjia	Turizëm kulturor
Faza	Afatshkurtër (1 vit)
Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Kryeziu është pjesë e projektit të 100 Fshatrave i cili synon rritjen e turizmit historik, agroturistik dhe atij malor të zonës e cila ka shumë potenciale për të ofruar. Ndërtimi i InfoPoint në fshatin Kryezi synon të ofrojë informacione të detajuara, harta, shërbime guidash dhe suvenire të zonës për turistët që do frekuentojnë fshatin Kryezi.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz


Kosto e përafërt	2,500,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Drejtoria e Promovimit të Qytetit
Veprimet e nevojshme për zbatimin e	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Ndërtimi i ndërtesës në qendër të fshatit pranë rrugës kryesore - Për ndërtimin të përdoren materiale të zonës duke ruajtur tipologjinë e fshatit Kryezi
projektit	- Të informohen edhe banorët e gjithë rethit për ekzistencën dhe funksionin e Infopointit që me radhën e tyre të orientojnë turistët aty
Treguesi i monitorimit	Zhvillimi dhe rritja e informacionit për turistët

SKEDA E PROJEKTIT - 9	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Ndërtimi i memorialit në ish-burgun e Qafë-Brarit.”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 2: “Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz, Qafë -Brar
Harta	
Sektori	08_Argëtimi/kultura dhe feja
Programi	082_Shërbime kulturore
Tipologjia	Turizëm kulturor
Faza	Afatshkurtër (1 vit)

Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Ish-Burgu i Qafë Brarit ka qenë një nga burgjet më famëkeqe gjatë sistemit komunist ku dërgoheshin në internim të burgosurit politik. nga të dhënat e Bashkisë, gjatë sistemit komunist kanë humbur jetën 35 persona duke bërë që ky burg të ketë një ndjeshmëri të lartë nga banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	1,875,00 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Shpallja e një konkursi të hapur për propozime lidhur me memorialin për dëshmorët e luftës. - Krijimi i një aktiviteti ku të ekspozohen propozimet si dhe shpallja e fituesit, shpërdarja e cmimeve përkatëse. - Ndërtimi i memorialit
Treguesi i monitorimit	Ndërtimi i memorialit dhe krijimi i një aktiviteti për inagurimin e tij.

SKEDA E PROJEKTIT – 10	
Lloji i Projektit	Prioritar
Emri i Projektit	"Ngritja e një sektori në Bashki për turizmin dhe marketimin e tij"
Objektivi	Objektivi Strategjik 2: “Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore,
Strategjik	natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Harta/Fotot	
Sektori	08_Argëtimi/kultura dhe feja
Programi	082_Shërbime kulturore
Tipologjia	Administratë turizmi
Faza	Afat mesëm (1-3 vite)
Kohëzgjatja	3 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Për nxitjen e marketingut është e rëndësishme krijimi i këtij sektori nga Bashkia ku do të ketë staf i cili do organizoj dhe do e manaxhoj.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	26,000,000 ALL

Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Përcaktimi i zyrës në ambientet e Bashkisë
zbatimin e projektit	- Shpallje e një konkursi të hapur për vendet e reja të punës.
Treguesi i monitorimit	Ngritja e Sektorit dhe vënia në funksionim .

SKEDA E PROJEKTIT - 11	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Përcaktimi i pikave për kamping"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 2: "Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Fushë-Arrëz"
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Harta/Fotot	
Sektori	08_Argëtimi/ Kultura dhe Feja
Programi	081_ Shërbimet rekreative dhe sportive
Tipologjia	Turizëm në natyrë
Faza	Afatshkurtër (1vit)

Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Evidentimi dhe shtimi në hartat turistike të Fushë-Arrëzit të zonave dhe pasazheve më të përshtatshme për kamping dhe ecje në natyrë, do të plotësonte ofertën turistike të Fushë-Arrëzit edhe me ofrimin e një aktiviteti i cili është dhe trend i viteve të fundit.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	120,161,600 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Evidentimi i saktë i pikave të përshtatshme për kamping dhe organizimi i tyre - Pasqyrimi i tyre në harta turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese -
Treguesi i monitorimit	Publikim në hartat turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese

8.6.Objektiv Strategjik 3 - Përmirësimi i bujqësisë edhe blegtorisë

Diversiteti i peizazheve në Bashkinë e Fushë-Arrëzit si dhe historiku i zhvillimit të tij ka bërë të mundur zhvillimin e një sërë racash lokale autoktone bagëtish dhe bimësh.

Tokat e Fushë-Arrëzit kanë kushte të favorshme për zhvillimin e formave autoktone bimore si misrit, patates, specave, domateve kastravecave, patëllxhaneve, qepëve të vendit, lakrave fasuleve etj të cilat kanë vlera të larta ushqimore. Zhvillimi i këtyre produkteve bën të mundur profilizimin e Fushë-Arrëzit si një qendër e rëndësishme për rritjen e produkteve vendase. Kjo mundëson krijimin e zonave bujqësore ku mund të incentivohet rritja e këtyre produkteve me banorët vendas si dhe duke krijuar pika agroturizmi afër tyre për të rritur prodhimin e produkteve bio si dhe të konsumimit të tyre.

Krahas këtyre produkteve Fushë-Arrëzi është i pasur me specie dru frutorësh me një larmi kultivatorësh autoktonë. Produkte të tilla si arrat, mollët, dardhat, kumbullat, qershitë, ftonjë, gështenjat, luleshtrydhet, rrushi etj, dallohen për cilësinë e tyre të rritura në hapësira të përshtatshme për zhvillimin e tyre.

Krahas këtyre produkteve dallohen edhe speciet e bimëve mjekësore si" trumza, mendërza, kamomili etj të cilat kanë kërkesë jo vetëm në territorin vendas por edhe jashtë tij. Produkte bio të cilat mund të eksportohen në vendet fqinje për shkak të pozitës gjeografike të Fushë-Arrëzit.

Për shkak të praktikave të gabuara në të kaluarën një pjesë e këtyre produkteve si dhe pyjet kanë pësuar dëmtime të mëdha prandaj duhet të synohet mbrotja edhe kultivimi i tyre nga aktorët lokalë.

Nga të dhënat e listuara më sipër nxjerrim pikat kryesore në lidhje me zhvillimin e objektit strategjik numër 3:

3.5.1 Zhvillimi dhe mbarështimi i kafshëve të zonës

3.5.2 Zhvillimi i formave autoktone të bimëve si misri, patatja, bimë medicinale etj

3.5.3 Krijimi i pikave të agroturizmit në zona të përshtatshme për kultivimin e bimëve dhe mbarështimin e kafshëve

3.5.4 Zhvillimi i prodhimit vendas për të furnizuar nevojat lokale dhe eksport në vendet kufitare

3.5.5 Shtimi i prodhimit vendas të produkteve bio

3.5.6 Marketimi i produkteve vendase të zonës





Figure 10 Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 3"

Programet strategjike

3.1.Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë

3.1.A. Projekt – “Ndërtimi i pikës për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore vendase në Fushë-Arrëz”, shumë e rëndësishme në tregun e sotëm është organizimi në formë bashkëpunimi i bujqësisë dhe blegtorisë ku pushteti lokal duhet të luajë rolin e koordinatorit. Ky projekt konsiston në ndërtimin e një objekti ku të grumbullohen të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale dhe nga ku të tregëtohen si në tregun vendas (Bashkiak) ashtu dhe atë jashtë Bashkisë. Pronar dhe menaxhues i saj të jetë Bashkia si organi që përfaqëson interesat e të gjitha palëve. Në këtë pikë do të bëhet:

- kontrolli i përshtatshmërisë së produkteve bujqësore
- përpunimi i produkteve bujqësore, në pajtueshmëri me standartet minimale të cilësisë
- ambalazhimi i produkteve bujqësore, duke ruajtur dimensionet minimale dhe shkallët e madhësisë
- ruajtje e produkteve në frigoriferë



3.1.B. Projekt – “Hartimi i një plani biznesi për krijimin dhe menaxhimin e pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale”, si pronar dhe menaxhues i kësaj pike Bashkisë i lind detyra të hartojë një plan biznesi për menaxhimin e pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Ky projekt do të përcaktojë të gjitha format e mardhënieve me fermerët vendas si dhe mardhëniet me tregun vendas dhe atë jashtë territorit të Bashkisë. Përfshirja në këtë plan biznesi i emigrantëve duke i ftuar të investojnë në vendlindjen e tyre është një detyrim dhe përparësi, për një Bashki ku një pjesë e mirë e të ardhurave vijnë nga emigracioni.

3.1.C. Projekt – “Mbështetje e fermave për mbarështimin e kafshëve të zonës”. Krijimi i një fondi bashkiak nga buxheti i Bashkisë apo dhe donatorë të ndryshëm për mbështetjen e fermave vendase në procesin e shtimit të numrit të bagëtive. Bashkia do të përcaktojë fermat lokale që merren me mbarështimin e bagëtive të cilave do u mundësojë blerjen e një numëri të caktuar bagëtish në raport me numërin e krerëve që çdonjëra nga fermat ka.


3.2.Promovimi i produkteve vendase

3.2.A. Projekt – “Financimi i një spoti publicitar në një nga televizionet kombëtare për produktet vendase”, me rëndësi të veçantë në këtë rast është reklamimi, ndaj ky projekt bën të mundur shfaqjen e produkteve të Bashkisë Fushë-Arrëz kundrejt një morie konsumatorësh të mundshme duke bërë që të rritet numëri i personave të interesuar për produktet që prodhohen në Fushë-Arrëz por dhe ata që duan të vizitojnë Fushë-Arrëzin.

3.2.B. Projekt – “Krijimi i markave të produkteve bujqësore (frutat e pyllit, bimët mjekësore, produktet e bulmetit)”, Bashkia Fushë-Arrëz duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve. Projekti ka si qëllim:

- identifikimi i markës së zonës dhe krijimi i një emri të përbashkët dhe promovimi i saj në tregje lokale dhe kombëtare
- sigurimi i cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet një sistemi kontrolli
- marketing i markës me anë të krijimit të një faqeje në internet
- programim i evenenimeve për promovimin e produkteve bujqësore në nivel lokal dhe kombëtar


3.2.C. Projekt "Ndërtimi i tregjeve lokale për produktet bujqësore dhe blegtorale në Fushë-Arrëz" Si qendra të njësive administrative me anë të këtij projekti iu shtohet dhe një facilitet tjetër i nevojshëm për jetën e popullatës së këtyre vendbanimeve ai i tegut të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë mënyrë banorët e këtyre zonave nuk do jenë të detyruar të zhvendosen deri në Fushë-Arrëz për të blerë fruta-preime apo bulmet etj. Bashkia do të përcaktojë vendet ku do të ndërtohen dhe do të ndërtojë strukturat e posaçme të cilat do të përbëhen nga ambjente magazinimi, tregëtimi, etj. Këto ndërhyrje duhet të limitohen në dimensionet minimale të ndërtimit të strukturave pa çënuar funksionimin normal të tyre.

SKEDA E PROJEKTIT - 12	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit Objektivi Strategjik	" Ndërtimi i një pike për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në Fushë-Arrëz " Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase"
Vendndodhja Përmasa	Bashkia Fushë-Arrëz 1500 m ²
Harta/Fotot	
Sektori	04_ Çështjet ekonomike
Programi	042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia
Tipologjia	Rigjenerim i bujqësisë
Faza	Afatgjatë (4-10 vite)
Kohëzgjatja	7 vite
Kosto e përafërt	30,000,000 ALL

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Bashkia Fushë-Arrëz sikundër dhe shumica e Bashkive në territorin e Shqipërisë kanë toka bujqësore të cilët i shfrytëzojnë privatisht dhe më sipërfaqe të vogla, pa bashkëpunuar më njëri tjetrin. Kjo si rezultat sjell dhe prodhim më të ulët dhe kosto më të larta për prodhimin e produkteve bujqësore. Kjo bën të nevojshme ngritjen e infrastrukturës magazinuese dhe përpunuese si mënyrë për të grumbulluar sasi më të larta prodhimi nga fermerët e Bashkisë dhe përpunimi i tyre për të rritur vlerën e produktit. Sipas këtij projekti është e nevojshme ngritja e infrastrukturës së duhur në mënyrë që dhe banorët dhe kryesisht fermerët të bashkpunojmë mes tyre duke bashkuar njësitë e tyre të tokave bujqësore dhe në këtë mënyrë të rrisin prodhimin me më pak kosto dhe cilësi më të lartë. Kjo do të bëjë që produktet lokale të Fushë-Arrëzit të jenë konkurruese në treg. Ndërtimi i pikës grumbullimit ka pjesë ndërtimin e magazinës kryesore frigoferike të ruajtjes së produktit, sektorin e paketimit dhe të jetë e pajisur me logjistikën e duhur për ngarkim-shkarkimin e kamionëve transportues si dhe godina të ndërtohet pranë qytetit në Fshat Fushë-Arrëz
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Burimet e mundshme të financimit	Investim publik Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: Shpallja e një konkursi për të hapur për projektide të këtij segmenti Shpallja e fituesit të konkursit Hartimi i projektzbatimit nga ana e fituesit të konkursit Prezantimi i projektit për publikun Ndërtimi i veprës
Treguesi i monitorimit	Shitja e produkteve të para nën logon e brandit lokal.

SKEDA E PROJEKTIT - 13	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Krijimi i markave të produkteve bujqësore (frutat e pyllit, bimët mjekësore, produktet e bulmetit)”
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 3: “Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase”
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Harta/Fotot	-
Sektori	04_Çështjet ekonomike
Programi	041_Çështjet e përgjithshme ekonomike tregëtare dhe të punës
Tipologjia	Rigjenerim i bujqësisë
Faza	Afatshkurtëe (1 vit)
Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Bashkia Fushë-Arrëz duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve. Projekti ka si qëllim: • identifikimi i markës të zonës dhe krijimi i një emri të përbashkët dhe promovimi i saj në tregje lokale dhe kombëtare • sigurimi i cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet një sistemi kontrolli • marketing i markës me anë të krijimit të një faqeje në internet • programim i evenimenteve për promovimin e produkteve bujqësore në nivel lokal dhe kombëtar
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	375,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz

eprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Shpallja e një konkursi të hapur për propozime lidhur me logon për brandin lokal, përcaktimi i çmimeve për tri vendet e para. - Krijimi i një aktiviteti ku të ekspozohen propozimet si dhe shpallja e fituesit, shpërdarja e çmimeve përkatëse. - Takim me prodhuesit vendas për arritjen e një dakortësie lidhur me përcaktimin e logos fituese në amablazhin e produkteve të tyre
Treguesi I monitorimit	Shitja e produkteve të para nën logon e brandit lokal.

SKEDA E PROJEKTIT - 14	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Ndërtimi i tregjeve lokale për produktet bujqësore dhe blegtorale në Fushë-Arrëz"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase"
Vendndodhja	Bashkia Fushë-Arrëz
Përmasa	-
Harta/Fotot	
Sektori	04_ Çështjet ekonomike
Programi	042_ Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia
Tipologjia	Rigjenerim i bujqësisë
Faza	Afatgjatë (4-10vite)
Kohëzgjatja	5 vite

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Si qendra të njësive administrative me anë të këtij projekti iu shtohet dhe një facilitet tjetër i nevojshëm për jetën e popullatës së këtyre vendbanimeve ai i tegut të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë mënyrë banorët e këtyre zonave nuk do jenë të detyruar të zhvendosen deri në Fushë-Arrëz apo gjetkë për të blerë fruta-preime apo bulmet etj. Bashkia do të përcaktojë vendet ku do të ndërtohen dhe do të ndërtojë strukturat e posacme të cilat do të përbëhen nga ambjente magazinimi, tregëtimi, etj. Këto ndërhyrje duhet të limitohen në dimensionet minimale të ndërtimit të strukturave pa cënuar funksionimin normal të tyre.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	5,843,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Përcaktimi i pikave për cdonjërin nga njësitë ku do të ndërtohet tregu - Ndërtimi i strukturave që do të përdoren si treg - Ofrimi i këtyre hapësirave për tregëtarët vendas me anë të kontratave të bashkëpunimit me Bashkinë
Treguesi i monitorimit	Ndërtimi i strukturave të tregjeve dhe vënia e tyre në funksion

8.7. Objektiv Strategjik 4 - Përmirësimi i shërbimeve publike

Kushtet e dobëta të infrastrukturës primare të Bashkisë sjellin automatikisht largimin e popullsisë edhe mungesën e investimeve në zonë. Në këtë mënyrë kërkohet përmirësimi imediat i kushteve të tilla si rrjeti ujësjellës-kanalizime, energjisë elektrike, arsimit, shëndetësisë etj. Kushtet e dobëta të elementeve bazë për popullsinë kërkon që këto të fundit të lokalizohen ku janë më problematike dhe këshillohet ristrukturimi i tyre si dhe shtimi i pikave të tjera në Bashki për të mundësuar furnizimin e Bashkisë.

Furnizimi me ujë i popullsisë së Bashkisë së Fushë-Arrëzit është një ndër çështjet më shqetësuese. Zona ka pasuri ujore e veçanërisht burime uji të pijshëm, që dallohen për cilësi shumë të mirë si përmbajtja e ulët e mineraleve, ngarkesat e vogla mikrobiologjike, tejdukshmeri, freski, etj. Megjithatë problemi i ujit të pijshëm ngelet ende i pazgjidhur. Furnizimi me ujë të pijshëm i banorëve ka dy veçori, atë të qytetit të Fushë-Arrëzit dhe të fshatrave. Këto të fundit, për shkak të shtirjes në territor dhe numrit relativisht të kufizuar të banorëve, në disa raste kanë rrjetet e tyre të furnizimit dhe disa të tjera furnizohen direkt nga burimet natyrore, apo puset.

Qyteti i Fushë-Arrëzit furnizohet nga dy burime, ai i Krrabit dhe ai i Micojt, me gjatësi linje, përkatësisht, 7 km dhe 3.5km, që shkarkohen në të njëjtin rezervuar. Në fakt, ujësjellësi i Krrabit ka nevojë të rikonstruktohet në 50% të tij. Gjithashtu, rrjeti shpërndarës i brendshëm, i qytetit, është i amortizuar duke sjellë humbje në sasinë e ujit, por edhe ndotje të tij. Investimi në këtë rrjet është i domosdoshëm jo vetëm për të adresuar çështjet e higjienës së ujit, por edhe të mirëmenaxhimit të tij duke vendosur sahatet matës për çdo familje.

Gjatë fazës së hulumtimit dhe zhvillimit të analizës vihet re se infrastruktura rrugore brenda Bashkisë ka mangësi. Bashkinë e Fushë-Arrëzit e përshkon rrjeti rrugor kombëtar që në total arrin në 116km. Ndërsa qyteti i Fushë-Arrëzit ka 2 km rrugë të brendshme. Rrjeti i rrugëve lokale është rreth 186km. I gjithë rrjeti është në përdorim dhe shfrytëzohet nga banorët. Në përgjithësi gjëndja e rrugëve nuk është e mirë, pasi mirëmbajtja e tyre ose është në nivel të pamjaftueshëm, ose nuk ekziston fare. Më problematike paraqiten, segmenti kombëtar Reps – Fushë-Arrëz, segmenti kombëtar Fushë-Arrëz – Pukë (në pjesën e njësive administrative Rrapë), rrugët lokale që lidhin fshatrat me qendrat e njësive administrative. Ka nevojë për asfaltimin e 1,5 km rrugë të brendshme në qytet, por edhe të rrugëve lokale. Së fundmi, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka financuar ndërtimin e rrugës Fushë-Arrëz – Iballë, rreth 33 km e gjatë, një rrugë me standarde. Këto rrugë pengojnë në këtë mënyrë zhvillimin e Bashkisë si pasojë e mungesës së lidhjes primare e cila kërkon përmirësimin e këtyre akseve problematike. Qyteti ka edhe linja brenda Bashkisë duke e lidhur atë me njësitë administrative dhe fshatrat por gjëndja e tyre paraqitet jo e mirë.




Figure 11 Diagrama e zërthimit të "Objektivit Strategjik 4"

Programet strategjike

4.1.Përmirësimi i rrugëve ekzistuese lokale

4.1.A. Projekt – "Asfaltim i aksit rrugor Fushë-Arrëz – Micoj", Rikonstruksion i ketyre sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave duke i integruar me qytetin e Fushë-Arrëzit, gjithashtu zvogëlohet

koha e lëvizjes nga fshatrat drejt qendrës dhe anasjelltas si dhe do i japë një dorë zhvillimit ekonomik duke i dhënë mundësinë fermerëve që të kenë akses më të lehtë drejt tregut.



Figure 12 Rruga Fushë-Arrëz – Micoje cila propozohet për sitemim dhe asfaltim

4.1.B. Projekt – “Asfaltim i aksit rrugor Fushë-Arrëz – Lumbardhë”, gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Asfaltimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull .

4.1.C. Proejkt – “Asfaltim i aksit rrugor Iballë-Fjerzë”, gjëndja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit . Asfaltimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull .

4.1.D. Projekt – “Hartimi i një plani afatgjatë masash për mirëmbajtjen e rrugëve lokale”, me asfaltimin e rrugëve lokale është shumë e rëndësishme që bashkia të hartojë një plan masash për mirëmbajtjen periodike të tyre ose mirëmbajtjen nga dëmtimet apo bllokimet (si për shembull bllokimet e rrugëve nga bora) e mundshme nga faktorët atmosferikë. Ky plan duhet të hartohet në formën e studimit i cili do të përcaktojë dhe një kosto mestare vjetore të mirëmbajtjes.

4.1.E. Projekt – “Sistemim asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatrave që janë dhe njësi

administrative”, si qendra të njësive administrative fhatrat Micoj, Fierzë, Iballë, janë dhe fshatrat me popullsinë dhe aktivitet më të lartë njerëzor prandaj shihet me përparësi sitemimi dhe asfaltimi ti rrugëve dhe rrugicave të këtyre pasi në gjendjen aktuale banorëve u vështirësohet shumë aksesimi në këto qendra sidomos në perudhën e dimrit.

4.1.F. Hapje traseje rruge auto Përroi Bugjon fshati Aprripe Guri Njësia Fierzë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Ndërtimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës.

4.2.Përmirësimi i kushteve të ujësjellës-kanalizimeve

4.2.A. Projekt – “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të qytetit Fushë-Arrëz”, infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve është një nga më të rëndësishmet ndër infrastrukturën që përdoren nga njeriu. Përveç sigurimit të ujit të pishmëm kjo infrastrukturë siguron dhe pastërtinë dhe shëndetin e njeriut dhe mjedisit ku funksionojnë. Prandaj ky projekt synon të plotësojë nevojat e banorëve të Fushë-Arrëzit.

4.2.B. Projekt – “Shtimin e pikave të furnizimit me ujë pijshëm të Bashkisë”, nga konsultat dhe shqyrtimi i situatës në terren na rezultoi se sasia e ujit që merret nga burimi i Vrellës nga ku shpërndahet nëpër qytet nuk është e mjaftueshme për të siguruar ujë për të gjithë popullsinë e Fushë-Arrëzit. Ndaj ky projekt ka për qëllim gjetjen e një ose disa pikave të tjera për të shtuar sasinë e prurjeve të ujit në rrjetin e ujësjellësit, në përshtatje me nevojat e popullsisë duke marrë parasysh dhe ndërtimin e rrjeteve të fshatrave të parashikuar në këtë dokument.

4.2.C. “Evidentimi i pikave të reja për kanalizimet që duhet të përfshijnë të gjithë territorin e ri pas reformës territoriale të Bashkisë Fushë-Arrëz ”

4.2.D. “Studim projektim ndërtimi i ujësjellësit të fshatit kryezi” Bashkia Fushë-Arrëz, ky projekt ka për qëllim ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për të shtuar sasinë e prurjeve të ujit, në përshtatje me nevojat e popullsisë.

4.3.Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi

4.3.A. Projekt – “Rikonstruktion i godinës së qendrës shëndetësore Berishë e Vogël”, Ky projekt do çojë shërbimin shëndetësor pranë banorëve të këtyre zonave duke i çliruar nga ankthi dhe vështirësitë e zhvendosjes së të sëmurëve drejt Fushë-Arrëzit sidomos në stinën e dimrit kur shpesh rrugët janë të bllokuara.

4.3.B. Projekt – “Rikonstruktion i godinës së qendrës shëndetësore Arst-Milsia”, Ky projekt do çojë shërbimin shëndetësor pranë banorëve të këtyre zonave duke i çliruar nga ankthi dhe vështirësitë e zhvendosjes së të sëmurëve drejt Fushë-Arrëzit sidomos në stinën e dimrit kur shpesh rrugët janë të bllokuara.

4.3.C. Projekt – “Rikonstruktion i godinës së qendrës shëndetësore Xath”, Ky projekt do çojë shërbimin shëndetësor pranë banorëve të këtyre zonave duke i çliruar nga ankthi dhe vështirësitë e zhvendosjes së

të sëmurëve drejt Fushë-Arrëzit sidomos ne stinën e dimrit kur shpesh rrugët janë të bllokuara.

4.3.D. Projekt - "Rikonstruksion i godinës se poliklinikës Fushë-Arrëz". Ky projekt do çojë shërbimin shëndetësor pranë banorëve të këtyre zonave duke i çliruar nga ankthi dhe vështirësitë e zhvendosjes së të sëmurëve drejt Fushë-Arrëzit sidomos ne stinën e dimrit kur shpesh rrugët janë të bllokuara.

4.4.Përmirësimi i kushteve në arsim

4.4.A. Projekt – “Rikonstruksioni i fushave dhe ambjenteve rekreative të shkollave ekzistuese”, ky projekt konsiston në përmirësimin e ambjenteve të jashtme rekreative dhe oborreve të shkollave në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz. Realizimi i këtij projekti do të sjellë ambjente më të pastra dhe të sigurta për nxënësit e shkollave pasi aktualisht oborret e shkollave në përgjithësi janë subjekt i baltosjes nga shirrat apo pluhurosja në stinën e verës. Gjithahstu do tu japë mundësinë nxënësve dhe mësuesve të zhvillojnë një proces mësimor me një cilësi më të lartë.

4.4.B. Projekt – “Rikonstruksion i godinës se Shkollës Fillore Berishë e Vogël”, nga vizita në terren u vu re se pjesa dërmuese e shkollave në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz janë në gjendje të mirë fizike të rikonstutur vitet e fundit. Megjithatë ndër to u vunë re disa shkolla që kanë nevojë për ndërhyrje rikonstuksioni, siç është shkolla fillore Berishë e vogël. Realizimi i këtij projekti do t’u japë mundësinë nxënësve dhe mësuesve të zhvillojnë një proces mësimor me një cilësi më të lartë.

4.4.C. Projekt - "Rikonstruksion i godinës së Shkollës 9-Vjeçare Fjerzë" nga vizita në terren u vu re se pjesa dërmuese e shkollave në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz janë në gjendje të mirë fizike të rikonstutur vitet e fundit. Megjithatë ndër to u vunë re disa shkolla që kanë nevojë për ndërhyrje rikonstuksioni, siç është shkolla 9-Vjeçare Fjerzë. Realizimi i këtij projekti do tu japë mundësinë nxënësve dhe mësuesve të zhvillojnë një proces mësimor me një cilësi më të lartë.

4.4.D. Projekt - Rikonstruksion i godinës së Shkollës 9-Vjeçare Mëzi. Nga vizita në terren u vu re se pjesa dërmuese e shkollave në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz janë në gjendje të mirë fizike të rikonstutur vitet e fundit. Megjithatë ndër to u vunë re disa shkolla që kanë nevojë për ndërhyrje rikonstuksioni, siç është shkolla 9-Vjeçare Mezi. Realizimi i këtij projekti do tu japë mundësinë nxënësve dhe mësuesve të zhvillojnë një proces mësimor me një cilësi më të lartë.

4.4.E. Projekt – “Furnizimi i shkollave me bazën materiale për zhvillimin e procesit mësimor”, ashtu si në të gjitha zonat larg qendrave të mëdha në shqipëri edhe në territorin e Fushë-Arrëzit shkollat vuajnë nga mungesa e bazës materiale për zhvillimin e një procesi mësimor konform një norme normale. Të tilla si banka, dërrasa të zëza apo librari mungojnë nëpër auditoret e shkollave në Fushë-Arrëz, projekti në fjalë duhet të bëjë evidentimin e saktë të mungesave dhe plotësimin e tyre.

Projektet prioritare/pilot

SKEDA E PROJEKTIT - 15	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Asfaltim i aksit rrugor Fushë-Arrëz – Micoj"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike"
Vendndodhja	Fshati Micoj është një nga fshatrat në distancë më të afërt me qendrën e Bashkisë Fushë-Arrëzit me një distancë prej 5 km .
Harta	
Sektori	01_ Shërbime të përgjithshme publike
Programi	013_Shërbime të përgjithshme publike
Tipologjia	Infrastrukturë rrugore
Faza	Afatgjate (4-10 vjet)
Përmasa	5 km
Kohëzgjatja	5 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga Kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit . Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me cakull .

	Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Micoj duke i integruar me qytetin e Fushë-Arrëzit . Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave ingjnierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	276,538,462ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës - Ndërtimi i rrugës
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posacme, vënia në funksionim e rrugës

SKEDA E PROJEKTIT - 16	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Asfaltim i aksit rrugor Fushë-Arrëz – Lumbardhë"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: “Përmirësimi i shërbimeve publike”
Vendndodhja	Lumbardhë, Bashkia Fushë-Arrëz
Harta	 The image is an aerial photograph of a rugged, mountainous landscape. A red line is drawn across the terrain, indicating a proposed road route. The terrain is covered in green vegetation, and there are some small settlements visible in the valleys. The Google Earth logo is visible in the bottom left corner of the image.
Sektori	01_Shërbime të përgjithshme publike
Programi	013_Shërbime të përgjithshme publike
Tipologjia	Infrastrukturë rrugore
Faza	Afatgjatë (4-10 vjet)
Kohëzgjatja	5 vite

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Fshati Lumbardhë është një nga fshatrat në distancë të afërt me qendrën e Bashkisë Fushë-Arrëzit me një distancë prej 7.2 km Gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore ka shkaktuar dhe largim të popullsisë nga kjo zonë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit . Asfaltimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Lumbardhë, Tuç dhe Mollëkuqe. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës , ndërtimin e veprave ingjinierike , krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Përmasa	7.2 km
Kosto e përafërt	398,215,385 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës - Ndërtimi i rrugës
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posacme, vënia në funksionim e rrugës

SKEDA E PROJEKTIT - 17	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Asfaltim i aksit rrugor Iballë-Fjerzë"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike"
Vendndodhja	Fshatrat Iballë dhe Fjerzë janë qendrat e njësisë administrative me të njejtin emër. Rruga mes dy fshatrave me distancë 18.3km është në gjëndje mjaft të keqe dhe me nevojë përmirësimin e saj .
Harta	
	
Sektori	01_Shërbime të përgjithshme publike
Programi	013_Shërbime të përgjithshme publike
Tipologjia	Infrastrukturë rrugore
Faza	Afatgjatë (4-10 vjet)
Kohëzgjatja	5 vite

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Asfaltimi i kësaj rruge ka një ndikim për gjithë Bashkinë e Fushë-Arrësit pasi ndihmon në qarkullimin më të shpëjtë dhe efikas të gjithë qendrave të banuara në veri të Bashkisë. Asfaltimi i kësaj rruge ul ndjeshëm dhe distancën kohore mes Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Bashkisë Tropojë. Aksi rrugor Fushë-Arrëz-Iballë është një aks i përfunduar vitet e fundit dhe vazhdimi i këtij aksi drejt Fierzës dhe më pas Tropojës ndikon në zhvillimin e ekonomik të zonës , rritjen e aksesit për turistët të cilët afrohen në distancë me fshatin Kryezi pjese e projektit të 100 Fshatrave dhe me fshatin Iballë. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës dhe krijon mundësi të investimeve private dhe kthimin e banorëve të larguar. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull . Asfaltimi i kësaj rruge ka ndikim për gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz . Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave inxhinierike , krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave.
	Projekti propozohet të zhvillohet në 2 Lote/Faza Lot 1 Iballë- Bugjon 10.5 km Lot 2 Bugjon-Fierzë 7.8 km
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	1,012,130,770 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës - Ndërtimi i rrugës
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posacme, vënia në funksionim e rrugës

SKEDA E PROJEKTIT - 18	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	“Hapje traseje rruge auto Përroi Bugjon fshati Aprripë Guri njësia Fierzë
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: “Përmirësimi i shërbimeve publike”
Vendndodhja	Aprripë Guri, Fierzë
Harta	
	
Sektori	01_Shërbime të përgjithshme publike
Programi	013_Shërbime të përgjithshme publike
Tipologjia	Infrastrukturë rrugore
Faza	Afatgjatë (4-10 vjet)
Kohëzgjatja	5 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do ndikojë në integrimin e kësaj qendre të banuar me qytetin e Fushë-Arrëzit. Ndërtimi i këtij aksi rrugor ndikon pozitivisht në përmirësimin e aksesit në zonat mineral mbajtëse duke krijuar lehtësira në transport apo dhe investime të tjera private. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Asfaltimi i kësaj rruge ka ndikim për gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz . Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave ingjnierike , krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	

Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës - Ndërtimi i rrugës
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posacme, vënia në funksionim e rrugës

SKEDA E PROJEKTIT - 19	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të qytetit Fushë-Arrëz"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike"
Vendndodhja	Fushë-Arrëz
Përmasa	3.3 km
Harta/Foto	
Sektori	05_ Mbrojtja e Mjedisit
Programi	052_ Menaxhimi i ujrave të zeza
Tipologjia	Infrastukturë KUZ
Faza	Afatshmesëm (1-3 vite)
Kohëzgjatja	3 vite

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Qyteti i Fushë-Arrëzit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e kanalizimeve . Aktualisht ujrat e zeza janë të depozituara në gropa septike e cila shkakton ndotje të nëntokës dhe probleme mjedisore për Bashkinë Fushë-Arrëz. Nisur nga kjo problematikë është e nevojshme ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh prej 3.3 km në qytetin e Fushë-Arrëzit për largimin e ujërave të zeza të qytetit . Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza ndihmon në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit përreth. Ky projekt synon ndërtimin nga e para të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjet kryesore të qytetit të Fushë-Arrëzit.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	21,763,500 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve KUZ. - Ndërtimi i rrjetit KUZ në qytetin e Fushë-Arrëzit
Treguesi i monitorimit	Vënia në funksion e këtij rrjeti

Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Qyteti i Fushë-Arrëzit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e furnizimit me ujë të pijshëm. Në gjendjen aktuale rrjeti i ujësjellësit nuk i përmbush nevojat për popullatën. Ky projekt ka për qëllim ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për të shtuar sasinë e prurjeve të ujit, në përshtatje me nevojat e popullsisë.
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë. - Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë në qytetin e Fushë-Arrëzit
Treguesi i monitorimit	Vënia në funksion e këtij rrjeti

SKEDA E PROJEKTIT - 21	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Rikonstruksion i godinës së qendrës shëndetësore Berishë e Vogël"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: “Përmirësimi i shërbimeve publike”
Vendndodhja	Berishë e Vogël, Bashkia Fushë -Arrëz
Përmasa	61 m ² , 1 kat
Harta/Foto	
Sektori	07_ Shëndetësia
Programi	072_ Shërbimet ambulatorë
Tipologjia	Infrastrukturë shëndetësore
Faza	Afatshkurtër (1vit)
Kohëzgjatja	1 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Distanca e largët nga zonat kryesore urbane e fshatit Berishë e Vogël dhe infrastruktura e dobët rrugore (në masë të madhe përdoret dhe transporti ujqor) krijon vështirësi në marrjen e shërbimeve spitalore në distanca të largëta . Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë . Qendra Shëndetësore e fshatit Berishë e Vogël është në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive dhe për banorët e fshatrave Shopel dhe Berishë Vend të cilët nuk ofrojnë shërbim ambulator . Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtësës të Qendrës Shëndetësore
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	3,500,000 ALL

Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore - Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale.

SKEDA E PROJEKTIT - 22	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Rikonstruksion i godinës së qendrës shendetësore Arst-Miliska"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike"
Vendndodhja	Arst , Blerim
Përmasa	132 m ²
Harta/Foto	
Sektori	07_ Shëndetësia
Programi	072_ Shërbime ambulatorë
Tipologjia	Infrastrukturë shëndetsore
Faza	Afatshkurtër (1vit)
Kohëzgjatja	1 vit
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Distanca e largët nga qendrat shëndetësore të Dardhës dhe Fjerzës dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Arst. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Arst ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Arst , Miliska dhe Mëzi duke sjellë përfitim më të gjerë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtësës të Qendrës Shëndetësore .
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz
Kosto e përafërt	7,574,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz

Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtme për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore - Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale.

SKEDA E PROJEKTIT - 23	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	"Rikonstruksion i godinës së qendrës shëndetësore Xath"
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike"
Vendndodhja	Xath , Blerim
Përmasa	75 m2
Harta/Foto	
Spektori	07_ Shëndetësia
Programi	072_ Shërbime ambulatorë
Tipologjia	Infrastrukturë shëndetsore
Faza	Afat shkurtër (1vit)
Kohëzgjatja	1 vite
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Distanca e largët nga qendra shëndetësore e qytetit të Fushë-Arrëzit ndikon negativisht në marrjen e shërbimeve shëndetsore. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra shëndetësore Xath shërben si pikë shërbimi dhe për fshatrat Kulumri dhe Flet. Qendra shëndetësore e fshatit Xath ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Xath, Kulumri dhe Flet duke sjellë përfitim më të gjerë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës së Qendrës Shëndetësore .
Përgjegjës	Bashkia Fushë-Arrëz

Kosto e përafërt	4,303,000 ALL
Burimet e mundshme të financimit	- Investim publik - Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz
Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit	Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit: - Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore - Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore
Treguesi i monitorimit	Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale.

SKEDA E PROJEKTIT - 24	
Lloji i Projektit	Pilot
Emri i Projektit	Rikonstruksion i godinës së poliklinikës Fushë-Arrëz
Objektivi Strategjik	Objektivi Strategjik 4: “Përmirësimi i shërbimeve publike”
Vendndodhja	Fushë-Arrëz Qytet
Përmasa	758 m2
Harta/Foto	
Spektori	07_ Shëndetësia
Programi	072_ Shërbime ambulatorie
Tipologjia	Infrastrukturë shëndetësore
Faza	Afat shkurtër (1 vit)
Kohëzgjatja	1 vit
